



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 431 Akti

Nr. 542 Vendimi  
Tiranë, më 20.6.2022

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Brunilda Bekteshi</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>
<b>Lulzim Hamitaj</b>	<b>Anëtar</b>

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datat 14.6.2022 dhe 20.6.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Brunilda Çarçiu**, me detyrë inspektore në Inspektoratin e ish-KLD-së, sot KLGJ.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor të relatores së çështjes, komisionere Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Brunilda Çarçiu, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit” (në vijim Komisioni), është zhvilluar shorti në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli, ndërsa anëtar zëvendësues u zgjodh komisioneri Lulzim Hamitaj.

2. Me vendimin nr. 1, datë 23.12.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Brunilda Çarçiu, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Brunilda Bekteshi.

3. Pas kërkesës për dorëheqje, për shkak të konfliktit të interesit të anëtares Suela Zhegu, në datën 10.1.2020, trupi gjykues i zgjedhur me short vendosi pranimin e kërkesës së komisioneres Suela Zhegu, për dorëheqjen nga procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Brunilda Çarçiu. Komisionere Suela Zhegu u zëvendësua nga anëtari zëvendësues Lulzim Hamitaj, i shortuar si i tillë me shortin e datës 16.12.2019.

4. Në datën 10.1.2020, nëpërmjet postës elektronike subjektit Brunilda Çarçiu iu njoftua fillimi i procedurave të rivlerësimit, iu dërgua pyetësori standard, si dhe iu njoftua trupi gjykues, duke i bërë me dije të drejtën për të deklaruar konfliktin e interesit. Subjekti nuk ka deklaruar gjendje konflikti interesi.

5. Me vendimin nr. 2, datë 21.10.202, trupi gjykues, pasi vlerësoi statusin/pozitën e znj. Brunilda Çarçiu, në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe ligjit nr.84/2016, vendosi me shumicë votash të vijojë procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke e konsideruar atë si subjekt rivlerësimi *ex officio*, sikurse është arsyetuar në vijim të këtij vendimi.

6. Nga Komisioni u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

7. Me vendimin nr. 3, datë 11.5.2022, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Brunilda Çarçiu dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit të bazohet në të tria kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

8. Në datën 17.5.2022, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 1.6.2022; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

9. Në datën 31.5.2022, subjekti i rivlerësimit informoi Komisionin me anë të postës elektronike se i është drejtuar me kërkesa për informacion Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Elbasan dhe Njësisë Administrative \*\*\*, Bashkia Gramsh, përgjigjet e të cilave ende nuk ishin administruar prej saj. Për këto arsye, por edhe për shkak të pamundësisë objektive për të siguruar

dokumentacion brenda afatit të caktuar, pasi një pjesë e tij duhet të sigurohet nga SHBA-ja, kërkoi shtyrjen e afatit për paraqitjen e parashtrimeve me dy javë.

**10.** Me vendimin nr. 4, datë 1.6.2022, trupi gjykues vendosi të shtyjë afatin e kthimit të përgjigjeve deri në datën 9.6.2022 dhe jo me dy javë sa ishte kërkuar nga subjekti, duke mbajtur në konsideratë faktet si vijojnë: (i) znj. Brunilda Çarçiu i është drejtuar dy institucioneve në datën 28.5.2022, ndërkohë që është njohur me rezultatet e hetimit që në datën 18.5.2022, pra, pas 10 ditësh; (ii) në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasit D. R. në SHBA, subjekti ka pasur mundësinë e kërkimit të të dhënave të kërkuara nga Komisioni që me marrjen dijani të pyetësorit nr. 2, në janar të vitit 2022.

**11.** Në datën 9.6.2022, subjekti ka paraqitur prapësimet dhe dokumentacionin shoqërues mbi rezultatet e hetimit administrativ.

**12.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 5, datë 10.6.2022, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore.

**13.** Në datën 14.6.2022, u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm. Në këtë seancë, subjekti kërkoi kohë shtesë, me qëllim kthimin e përgjigjeve për pyetjet e drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues, kërkesë e cila u rrëzua me vendim të ndërmjetëm të trupit gjykues, i cili iu komunikua subjektit në seancë dëgjimore, duke i bërë me dije se kishte të drejtën e dërgimit në rrugë elektronike të përgjigjeve me shkrim brenda datës 15.6.2022. Në përfundim, subjekti kërkoi konfirmimin në detyrë.

**14.** Në datën 15.6.2022, subjekti dërgoi me anë të postës elektronike përgjigjet me shkrim të pyetjeve të ngritura nga anëtarët e trupit gjykues në seancën dëgjimore të datës 14.6.2022 dhe dokumentacion shoqërues.

**15.** Në datën 20.6.2022, u zhvillua seanca për shpalljen e vendimit.

## **II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

**16.** Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**17.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**18.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**19.** Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

### III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

#### Mbi statusin e subjektit

20. Nga të dhënat e administruara<sup>1</sup> ka rezultuar se:

- Znj. Brunilda A. A. ka kryer studimet në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike në sistemin me shkëputje nga puna në vitet akademike 1987 – 1991 dhe është diplomuar në datën 5.7.1991.
- Pas përfundimit të studimeve është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Gramsh, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në datën 13.5.2000, kur me vendimin nr. \*\*\*, të ish-KLD-së ajo lirohet nga detyra e gjyqtares me kërkesën e saj. Në datën 15.5.2000 është emëruar ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më 1.3.2011. Me urdhrin nr. \*\*\* prot., datë 9.5.2012, KLD-ja ka urdhëruar emërimin e znj. Brunilda Çarçiu, si specialiste pranë IKLD-së.
- Me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.11.2016, znj. Brunilda Çarçiu është emëruar inspektore pranë IKLD-së.
- Në datën 27.1.2017, znj. Brunilda Çarçiu ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së, në funksionin e inspektore pranë KLD-së deklaratën *Vetting*, si dhe dokumentacionin mbështetës. Po kështu, në datën 30.1.2017 ka depozituar formularin e vetëvlerësimit dhe dokumente shoqëruese pranë ish-KLD-së, si organ i vlerësimit të aftësive profesionale.
- Me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.12.2019, KLGJ-ja, pasi ka arritur në përfundimin se inspektorja Brunilda Çarçiu e ka ruajtur statusin e gjyqtarit, ka vendosur të deklarojë pasjen e statusit “magjistrat” nga znj. Brunilda Çarçiu.

21. Trupi gjykues, në vlerësimin e gjendjes që identifikohen rrethanat faktike dhe ligjore për rastin në fjalë, të analizuar në raport me kuadrin ligjor dhe frymën e qëllimit për të cilën u miratua ligji nr. 84/2016, ka çmuar se znj. Brunilda Çarçiu duhet t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit *ex-officio*, pas analizimit të disa aspekteve të renditura në vijim:

- a) fakteve dhe rrethanave ligjore të dala nga aktet e administruara në dosjen objekt hetimi, për znj. Brunilda Çarçiu;
- b) shkaqeve dhe arsyeve të kualifikimit të znj. Brunilda Çarçiu, subjekt rivlerësimi;
- c) shprehjes së vullnetit të subjektit dhe sjelljeve të saj në raport me detyrimet ligjore, si dhe përgjatë nisjes së hetimit administrativ dhe deri aktualisht;
- ç) a i shërben qëllimit të ligjit nr. 84/216, Reformës në Drejtësi dhe arsyeve për të cilat u ndërtuan organet e reja të sistemit të drejtësisë, kualifikimi i pozitës juridike të znj. Brunilda Çarçiu, si subjekt rivlerësimi?

21.1 Në lidhje me identifikimin e fakteve dhe rrethanave ligjore, të dala nga aktet e administruara në dosjen objekt hetimi, rezultoi se:

- i) Për znj. Brunilda Çarçiu, si subjekt i shortuar nga Komisioni dhe për të cilën nisi procesi i rivlerësimit, janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe formulari i vetëvlerësimit dhe dokumente shoqëruese dorëzuar nga subjekti pranë ish-KLD-së, si organ i vlerësimit të aftësive profesionale.
- ii) Me kërkesën e datës 10.4.2018, znj. Brunilda Çarçiu, i është drejtuar Komisionit të pavarur të Kualifikimit, ONM-së, Kryeinspektore së KLD-së dhe Shkollës së Magjistraturës, në të cilën kërkon t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar si ish-gjyqtare. Subjekti bën me

<sup>1</sup>Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2020, nga KLGJ-ja, në dosjen e Komisionit; shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2020, nga KLGJ-ja drejtuar Komisionit; deklaratën *Vetting* në dosjen e ILDKPKI-së; kërkesën e datës 10.4.2018, të znj. Brunilda Çarçiu, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 13.4.2018, drejtuar Komisionit, ONM-së, SHM-së dhe Kryeinspektore së KLD-së; sqarime nga znj. Brunilda Çarçiu dërguar në rrugë elektronike në datat 10 dhe 19.10.2021, në adresë të Komisionit.

dije se kjo kërkesë është bërë prej saj pasi Shkolla e Magjistraturës i ka kërkuar të kryejë testimin profesional dhe sipas saj, ajo është subjekt rivlerësimi, për shkak të detyrës si inspektore e KLD-së dhe njëkohësisht si ish -gjyqtare.

iii) Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.12.2019, ka vendosur “të deklarojë pasjen e statusin “magjistrat” nga znj. Brunilda Çarçiu.

iv) Nga dosja e ILDKPKI-së, konstatohet se znj. Brunilda Çarçiu, në funksionin e inspektore pranë KLD-së, në datën 27.1.2017, ka dorëzuar pranë këtij institucioni deklaratën *Vetting* dhe dokumentacionin mbështetës.

v) Në datën 10.12.2020, me shkresën nr. \*\*\* prot., KLGJ-ja i ka kërkuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të japë mendim lidhur me periudhën e rivlerësimit që do të merret për zhvillimin e shortit profesional të znj. Brunilda Çarçiu, nëpunëse përgjegjëse pranë Njesisë së Vlerësimit Profesional dhe etik të gjyqtarëve pranë KLGJ-së, e cila në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, sipas ligjit, nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtarit, ndërkohë që është emëruar inspektore në KLD, në datën 18.11.2016.

vi) Me e-mail të datës 8.10.2021, iu kërkuar znj. Brunilda Çarçiu, që të vendosë në dispozicion të Komisionit kërkesën e saj për t’u rivlerësuar si ish-gjyqtare, të depozituar brenda afatit ligjor pranë institucioneve ndihmëse, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë, të Kushtetutës. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, znj. Brunilda Çarçiu informoi se: *“Në lidhje me informacionin e kërkuar po ju sqaroj se në momentin që ligji hyri në fuqi unë nuk isha në detyrën e inspektore në KLD, pasi jam emëruar në këtë detyrë me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.11.2016. Në momentin që Gjykata Kushtetuese vendosi afatin përfundimtar për plotësimin e formularëve, mendova se isha pjesë e këtij ligji, si inspektore tashmë në detyrë dhe plotësova në përputhje me këtë ligj deklaratën *Vetting*”.*

vii) Komisioni lidhur me këtë situatë, me anë të postës elektronike, i kërkoi subjektit të parashtojë qëndrimin si vijon:

- Të sqarojë pozitën e saj mbi depozitim të kërkesës në prill të vitit 2018 - në raport me sjelljen e saj si subjekt rivlerësimi *ex officio* duke dorëzuar pranë organeve ndihmëse deklaratat dhe formularët, mbështetur edhe në përgjigjen e saj dërguar Komisionit në datën 10.10.2021.

- Të sqarojë pozitën e saj, lidhur me depozitim të kërkesës në prill të vitit 2018, për t’u vetuar si ish-gjyqtare – në raport me parashikimin ligjor në nenet 31, 35 dhe 41, që kërkon paraqitjen me shkrim pranë Komisionit të kërkesës për rivlerësimin e tyre, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit, kërkesë kjo që i bashkëlidhë formularit përkatës.

- Të përcaktojë qartësisht qëndrimin përfundimtar lidhur me procesin e rivlerësimit, për konsiderimit apo jo si subjekti rivlerësimi.

viii) Në datën 19.10.2021, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se *deklaratat dhe formularin *Vetting* i ka plotësuar në përputhje me nenin 179/b të Kushtetutës, ku parashikohet se inspektorët pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*. Në këto kushte edhe formulari i vetëdeklarimit pranë KLD-së është plotësuar si inspektore në detyrë, duke depozituar edhe procesverbalin nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2017, si dhe fletën e inventarit. Ky formular nuk është plotësuar si ish-gjyqtare, pasi si ish-gjyqtare duhej t’i drejtohej KLD-së me kërkesë. Plotësimi i deklaratës *Vetting* prej saj si inspektore, tregon se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga procesi i rivlerësimit, pasi e ka plotësuar këtë detyrim ligjor në momentin e emërimit si inspektore, ndërsa qenien si subjekt apo jo të ligjit e lë në çmim të Komisionit.*

**21.2.** Arsyetimi i shkaqeve dhe rrethanave të kualifikimit të znj. Brunilda Çarçiu, si subjekt rivlerësimi, si vijon:

i) Kushtetuta në nenin 179/b, pika 3, parashikon se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë*

*Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”.*

ii) Po ashtu, ligji nr. 84/2016, që hyri në fuqi me botimin në fletoren zyrtare, datë 8.10.2016, u pezullua nga Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në datën 25.10.2016 dhe, për rrjedhojë të kësaj mase pezullimi, efektet e zbatimit të ligjit nisën me publikimin e vendimit nr. 2, datë 19 .1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

iii) Për të kualifikuar znj. Brunilda Çarçiu si subjekt rivlerësimi sipas përkufizimit kushtetues, vlerësohet se kuadri ligjor i sipërcituar duhet lexuar/analizuar dhe, për rrjedhojë, duhet çmuar në situatën faktike dhe ligjore që gjendet znj. Brunilda Çarçiu. Në këtë drejtim ka rezultuar se vërtet znj. Brunilda Çarçiu është gjendur në detyrën e specialistes në Drejtorinë Ligjore të KLGJ-së në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr.84/2016, për shkak të botimit të tij në fletoren zyrtare, por, nga tjetër ajo u gjend në detyrën e inspektore, pikërisht, në kohën kur ligji filloi efektet e zbatimit të tij, sipas vendimit nr. 2, të Gjykatës Kushtetuese, në datën 19.1.2017, i cili, gjithashtu, ka forcën e ligjit. Në këtë drejtim, trupi gjykues çmon se emërimi i subjektit në nëntor të vitit 2016 si inspektore, në momentin e pezullimit të ligjit nr. 84/2016 dhe të afatit për startimin e procesit të rivlerësimit e barazon atë (*de facto*) me të gjithë subjektet e tjera.

iv) Po ashtu, faktet e rezultuara nga aktet e administruara dëshmojnë se znj. Brunilda Çarçiu është emëruar në detyrën e inspektore me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.11.2016 dhe sikurse ka rezultuar për çdo subjekt rivlerësimi, deklaratën e pasurisë e ka plotësuar në janar të vitit 2017, pra, në detyrën/si inspektore që mbante në momentin/datën e plotësimit të kësaj deklarate.

v) Situata ligjore e sipërcituar nuk duhet të shihet e shkëputur nga fakti më i qenësishëm i kësaj çështjeje, kur një institucion kushtetues, KLGJ-ja, me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.12 .2019, bazuar në ligjin nr.115 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe në ligjin nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka disponuar me “deklarimin e pasjes së statusit “magjistrat”, për znj. Brunilda Çarçiu.

vi) Trupi gjykues çmon se ruajtja e statusit për znj. Brunilda Çarçiu nga institucioni kushtetues i KLGJ-së , si dhe qenia e saj në detyrën e inspektore, sipas përkufizimit kushtetues, neni 179 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që në datën 18.11.2016 dhe aktualisht, janë arsye dhe rrethana ligjore që të vendosin në kushtet e zbatimit të nenit 168 paragrafi (1) i ligjit nr. 96/2016, i cili parashikon se: *“Inspektori dhe kryeinspektori në detyrë, të cilët kanë statusin e gjyqtarit dhe ushtrojnë funksionet në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, me hyrjen në fuqi të ligjit konsiderohen magjistratë dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e këtij ligji. Ato i nënshtrohen procesit të rivlerësimit ...”.*

vii) Sa më sipër arsyetuar, kjo çështje duhet të çmohet nën respektimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe sigurisë juridike që nënkupton:

Së pari, vendimi i marrë nga KLGJ-ja, për deklarimin e ruajtjes së statusit së znj. Brunilda Çarçiu, nuk mund t'i nënshtrohet një vlerësimi ndryshe nga një organ tjetër kushtetues si Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Ky argument ligjor gjendet i bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit dhe, më konkretisht, te vendimi i subjektit të rivlerësimit E. Q., ku në faqen 36.1, ndër të tjera, arsyetohet se: *“... trupi gjykues vlerëson të sjellë në vëmendje, së pari, se interpretimi i kuadrit ligjor është kompetencë e institucioneve që i zbatojnë këto parashikime ligjore. Në rastin konkret, kuadri ligjor që përbën procesin e rivlerësimit, është kompetencë e Komisionit dhe e Kolegjit. Po ashtu, kuadri ligjor që rregullon statusin e magjistratëve, është kompetencë e KLGJ-së apo KLP-së, sipas rastit. Në vijim të këtij parimi, është e natyrshme që për pyetje dhe procedura që lidhen me statusin e subjekteve të rivlerësimit, Komisioni apo Kolegji kanë nevojë për opinionin e secilit prej këtyre dy institucioneve. Ky qëndrim i trupit gjykues është në përputhje edhe me jurisprudencën<sup>1</sup> e Gjykatës Kushtetuese, e cila është shprehur: [...]. Interpretimi i ligjeve është para së gjithash e drejta për çdo organ që i zbaton*

ato. [...] dhe [...]. Interpretimi, si funksion dhe metodë, ka vend për një normë ekzistuese kur ka paqartësi në kuptimin e saj dhe jo për të plotësuar boshllëkun, sepse përndryshe Gjykata Kushtetuese do të vihej në pozicionin e gabuar të krijuesit të normës juridike, funksion që, siç dihet, i përket ligjvënësit [...].”

Së dyti, parimi i sigurisë juridike nënkupton që një status i fituar në bazë të një ligji të mëparshëm nuk mund të cenohet për shkak të ndryshimeve të mëvonshme ligjore. KLGJ-ja, në vendimin nr. \*\*\*, datë 19.12.2019, ka bërë vlerësim/vendimmarrje në bazë të fakteve dhe dispozitave ligjore të mëparshme.

Së treti, ky qëndrim është në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, nr.34/2017, ku kjo e fundit është shprehur se: “... fryma që përshkon Kushtetutën edhe pas ndryshimeve kushtetuese, është vijimësia institucionale dhe ushtrimi i funksioneve për të garantuar vlerat dhe parimet, të cilat krijojnë bazën e shtetit të së drejtës ... ndryshimet kushtetuese të datës 22.8.2016 përforcohen nga parimi i vijimësisë dhe koherencës institucionale, e cila garanton vlerat dhe parimet e shtetit të së drejtës ...”.

viii) Fakti që KLGJ-ja si një organ kushtetues ka disponuar me vendim se znj. Brunilda Çarçiu e ka ruajtur statusin e magjistratit është konfirmuar duke vlerësuar në këtë rast edhe depozitimin prej saj, ndër vite, të shtatë kërkesave për t’u rikthyer në pozicionin e gjyqtare, si dhe tri kërkesave për t’u emëruar si inspektore, duhet parë dhe çmuar nën analizën *se ajo ka qenë dhe është në detyrë*, sipas parashikimit të nenit 179/b të Kushtetutës, nën efektin e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, edhe në ecurinë e procesit të rivlerësimit.

ix) Një aspekt tjetër që duhet të vlerësohet është edhe çmuarja që duhet të ketë mosdepozitimi i kërkesës prej saj brenda afatit ligjor si ish-gjyqtare. Në raport me këto parashikime ligjore, nga aktet e administruara, ka rezultuar se:

- Znj. Brunilda Çarçiu në letrën e saj drejtuar Komisionit, në prill të vitit 2018, ka pretenduar se ajo i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar si ish-gjyqtare. Neni 179/b, pika 4, fjalja e dytë, e Kushtetutës parashikon se *procesit të rivlerësimit mund t’i nënshtrohen me kërkesë nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet*. Ndërkohë, në lidhje me këtë kategori subjektësh, ligji nr. 84/2016 në nenet 31, 35 dhe 41, parashikon paraqitjen me shkrim para Komisionit, të kërkesës për rivlerësimin e tyre brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit dhe kërkesa i bashkëlidhet formularit përkatës.

- Situata faktike e përshkruar më sipër, edhe pse në njërin anë shihet se znj. Brunilda Çarçiu nuk ka paraqitur një kërkesë të saj brenda afatit ligjor për t’u rivlerësuar si ish-gjyqtare, apo si ish-këshilltare, nga ana tjetër mosformalizimi i një kërkesë të tillë, e cila nga legjislatori është parashikuar si *“një e drejtë”* e çdo subjekti që plotëson kriteret e nenit 179/b, pika 4, fjalja e 2-të, duhet të çmohet nën rrethanat faktike e ligjore: (i) mbi disponimin e vendimit të KLGJ-së “Për deklarimin e pasjes së statusit”, për znj. Brunilda Çarçiu; si dhe (ii) në ndërmarrjen e veprimeve dhe shprehjen e vullnetit të saj<sup>1</sup> që dëshmojnë fakte se znj. Brunilda Çarçiu është sjellë në mënyrë konsistente si subjekt rivlerësimi. Në këtë drejtim vlen të përmendet fakti se nëse do të analizonim shkakun e mosparaqitjes së kërkesës në kohë për rivlerësimin e saj si një ish-gjyqtare, duket qartë që kjo ka ndodhur vetëm për shkak të interpretimit dhe vlerësimit të ndryshëm (paraqitur vetëm pas dërgimit të rezultateve të hetimit) të pozicionit të saj si subjekt *ex officio* dhe aspak për mospasje vullneti për t’u vetuar.

**21.3.** Shprehja e vullnetit të subjektit dhe sjelljeve të saj në raport me detyrimet ligjore, si dhe përgjatë nisjes së hetimit administrativ e deri aktualisht.

- Znj. Brunilda Çarçiu ka plotësuar formularët sipas ligjit nr. 84/2016 (konfirmuar nga KLGJ-ja si organ kushtetues, pasja e statusit si magjistrat), ka depozituar kërkesë, edhe pse në tejkalim të afatit ligjor, për t’u rivlerësuar si ish-gjyqtare, gjatë hetimit administrativ në qëndrimet e saj

është shprehur se nuk i është shmangur procesit të rivlerësimit, si dhe në komunikimin e saj me Komisionin është shprehur se ka lënë në çmim të këtij institucioni rivlerësimin ndaj saj. Të gjithë këto veprime në vlerësimin tim, qartësisht *diktojnë vullnet të pavesuar dhe real* lidhur me këtë proces. Vendimi i KLGJ-së, për dhënien e statusit të magjistratit për znj. Brunilda Çarçiu, i shtrin efektet prapavepruese, *retrosactively*, nga momenti i emërimit si inspektore – duke e barazuar plotësisht me subjektet e tjera përpara mbarimit të afatit për paraqitjen e formularëve, pikërisht, për të mundësuar nisjen e procesit të rivlerësimit.

**21.4.** Kualifikimi i pozitës juridike të znj. Brunilda Çarçiu, si subjekt rivlerësimi, a i shërben qëllimit të ligjit për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe Reformës në Drejtësi, për të cilat u ndërtuan organet e reja të sistemit të drejtësisë?

i) Lidhur me këtë çështje, sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi.

ii) Pozita e znj. Brunilda Çarçiu si subjekt rivlerësimi, për sa kohë institucioni kushtetues, KLGJ-ja: (a) i ka njohur ruajtjen e statusit magjistrat, që nënkupton se ka qenë në sistemin e drejtësisë në një karrierë të gjatë; (b) ka ushtruar detyra të ndryshme në sistemin e drejtësisë të cilat gjenden sipas parashikimit kushtetues të Republikës së Shqipërisë në nenin 179/b/3 dhe 5 të saj, ku është parashikuar: “3. Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*. 5. Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, çmohet se i përgjigjet frymës dhe qëllimit të Kushtetutës, ligjit nr.84/2016 dhe në tërësi Reformës në Drejtësi”.

**22.** Nga një analizë harmonike dhe objektive të rrethanave dhe fakteve, me një vlerësim konkret/pragmatik në aspektin substancial dhe jo *strict formal*, Komisioni vlerësoi vijimin e procesit të rivlerësimit znj. Brunilda Çarçiu, për sa kohë vendimi i KLGJ-së për njohjen e statusit të magjistratit për të, i shtrin efektet në një periudhë të mëhershme, pikërisht, në sajë të funksioneve të mbuluara në karrierën e saj, duke e barazuar plotësisht me subjektet e tjera përpara mbarimit të afatit për paraqitjen e formularëve, pikërisht, për të mundësuar nisjen e procesit të rivlerësimit. Gjithashtu, Komisioni vlerëson që nga një këndvështrim më i gjerë, duke pasur parasysh frymën e dispozitave kushtetuese dhe të ligjit nr. 84/2016, që synojnë rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve, prokurorëve, inspektorëve, ndihmësve ligjorë – dhe jo vetëm – duke përfshirë këtu edhe ata të cilët kanë pasur më herët një të kaluar profesionale si gjyqtarë, prokurorë apo këshilltarë ligjorë (ish...) dhe aspirojnë të rikthehen si aktorë në sistemin e drejtësisë, ndonëse ndërkohë e kanë humbur pozicionin e mëparshëm, përforcohet bindja se znj. Brunilda Çarçiu duhet të përfshihet ndër subjektet që duhet t’i nënshtrohen hetimit administrativ për rivlerësimin kalimtar. Në të kundërt nuk mund të konsiderohet në harmoni dhe në përputhje me këto dispozita dhe as në funksion të realizimit të qëllimit të reformës në drejtësi, moskryerja e procesit të rivlerësimit ndaj një ish-gjyqtari, që, më pas, ka mbuluar funksione të ndryshme në karrierë. Kësisoj, alternativa e anashkalimit/mos kryerjes të procesit të rivlerësimit, duke ndërprerë këtë proces me një vendim jo përfundimtar, jo vetëm që do të binte ndesh me frymën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore në fjalë, por do të rezultonte totalisht e pambështetur në ligj dhe në prova, si dhe me mangësi të argumenteve analitiko-juridike bindëse.

**23.** Kështu që, në konsiderim të sa më sipër, nëse do të ndërpritej procesi i rivlerësimit, përjashtimi i subjektit nga sistemi i drejtësisë për 15 vjet, si e vetmja rrugë që mund të ndërpriste këtë proces tashmë të nisur (së bashku me dorëheqjen), nuk do të ishte në përputhje me parimin



e objektivitetit dhe të proporcionalitetit. Midis mosveprimit (në kohë), pa pasoja administrative lidhur me procesin e rivlerësimit (që ka nisur pas paraqitjes së deklaratës nga znj. Brunilda Çarçiu), si dhe masës penalizuese, të përjashtimit nga sistemi për 15 vjet, Komisioni vlerësoi se zgjidhja më e përshtatshme dhe në përputhje me vullnetin e shprehur nga subjekti, me frymën e ligjit dhe me interesin publik, do të ishte kryerja e rivlerësimit për këtë subjekt.

### **Vlerësimi i pasurisë**

**24.** Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu, ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë në datën 29.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, me nr.indeksi \*\*\* dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private (DPV), për periudhën 2004 – 2010, deklaratën pas largimit nga funksioni 2011, deklaratën para fillimit të detyrës 2016, si dhe deklaratat periodike në vijim.

**25.** ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin, ka konstatuar se: (a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (b) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (d) nuk ka kryer deklarim të rremë; (e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**26.** Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Brunilda Çarçiu, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaratimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

**27.** Hetimi administrativ, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklaratimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

### **Pasuri të deklaruara në deklaratën Vetting**

**28.** Në deklaratën Vetting, subjekti ka deklaruar: “*Banesë private 2 kate në bashkëpronësi, me sipërfaqe takuese ¼, ndodhur në \*\*\*, e vetëndërtuar pjesë-pjesë që në vitin 1996, e vlerësuar sipas çmimeve të kohës, legalizuar me lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 19.12.2014, me sipërfaqe truall 568.40 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 243.90 m<sup>2</sup>, sipas certifikatës së pronësisë me nr. serial \*\*\*, z. k. nr. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\* dhe dokumentet bashkëlidhur. Vlera: 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50% në bashkëpronësi me bashkëshortin e pjesës takuese prej 25%. Burimi i krijimit: kursime nga pagat në vite dhe të ardhura nga aktivitet privat*”.

**29.** ILDKPKI-ja, në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar:

- mungesë e burimeve të ligjshme financiare, për ndërtimin e shtëpisë së banimit me 2 kate, në vitin 1997, në vlerën 3.000.000 lekë;
- mungesë dokumentacioni justifikues ligjor (situacion punimesh/preventiv punimesh, akt kolaudimi, etj.), për ndërtimin e shtëpisë së banimit 2 – kate për vlerën e deklaruar 3 000 000 lekë. Rrjedhimisht vlera e ndërtimit të shtëpisë 2 kate, me sipërfaqe ndërtimi 243.9 m<sup>2</sup> dhe për banim sip. 559.8 m<sup>2</sup>, mbetet e paverifikuar;
- mospërputhje lidhur me periudhën e ndërtimit të shtëpisë së banimit mes deklaratës *Vetting* dhe deklaratave të interesave private, para fillimit të detyrës 2003 dhe 2016, si dhe mosdeklarimi i sipërfaqes së ndërtimit në deklaratën e interesave private, para fillimit të detyrës 2003;
- bashkëshorti i subjektit A. Ç., si subjekt deklarues nuk e ka deklaruar shtëpinë 2 kate, në deklaratën e tij të interesave private, para fillimit të detyrës 2005;
- ndërtimi i paligjshëm i shtëpisë së banimit me 2 kate, rëndon figurën e subjektit.

### Hetimi i Komisionit për këtë pasuri

**30.** Në lidhje me origjinën e pasurisë, statusin aktual të saj dhe deklaratimet e subjektit, u verifikuan aktet e ILDKPKI-së dhe aktet shkresore të administruara gjatë hetimit administrativ<sup>2</sup>, sipas të cilave rezultoi se:

- Me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 30.10.1996, shtetasit S. Ç.(vëllai i bashkëshortit) dhe Sh. K. kanë blerë në vlerën 1.500.000 lekë, godinën njëkatëshe, ish-zdrukhëtaria \*\*\* e Stacionit Racor të Gjedhit.

- Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore, datë 14.10.2003, nga ZVRPP-ja Tiranë, në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, datë 30.10.1996, figuron e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve S. Ç. dhe Sh. K., godina e sipërpërmendur me sipërfaqe të truallit 1067 m<sup>2</sup>.

- Sipas kontratës për pjesëtim vullnetar nr. \*\*\*, datë 7.2.2000, kunati i subjektit S. Ç. ka marrë pjesën A të objektit ekzistues prej 567 m<sup>2</sup>, mbi truallin e të cilit është rindërtuar një objekt i ri me 4 bashkëpronarë: S. Ç., A. Ç., A. A. dhe A. Ç.

- I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi origjinën dhe mënyrën e përfitimit të truallit mbi të cilin ndodhet objekti, duke paraqitur çdo kontratë apo marrëveshje me pronarin/zotëruesin e këtij trualli, subjekti ka sqaruar se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 30.10.1996, shtetasit S. Ç. dhe Sh. K. kanë blerë në vlerën 1.500.000 lekë një godinën njëkatëshe, ish-zdrukhëtaria \*\*\* e Stacionit Racor të Gjedhit, ndërsa sipërfaqja prej 1067 m<sup>2</sup> i është dhënë me qira për 5 vjet, sipas vërtetimit pronësie të datës 16.1.1997. Sipas kësaj kontrate që subjekti e vuri në dispozicion dhe vërtetimit të pronësisë së objektit, rezultoi se trualli i objektit është dhënë me qira, e cila deri në momentin e hartimit të kontratës së shitblerjes është paguar deri më 19.9.1997.

- Në sqarimet në ILDKPKI, lidhur me truallin e objektit, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar<sup>3</sup> se nuk ka paguar për blerjen e sipërfaqes së truallit<sup>4</sup>, pa dhënë sqarime të mëtejshme se si është përfituar trualli nga pronari i pare apo si është përfituar bashkëpronësia e tij.

- Gjatë hetimit administrativ, subjekti sqaroi se me gjithë përpjekjet për të blerë truallin prej 567 m<sup>2</sup>, kjo gjë nuk u arrit të mundësohej dhe, për këtë arsye, me daljen e ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, për legalizimin, u ndoqën procedurat ligjore dhe, më pas, u bë kalimi në pronësi i

<sup>2</sup>Shihni aktet në aneksin \*\*\*, \*\*\* dhe \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

<sup>3</sup>Shihni sqarimet e dhëna nga subjekti dhe bashkëshorti, sipas procesverbalit të datës 7.2.2017, në ILDKPKI, bashkëngjitur shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2020, të ILDKPKI-së, në dosjen e Komisionit.

<sup>4</sup>Duke qenë se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 30.10.1996, godina njëkatëshe është blerë nga shtetasit S. Ç. dhe Sh.K., në vlerën 1.500.000 lekë, në analizën financiare subjekti nuk është ngarkuar me asnjë shpenzim për vlerën e godinës së blerë nga vëllai i tij, në shumë 1.500.000 lekë. Nuk është ngarkuar, gjithashtu, edhe me shpenzime për fitimin e bashkëpronësinë mbi truallin.

parcelës ndërtimore me VKM-në nr. 611, datë 11.6.2009. Për të mbështetur pretendimet e saj subjekti paraqiti: një mandatpagesë qiraje në Bankën e Kursimeve që i përket datës 25.4.2003, me përshkrimin qira truall zdrukthëtari, në shumën 86.149 lekë; kontratën e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore; si dhe VKM-në nr. 611, trajtuar në vijim.

- Me shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 25.2.2020, ASHK-ja, Tirana Veri informoi se në emër të shtetasit A. R. Ç., bashkëshorti i subjektit, rezulton e regjistruar në bashkëpronësi me shtetasin A. T. A. (babai i subjektit), A. R. Ç. (vëllai i bashkëshortit të subjektit) dhe S. R.Ç. (vëllai i bashkëshortit të subjektit), pasuria e llojit truall me sip. 568.4 m<sup>2</sup> + ndërtesë me sip. 243.9 m<sup>2</sup>, në z. k. \*\*\*, me leje legalizimi.

- E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi gjendjen juridike aktuale të kësaj pasurie, subjekti ka informuar<sup>5</sup> se pas pjesëtimit të bashkëpronësisë është regjistruar në datën 26.4.2021, në pronësi të shtetasit A. Ç.: (i) pasuria nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit apartament me sip 57.98 m<sup>2</sup>; (ii) pasuria nr. \*\*\*, e llojit apartament me sip. 65.78 m<sup>2</sup>, pra, në pronësi të shtetasit A. Ç. rezultojnë dy apartamente me sip. totale 123.76 m<sup>2</sup>. Subjekti paraqiti certifikatat e pronësisë për të gjithë bashkëpronarët e ndërtesës, nga ku rezulton që secili prej tyre ka në pronësi nga dy apartamente, nga një apartament në secilin kat<sup>6</sup>.

- FSHU-ja<sup>7</sup> konfirmoi kontratën e furnizimit me energji me kod klienti \*\*\*, në emër të bashkëshortit të subjektit A. Ç., e hapur në datën 28.12.2011.

- UKT-ja<sup>8</sup> nuk konfirmoi kontratë të furnizimit me ujë në emër të subjektit apo bashkëshortit. Ndërkohë, subjekti informoi<sup>9</sup> se në janar të vitit 2018 është lidhur kontrata me ujesjellësin, sipas kontratës nr. \*\*\*, në emër të shtetasit A. Ç..

**31.** Në lidhje me procedurat e legalizimit të objektit të ndërtuar pa leje ndërtimi, nga ana e Komisionit janë kryer disa verifikime, nga të cilat ka rezultuar se:

- Me vetëdeklarimin për legalizim të datës 23.3.2005, pranë Njësisë Administrative Nr. \*\*\* dhe vetëdeklarimin e datës 11.9.2006, me nr. \*\*\*, deklaruesit S. R. Ç., A. Ç., A. A. dhe A. Ç., deklarojnë se në mars të vitit 1997 kanë ndërtuar një objekt banimi 2 kate, me sipërfaqe të zënë 567 m<sup>2</sup>, sipërfaqe ndërtimi 300 m<sup>2</sup>, me adresë: rruga “\*\*\*\*”, \*\*\*, Tiranë.

- Në deklaratën për vitin 2003, subjekti ka deklaruar: “*Shtëpi banimi 2-katëshe. Filluar ndërtimi fundi i vitit 1996. Rruga “\*\*\*\*”, \*\*\*. E paregjistruar. Vlera 3.000.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhura nga aktiviteti privat, biznes i vogël Gramsh dhe të ardhura familjare*”. Nuk është deklaruar sipërfaqja e ndërtimit.

- Me VKM-në nr. 611, datë 11.6.2009, u vendos miratimi i kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore, në favor të zotëruesve të objekteve informale, ndër të cilët edhe për shtetasit S.R.Ç., A. R. Ç., A. T. A. dhe A. R. Ç., në pronësi të të cilëve kaloi pasuria me nr. \*\*\*, me sip. 568.4 m<sup>2</sup>.

- Sipas kontratës së kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore nr. \*\*\*, datë 18.12.2014, me palë blerëse S. Ç., A. Ç., A. A. dhe A. Ç. dhe palë shitëse ALUIZNI, është bërë kalimi në pronësi të blerësve të parcelës ndërtimore me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 568.4 m<sup>2</sup>, mbi të cilën ngrihet ndërtesa dykatëshe me sip 243.9 m<sup>2</sup>, sipas vetëdeklarimeve, kundrejt vlerës prej 1.320.000 lekësh, paguar me bono privatizimi, sipas mandatit të datës 17.12.2014. Pra, siç

<sup>5</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dhe dokumentet bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

<sup>6</sup>Shihni dokumentet e bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit shtesë nr. 5, në dosjen e Komisionit.

<sup>7</sup>Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2022, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>8</sup>Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr.\*\*\* prot., datë 3.2.2020, nga UKT-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>9</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

vërehet, të katër bashkëpronarët kanë paguar shumën 1.320.000 lekë, për sipërfaqen prej 568.4 m<sup>2</sup>, në vitin 2014<sup>10</sup>.

- Me lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 19.12.2014, është legalizuar objekti “godinë banimi 2 kate”, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 568.4 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtimi 243.9 m<sup>2</sup>, në emër të shtetasve A. R. Ç., A. T. A., A. R. Ç. dhe S. R. Ç., konfirmuar edhe nga ASHK-ja, Drejtoria e Përgjithshme.

- Sipas kartelës së pasurisë rezulton se në datën 19.12.2014, pasuria me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit truall me sip. 568.4m<sup>2</sup>, dhe ndërtesë (dykatëshe) me sip. 243.9 m<sup>2</sup>, është regjistruar në bashkëpronësi të katër bashkëpronarëve të sipërpërmendur.

- Në DIPPFD-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: *“Banesë private, 2 kate, me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, ndërtuar në 1996-2000, legalizuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.12.2014. Vlera: 3.000.000 lekë. Burimi i krijimit: kursime nga pagat në vite dhe të ardhura nga aktivitet privat. Pjesa takuese: 50% në bashkëpronësi me bashkëshortin”*.

- Sipas kontratës së pjesëtimit me nr. \*\*\*, datë 30.11.2020<sup>11</sup>, është bërë pjesëtimi i bashkëpronësisë mes bashkëpronarëve të mësipërm, sipas të cilës A. Ç. i kalon në pronësi: (i) apartament nr. \*\*\*, me sip. 57.975 m<sup>2</sup> dhe verandë me sip. 9.00 m<sup>2</sup>, kati përdhe; dhe (ii) apartament nr. \*\*\*, me sip. 65.775 m<sup>2</sup> e sip. shkalle 4.20 m<sup>2</sup>, kati i parë, të cilat janë regjistruar në hipotekë në pronësi të bashkëshortit të subjektit në datën 26.4.2021, sipas kartelave përkatëse të pasurive.

**32.** Në lidhje me ndërtimin e objektit dhe periudhat e investimeve, u konstatua se:

- Bazuar në të dhënat e administruara, Komisioni është ndodhur përpara faktit të ndërtimit të një banese pa leje ndërtimi. Gjatë procesit të rivlerësimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi ndërtimin e objektit dykatëshe pa një leje ndërtimi, sipas parashikimeve në nenin 31 të ligjit nr. 7693, datë 6.4.1993, “Për urbanistikën”. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se *për shkak të situatës kaotike në vitin 1997, objektin e tyre e zunë persona të panjohur dhe pas nxjerrjes forcërisht të tyre, u detyruan të prishnin objektin e ish-zdrukhëtarisë dhe të nisnin ndërtimin e banesës, të paktën si karabina afër fundit të vitit 1998. Më tej, subjekti ka sqaruar se zona ku ata kanë ndërtuar sipas planit urbanistik të Tiranë, ishte zonë e planifikuar për ndërtim banesash dhe se ata ndërtuan mbi objektin ekzistues, në pronësi të tyre. Për shkak të nevojave për strehim në kushte të vështira në fund të vitit 1998, në këtë banesë u fut për të jetuar bashkëpronari A. A. (babai i subjektit) dhe në vitin 2000 u strehuan edhe ata.*

- Gjatë hetimit nuk u administruan dokumente shpresore që të vërtetojnë periudhën/periudhat e ndërtimit të objektit dhe, për këtë arsye, Komisioni iu referua deklarimeve të subjektit, sipas të cilave rezultoi se:

i) Në DPFDF-në për vitin 2003 deklarohet se ndërtimi ka filluar në fund të vitit 1996.

ii) Në vetëdeklarimin për legalizim të datës 23.3.2005 dhe vetëdeklarimin e datës 11.9.2006, deklaruesit S. R. Ç., A. Ç., A. A. dhe A. Ç., deklarojnë se në mars të vitit 1997 kanë ndërtuar një objekt banimi me dy kate.

iii) Në DPV-në e vitit 2016 deklarohet i ndërtuar në vitet 1996 – 2000.

<sup>10</sup>Ky shpenzim nuk i përket periudhës së rivlerësimit, pasi subjekti ka qenë në një detyrë që nuk i nënshtrohet rivlerësimit, për periudhën mars 2011 – nëntor 2016. Por, nga ana e Komisionit është kryer një analizë financiare për këtë periudhë, sipas së cilës duket se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e pjesës takuese të kësaj pasurie, sikurse trajtuar në rubrikën “konstatime të tjera”.

<sup>11</sup>Shihni dokumentin bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

iv) Në sqarimet e dhëna në ILDKPKI, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar<sup>12</sup> se së bashku me vëllezërit dhe vjehrrin kanë nisur ndërtimin e shtëpisë me 2 kate me sip. trualli 568.4 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 243.9 m<sup>2</sup> në vitin 1996 dhe përfunduar në vitin 2000, legalizuar në 2014.

v) Në deklaratën *Vetting* deklarohet e vetëndërtuar pjesë-pjesë që në vitin 1996.

vi) Në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: “...në maj të vitit 2000 filloi punë në Gjykatën e Lartë dhe në gusht të vitit 2000 kemi ardhur me banim në Tiranë, duke banuar fillimisht te prindërit e mi, derisa bashkëshorti me dy vëllezërit e tij përfunduan banesën private, në rrugën ‘\*\*\*’, \*\*\*, Tiranë...”.

vii) Gjatë hetimit administrativ<sup>13</sup>, duke deklaruar se ndërtesa kishte nisur në vitin 1997 dhe ishte ndërtuar të paktën si karabina në fund të vitit 1998, subjekti ka sqaruar se objekti është ndërtuar fillimisht kati I, më pas kati II si karabina. Sipas saj, pas ndarjes me short të pjesëve midis bashkëpronarëve, ku secili ishte i lirë të kryente më vete punimet e brendshme të banesës, punimet e brendshme të saj kanë filluar pas muajit maj 1999, që është fillimi i punës së bashkëshortit në Tiranë, më 1.5.1999. Më tej, subjekti ka sqaruar se në maj të vitit 2000 filloi edhe ajo punë në Gjykatën e Lartë dhe në gusht të vitit 2000 kanë ardhur në Tiranë, duke banuar fillimisht te prindërit e saj, derisa u përfundua banesa (për vitin e ri). Subjekti ka paraqitur urdhrin nr. \*\*\*, datë 10.5.2000, me të cilin është caktuar ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë dhe tri foto të objektit, ku nuk evidentohet data e fotografimit.

- Nga informacioni i paraqitur nga ASIG<sup>14</sup>, vërehet se në *ortofoton* e vitit 1999 ka një objekt të ndërtuar, i cili duket njësoj edhe në *orotofoton* e vitit 2001. Ndërsa në *orotofoton* e vitit 1994 objekti i ndërtuar duket shumë më i vogël krahasimisht me vitet 1999 dhe 2001. Këto fakte tregojnë se në vitin 1999 objekti ka qenë i ndërtuar. Ndërkohë, nuk ka të dhëna në lidhje me gjendjen e objektit në vitin 1997 dhe 1998. Ndërsa në *orotofotot* e viteve 2007, 2015 dhe 2018, nisur nga lartësia e objektit, bëhet fjalë për një ndërtesë dykatëshe, e cila nuk ka pësuar ndryshime në këto vite, fakt që tregon se nuk janë kryer investime në këtë periudhë.

**33.** Në lidhje me vlerën e investimeve të kryera në objekt, u konstatua se:

- Në deklaratën për vitin 2003, në DIPPFD-në për vitin 2016 dhe në deklaratën *Vetting*, si vlerë e banesës është deklaruar shuma prej 3.000.000 lekësh.

- Në procesverbalin e datës 7.2.2017, kur është pyetur nga ILDKPKI-ja, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se *qartëson se nuk ka paguar për blerjen e sipërfaqes së truallit, por për pjesën tij të banesës, ka shpenzuar shumën 3.000.000 lekë*, sipas situacionit të punimeve nga ing. D.S. dhe fotove, por këto akte nuk janë pjese e dosjes së ILDKPKI-së. Në këto kushte, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor si: situacion punimesh/preventiv punimesh, aktkolaudimi, kontratë ndërtimi etj., për ndërtimin e shtëpisë së banimit 2 kate, për vlerën e deklaruar prej 3.000.000 lekësh.

- Në përgjigjet të pyetësorëve, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokument shkresor për të vërtetuar sasinë e punimeve, ndër vite, apo vlerën e investimeve.

- Në kushtet e mospërputhjes në deklarime në lidhje me vitin/vitet e ndërtimit të objektit, si dhe në mungesë të një informacioni dhe dokumentacioni shkresor tekniko-ligjor për sasinë e punimeve të kryera dhe për vlerën e investimit për çdo vit, referuar edhe faktit që mungojnë *ortofoto* të vitit 1997 dhe vitit 1998, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konsideruar si kohë të ndërtimit të banesës marsin e vitit 1997, sikurse është pasqyruar në

<sup>12</sup>Shihni sqarimet e dhëna nga subjekti, sipas procesverbalit të datës 7.2.2017, në ILDKPKI, bashkëngjitur shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2020, të ILDKPKI-së, në dosjen e Komisionit.

<sup>13</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 dhe pyetësorit nr. 5, në dosjen e Komisionit.

<sup>14</sup>Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2022, nga \*\*\* dhe dokumentacionin bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

formularin e vetëdeklarimit të ALUIZNI-t. Vlera e investimit sipas çmimeve të EKB-së për pjesën takuese të subjektit prej 123.76 m<sup>2</sup>, është 2.050.332 lekë (çmimi për sipërfaqe ndërtimi në qytetin e Tiranës, për vitet 1996 dhe 1997, është përcaktuar 16.567 lekë/m<sup>2</sup>, në bazë të VKM-së nr. 13, datë 5.1.1998).

- Siç vërehet, vlera deklaruar nga subjekti prej 3.000.0000 lekësh, është më e lartë se vlera e pjesës së tij takuese, sipas çmimeve të referencës të EKB-së. Por, në kushtet kur subjekti në çdo deklaratë ka deklaruar vlerën 3.000.000 lekë, konfirmuar nga bashkëshorti në pyetjen në ILDKPKI, në vitin 2016, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konsideruar si shpenzim të investimit në pasuri, vlerën prej 3.000.000 lekësh.

**34.** Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar kursime nga pagat në vite dhe të ardhura nga aktivitet privat, i njëjti burim krijimi i deklaruar edhe në deklaratën e vitit 2003 dhe DIPFD-në e vitit 2016. Në përgjigjet e pyetësorëve nr. 2 dhe 3, subjekti ka qartësuar se si burim krijimi kanë shërbyer: të ardhura nga aktiviteti privat i vjehrrit dhe bashkëshortit; të ardhura nga pensionet e tyre; si dhe të ardhura nga bujqësia.

**35.** Komisioni kreu verifikime, në lidhje me secilin prej burimeve të deklaruara, si vijon:

**35.1.** Në lidhje me të ardhura të vjehrrit R. Ç., rezultoi se:

- Në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe 3, subjekti ka deklaruar se vjehri R. Ç. ka ushtruar aktivitet (shitës), në fshatin \*\*\*, sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 27.7.1993, të Gjykatës së Rrethit Gramsh. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2020, pas kërkesës së subjektit, Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan ka informuar se: "*Subjekti (R. Ç.) për periudhën 29.7.1993 – 31.8.1999 ka qenë i regjistruar, por për shkak të situatës të vitit 1997 nuk disponojnë dokumentacion për këtë subjekt*". Në mungesë të të dhënave, subjekti ka përllogaritur të ardhura të vjehrrit nga ushtrimi i këtij aktiviteti, duke konsideruar afërsisht pagën mesatare të asaj periudhe, në referim të VKM-ve përkatëse të atyre viteve<sup>15</sup>. Sipas këtyre përllogaritjeve ka rezultuar se të ardhurat e përfituara nga vjehri për periudhën 6-vjeçare ishin në shumën 606.720 lekë, pavarësisht se subjekti ka pretenduar se të ardhurat reale kanë qenë disa herë më të mëdha dhe kjo për faktin se njësia e tregtimit të artikujve ushqimorë ka qenë e vetme në fshat dhe në gjithë zonën. E pyetur mbi vërtetimin e këtyre pagave të vjehrrit nga ISSh-ja, subjekti ka deklaruar se ato mungojnë si pjesë e dosjes në organet tatimore. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur disa akte shkresore<sup>16</sup>.

- Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan, e cila i referohet situatës së vitit 1997, nuk qartëson rrethanat se përse mungon dokumentacioni, pasi nuk jepet ndonjë arsye konkrete për humbjen apo zhdukjen se tyre. Gjithashtu, mbetet e paqartë nëse është ushtruar aktivitet nga R. Ç. në vitet 1998, 1999 dhe 2000.

- Bazuar në të dhënat e administruara, në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me të ardhura të aktivitetit privat të vjehrrit, u konstatua se: (i) subjekti ka vërtetuar regjistrimin e aktivitetit privat në datën 29.7.1993; (ii) nuk ka vërtetuar ushtrimin e aktivitetit dhe periudhën përkatëse; (iii) nuk ka vërtetuar të ardhura nga ushtrimi i aktivitetit privat; (iv) nuk është provuar pagesa e detyrimeve tatimore për aktivitetin e ushtruar; (v) nuk është paraqitur vërtetim

<sup>15</sup>Në përgjigje të pyetjes 3/c, të pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur një tabelë e cila bazohet në disa VKM dhe konkretisht: nr. 452, datë 16.9.1993; nr. 610, datë 31.12.1993; nr. 42, datë 23.1.1995; nr. 180, datë 18.3.1996; dhe nr. 20, datë 13.1.1997, duke evidentuar në këtë tabelë pagën minimale dhe atë maksimale për çdo vit, për periudhën janar 1993 – dhjetor 2000.

<sup>16</sup>Certifikatë ushtrimi profesioni nr. \*\*\*, datë 29.7.1993, sipas së cilës vërtetohet se shtetasi R. Ç. ka ushtruar veprimtari private si shitës në një lokal, në \*\*\*, sipas vendimit nr. \*\*\*, datë 27.7.1993, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan; vërtetim të datës 2.3.2022 të kryetarit të fshatit \*\*\*, Gramsh, i cili vërteton faktin e ushtrimit të aktivitetit për vitet 1993 – 1997 dhe se ky dyqan ka qenë i vetëm për zonën; vendim gjyqësor nr. \*\*\*, datë 28.7.1995, ku përcaktohet se në anën e djathtë të portës (kur hyn) është ndërtuar prej kërkuesit R. Ç. një dyqan 3x4 m, ndërtuar me mur tulle, mbuluar me eternit.

nga ISSh-ja mbi pagën e vlerësueshme mbi të cilën paguhen sigurime shoqërore. Bazuar në këto të dhëna nuk u vërtetuan të ardhura nga aktiviteti privat i vjehrrit R. Ç.

**35.2.** Në lidhje me të ardhura të bashkëshortit A. Ç., rezultoi se:

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se: *“Bashkëshorti A. Ç. për vitin 1997, ka qenë i pajisur me licencë të përkohshme nr. \*\*\*, datë 15.1.1997, si ekspert kontabël i autorizuar, ndërkohë që ushtronte detyrën e Përgjegjës të Seksionit të Financës në Bashkinë Gramsh”*.

Subjekti ka informuar se bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.3.1997, të Degës së Tatim Taksave Gramsh, bashkëshortit i është kërkuar sipas ligjit që të bëjë ekspertimin kontabël të bilanceve të vitit 1996 të disa subjekteve tregtarë, pasi, sipas subjektit, në rrethin e Gramshit ishte i vetmi i licensuar për kryerjen e këtij misioni. Pas kërkesës së subjektit mbi të ardhurat dhe fitimet e realizuara prej tij, DRT-ja Elbasan, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2020, informoi se *nuk dispononin asnjë të dhënë për periudhën 1997-1998*. Sipas përlllogaritjeve të subjektit, bazuar në urdhëresat që rregullojnë kohën e ekspertizës së ekspertit kontabël dhe honorarët e tyre, të ardhurat e përfituara në vitin 1997 kanë qenë në shumën 630.000 lekë<sup>17</sup>. Përveç kësaj, subjekti deklaroi se bashkëshorti ka kryer edhe disa ekspertime të tjera kontabël të ndërmarrjeve në varësi të bashkisë, kundrejt përfitimit të honorarëve, por për shkak të mungesës së dokumentacionit, si pasojë e trazirave të 1997, nuk mund të vërtetohet shuma e tyre.

- Bashkia Elbasan ka informuar se<sup>18</sup> shtetasi A. Ç. nuk është i regjistruar në sistemin e DTTV-së, pranë Bashkisë Elbasan.

- Më tej, gjatë hetimit administrativ, subjektit iu kërkuar të paraqesë licencën e ushtrimit të aktivitetit dhe vërtetim mbi pagesën e tatimeve për të ardhurat e marra si ekspert kontabël. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, duke dhënë të njëjtat sqarime si në pyetësorin e mëparshëm mbi mungesën e të dhënave nga organet tatimore lidhur me veprimtarinë e bashkëshortit të saj si ekspert kontabël i autorizuar, subjekti deklaroi se shkresa nr. \*\*\* prot., datë 5.3.1997, e degës së Tatimeve Gramsh vërteton faktin që bashkëshorti është person i regjistruar në organet tatimore, pasi vetë autoriteti që ka detyrimin ligjor që të kontrollojë pagesën e detyrimeve tatimore e ka ngarkuar me kryerjen e këtij funksioni. Për të mbështetur këto pretendime, subjekti ka paraqitur në të dy pyetësorët disa dokumente shkresore<sup>19</sup>.

- Subjekti, për të justifikuar legjitimitetin e ushtrimit të auditimit financiar nga bashkëshorti, ka paraqitur pjesë nga urdhëresa nr. \*\*\*, datë 2.10.1995, e Këshillit të Ministrave *“Për organizimin e profesionit të ekspertëve kontabël të autorizuar”*. Sipas kësaj urdhërese, në nenin 94, paragrafi i 1-rë ka një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, sipas të cilit: *“Papajtueshmëria e funksionit të ekspertit kontabël të autorizuar me postin e të punësuarit, nuk do të zbatohet për punonjës të shquar të administratës shtetërore...”*. Ndërsa, në paragrafin e 2-të të tij, përcaktohet se nga ky përjashtim nuk përfitojnë punonjësit e organeve tatimore dhe të organeve të tjera të kontrollit shtetëror, të cilët janë në kushtet e papajtueshmërisë me funksionin e ekspertit kontabël në rast ushtrimi të funksionit.

<sup>17</sup>Shihni përgjigjet në pikën 1.8, të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

<sup>18</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.07.2017, në Aneksin \*\*\*, të administruar në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>19</sup>Shihni: vendim nr. \*\*\*, datë 15.3.1994, *“Për krijimin e grupit të ekspertëve kontabël të pavarur”*; tri raporte auditimi për vitin ushtrimor 1996<sup>19</sup> të kryera nga bashkëshorti i subjektit; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2020, nga DRT-ja Elbasan, sipas të cilës nuk disponohet asnjë e dhënë për z. A. Ç., për vitet 1997-1998; licencë e përkohshme nr.\*\*\*, datë 15.1.1997, dhënë z.A.Ç., për ushtrimin e profesionit të ekspertit kontabël me vlefshmëri deri më 31.5.1997; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 5.3.1997, lëshuar nga Dega e Tatim Taksave Gramsh, mbi listat e subjekteve që do t'i nënshtrohen kontrollit nga ana e ekspertëve kontabël për bilancet e vitit 1996. Konkretisht, kjo shkresë, liston 18 subjekte dhe xhiron e parashikuar të tyre, të cilat i ngarkohen ekspertit A. Ç. për kontroll.

- Duke qenë përpara faktit që bashkëshorti i subjektit A. Ç. është ngarkuar nga Dega e Tatimeve dhe Taksave Gramsh për kontrollin e bilanceve të disa subjekteve juridikë, për të qartësuar situatën, Komisioni i ka kërkuar DPT-së një interpretim më të plotë të ligjit në lidhje me kompetencën e bashkëshortit të subjektit për të kryer auditimin në mars të vitit 1997, si dhe arsyen e mungesës së dokumentacionit në dosjen e tatimpaguesit për vitet 1997-1998.

- Në përgjigje të kësaj kërkesë, DPT-ja informoi<sup>20</sup> se ky organ nuk është kompetent për interpretimin e bazës ligjore të ushtrimit të funksionit të ekspertit kontabël, ndërkohë që sipas tyre, lidhur me mungesën e dokumentacionit në dosje, do të shprehet DRT-ja Elbasan.

- Në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2022, DRT-ja Elbasan ka informuar se: “... për vitet 1997-1998 ....në arshivën e DRT-së Elbasan nuk disponohet dokumentacion i arshivuar për këtë periudhë”.

- Bazuar në sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, u konstatua se: (i) bashkëshorti i subjektit ka qenë i licencuar si ekspert kontabël për periudhën kur ai pretendon të ardhura; (ii) ka provuar se është ngarkuar/urdhëruar nga Dega e Tatim Taksave Gramsh, të kryejë auditimin financiar e 18 subjekteve tregtarë; (iii) subjekti ka përllogaritur në mënyrë të saktë të ardhura të përfituara si ekspert kontabël në formën e honorarëve, bazuar në aktet që rregullojnë mënyrën e organizimit të ekspertëve kontabël të autorizuar dhe pagesat e tyre; (iv) ka provuar auditimin e tri shoqërive tregtare; (v) nuk ka të dhëna mbi pagimin e tatimeve mbi të ardhurat nga bashkëshorti i subjektit si ekspert kontabël dhe informacioni i paraqitur nga DRT-ja Elbasan nuk jep asnjë arsye mbi mosdisponimin e dokumenteve, humbjes apo zhdukjes se tyre. Bazuar në këto të dhëna, nuk u vërtetuan të ardhura të ligjshme nga aktiviteti i bashkëshortit si ekspert kontabël dhe, për rrjedhojë, ato nuk janë përfshirë si burim në analizën financiare.

**35.3.** Në lidhje me të ardhura të secilit prej anëtarëve të familjes së bashkëshortit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka vërtetuar të ardhura të përfituara nga pensioni i pleqërisë për babanë e bashkëshortit R. Ç., për periudhën 1.1.1991 – 31.12.2000<sup>21</sup> dhe, për këtë arsye, pensioni i vjehrrit është përfshirë në analizën financiare para DPF-së, në vitin 2003. Subjekti nuk ka paraqitur dokumente mbi të ardhura nga pensioni i vjehrrës D. Ç.

**35.4.** Në lidhje me të ardhura nga toka bujqësore, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar si burim edhe të ardhura të përfituara nga shfrytëzimi i tokës prej 3 dynym gjatë kohës që kanë banuar në fshat dhe në Gramsh, të ardhura nga blegtoria, pemëtaria, bletaria etj., për të cilat kujdeseshin prindërit e bashkëshortit, të cilët deri në vitin 2000 bashkëjetonin me familjen e subjektit. Për këtë periudhë, sipas subjektit, shpenzimet për jetesë përballoheshin nga të ardhurat nga fshati. Më tej, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumente mbi pronësinë e tokës, prodhimet dhe të ardhurat nga përdorimi i saj dhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka informuar se vjehrrit i saj ka pasur në pronësi tokë me sipërfaqe 3 dynym, 199 m<sup>2</sup> truall+arë, dhe një banesë dykatëshe. Gjatë kohës që kanë jetuar në Gramsh kanë pasur pemë frutore, blegtori dhe 20 koshere bletë, nga të cilat kanë përfituar prodhime duke plotësuar nevojat për jetesë të familjes dhe realizuar të ardhura nga përdorimi i tokës sipas vlerave të paraqitura në një tabelë. Për të mbështetur pretendimet e saj, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresorë<sup>22</sup>, midis të cilave edhe një aktekspertim, ku janë përllogaritur të ardhura vjetore *neto* të familjes Çarçiu nga pemët drufrutore.

<sup>20</sup>Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2022, nga DPT-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>21</sup>Shihni vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 2.3.2022, nga DRSSH-ja Elbasan, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3.

<sup>22</sup>Aktin “Vlerësimi i llojeve drufrutorë që janë mbuluar nga pasqyra ujore e rezervuarit të HEC-it B.”, nga 2 ekspertë të licensuar F. L. dhe L. Sh.; vendim gjyqësor nr. \*\*\*, datë 28.7.1995, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh; certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 26.2.2008, për arë+truall sip. 3.199 m<sup>2</sup>, në Gramsh, \*\*\*; kartela e pasurisë ku evidentohet shpronësimi dhe kalimi në pronësi të Ministrisë së Ekonomisë i pasurisë arë+truall, me sip 3.199 m<sup>2</sup>; VKM-ja nr. 656, datë 26.9.2012, ku, ndër të tjera, evidentohet edhe shpronësimi i shtetasit R. Ç., në vlerën 2.334.224 lekë.



- Nga analiza e shpjegimeve dhe dokumenteve të mësipërme, rezultoi se: (i) vjehri i subjektit ka pasur në pronësi tokë me sipërfaqe 3.199 m<sup>2</sup> truall+arë, të ndodhur në fshatin \*\*\*, Gramsh; (ii) familja Çarçiu është marrë me blegtori dhe pemëtari; (iii) nuk është provuar pagesa e taksës së tokës bujqësore; (iv) nuk është provuar pagesa e kontributeve të prindërve si të vetëpunësuar në bujqësi (nëse është rasti); (v) nuk është provuar me dokumente shitja e produkteve bujqësore dhe blegtorale; (vi) subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në deklarata të tjera të ardhura nga toka bujqësore.

- Bazuar në sa më sipër, në analizën financiare të kryer në përfundim të hetimit administrativ, nuk janë konsideruar të ardhura nga bujqësia. Për më tepër, në deklaratën *Vetting* nuk janë deklaruar si burim të ardhurat nga bujqësia.

### Analiza financiare

36. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka kryer analizën financiare për periudhën 1991 – mars 1997, pasqyruar në tabelën më poshtë, sipas së cilës, duket se subjekti dhe bashkëshorti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të investuar shumën 3.000.000 lekë, për ndërtimin e pjesës takuese të banesës në \*\*\*.

Përshkrimi	Ndërtimi i shtëpisë në mars 1997
<b>Pasuri</b>	<b>3 000 000</b>
Dy apartamente nga banesa dykatëshe, ***, Tiranë	3 000 000
<b>Të ardhura dokumentuar</b>	<b>1 343 597</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	732 150
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	470 152
Pensioni i babait të bashkëshortit	141 295
Nga puna e bashkëshortit si ekspert kontabël	-
Nga aktiviteti privat i vjehrit	-
<b>Shpenzime</b>	<b>886 774</b>
Shpenzime jetese	886 774
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-2 543 177</b>

Megjithatë edhe nëse do të kryheshin përlllogaritjet sipas variantit të deklarimeve të subjektit se banesa është ndërtuar në vitet 1996 – 2000<sup>23</sup>, subjekti dhe bashkëshorti kanë qenë në pamundësi financiare për të justifikuar vlerën prej 3.000.000 lekësh, për shkak të një balance negative në vlerën prej 1.783.533 lekësh.

37. Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me pasurinë, banesë, në \*\*\*, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës të japë sqarime dhe të paraqesë dokumente në lidhje me konstatimet, duket se:

- i) subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë në deklaratën *Vetting* pjesën takuese të saj dhe bashkëshortit në këtë pasuri;
- ii) ka kryer deklarime të ndryshme në lidhje me vitin e ndërtimit të objektit;
- iii) ka paqartësi për mënyrën e përfitimit të truallit nga dy bashkëpronarët e fillestarë të godinës së ish-zdrukhëtarisë, si dhe vazhdimësisë së zotërimit të truallit deri në momentin e aplikimit pranë ALUIZNI-t;

<sup>23</sup>Për shkak të shpjegimeve të paqarta të subjektit dhe në mungesë të një dokumentacioni tekniko-ligjor, Komisioni ka kryer ndarjen e volumnit të ndërtimit, ndër vite, duke u bazuar në logjikën e zhvillimit të një projekti ndërtimor dhe në përpjekje për të kuptuar shpjegimet e subjektit, si në deklaratat e mëparshme ashtu edhe ato të kryera gjatë hetimit administrativ. Kështu, është prezumuar se ndërtimi i karabinasë, i deklaruar nga subjekti si i ndërtuar gjatë viteve fund 1996-1998, përbën 60% të volumnit ndërtimor, ndërsa pjesa e mbetur e prej 40% është ndarë në mënyrë të barabartë për secilin nga vitet 1999 dhe 2000, meqenëse subjekti ka deklaruar se ndërtimi ka vazhduar përgjatë viteve 1999 (kur bashkëshorti i subjektit ka ardhur në Tiranë), dhe në vitin 2000.

iv) objekti është ndërtuar pa leje ndërtimi, sipas kërkesave të parashikuara në nenin 31 të ligjit nr. 7693, datë 6.4.1993 “Për urbanistikën”, në vitin 1997, periudhë kur subjekti ka qenë gjyqtare në Gramsh;

v) subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të investuar shumën 3.000.000 lekë, për ndërtimin e banesës objekt verifikimi.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

**38.** Në lidhje pasaktësinë e deklaramit të pjesës takuese të pasurisë objekt verifikimi në deklaratën *Vetting*, subjekti ka sqaruar se sipërfaqja ndërtimore e banesës dykatëshe është 487.8 m<sup>2</sup>, pra, 243.9 m<sup>2</sup> x 2 dhe se, ajo ka deklaruar saktësisht sipas certifikatës dhe kartelës së pasurisë, pasi familja e saj ka në pronësi 123.76 m<sup>2</sup>, pra, 25% ose ¼ pjesë takuese të sipërfaqes së përgjithshme, shpjegim i cili qëndron, referuar certifikatave të pronësisë të apartamenteve të ndërtesës, sipas së cilave secili prej bashkëpronarëve të ndërtesës dykatëshe ka në pronësi nga dy apartamente, duke gëzuar nga ¼ pjesë takuese të ndërtesës.

**39.** Në lidhje me deklaramet e ndryshme mbi vitin e ndërtimit të objektit, subjekti ka parashtruar se të gjitha deklaramet e saj, pavarësisht se bëjnë fjalë për një fakt të ndodhur 25 vjet më parë, janë në unitet me njëra-tjetrën dhe provojnë faktin se ndërtimi është kryer nga fundi i vitit 1996 – deri në fund të vitit 2000. Këto fakte, sipas saj, gjejnë mbështetje edhe nga informacioni i paraqitur nga ASIG, sipas të cilit rezulton se objekti ka qenë i ndërtuar në vitin 1999, fakt që përputhet me deklaramin e saj se deri në fund të vitit 1998 ka përfunduar karabinaja. Në këtë mënyrë, subjekti kundërshtoi konsiderimin e ndërtimit të objektit në mars të vitit 1997, duke kërkuar që si periudhë e kryerjes së punimeve të konsiderohen vitet 1997 – 2000.

Në analizë të këtyre pretendimeve, Komisioni çmoi se ato janë bindëse, pasi subjekti ka qenë konsistente në deklaramet ndër vite si dhe gjatë procesit të rivlerësimit sa i takon periudhës së ndërtimit të godinës, ku ka deklaruar periudhën 1996 – 2000. Këto deklarime të subjektit, të cilat përbejnë provë shkresore, sipas nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim u vlerësuan me një peshë specifike më të madhe krahasimisht me vetëdeklarimin për legalizim të paraqitur nga bashkëpronarët e objektit/bashkëshorti dhe të tjerë, sipas së cilit objekti është ndërtuar në mars të vitit 1997. Për më tepër, deklarimi në DPDFD-në për vitin 2003, ku subjekti ka deklaruar se ndërtimi ka filluar në fund të vitit 1996, e bën të pabesueshëm faktin që objekti mund të jetë ndërtuar brenda tre muajve, deri në mars të vitit 1997, sipas vetëdeklarimeve.

**40.** Në lidhje me paqartësitë mbi mënyrën e përfitimit të truallit nga dy bashkëpronarët e fillestarë të godinës së ish-zdrukhëtarisë, si dhe vazhdimësisë së zotërimit të truallit deri në momentin e aplikimit pranë ALUIZNI-t, subjekti ka parashtruar të njëjtat fakte, sikurse ka sqaruar edhe gjatë procesit të rivlerësimit se kunati i saj S. Ç., pranoi që në objektin e blerë prej tij (pjesën e tij takuese), në fund të vitit 1996, të ndërtonin përveç tij edhe dy vëllezërit e tjerë. Sipas subjektit, pavarësisht se është ndërtuar në mënyrë informale, kunati i saj nuk e ka zaptuar truallin, pasi ka privatizuar godinën dhe ka paguar qira për përdorimin e truallit poshtë saj, sikurse parashikohet në kontratën e shitjes. Sipas saj, pavarësisht përpjekjeve për të përfituar truallin poshtë ndërtesës, nuk është bërë e mundur blerja e truallit me sip. 567 m<sup>2</sup> dhe, për këtë arsye, pronësia mbi këtë truall është fituar bazuar në parashikimet ligjore të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, për legalizimin.

Në përfundim të procesit, Komisioni nuk evidentoi problematika, që kanë lidhje me subjektin e rivlerësimit, për sa i takon përfitimit të pronësisë mbi truallin e objektit. Për më tepër, u vërtetua që dy bashkëpronarët fillestarë të godinës së ish-zdrukhëtarisë, fillimisht kanë fituar pronësinë e godinës, duke përdorur dhe truallin poshtë saj me qira, deri në momentin kur me nisjen e procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje iu hap rrugë edhe kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore.

**41.** Në lidhje me konstatimin për ndërtimin objektit pa leje ndërtimi, sipas kërkesave të parashikuara në nenin 31 të ligjit nr. 7693, datë 6.4.1993, “Për urbanistikën”, në vitin 1997, periudhë kur subjekti ka qenë gjyqtare në Gramsh, subjekti ka argumentuar se ndërtimi i objekteve informale ishte një fenomen që përfshiu gjithë shoqërinë shqiptare në vitet 1990 dhe se ligji nr. 7693, datë 6.4.1993 “Për urbanistikën”, mbeti pa efekt, sepse nuk u respektua nga pothuajse e gjithë popullsia shqiptare, prandaj ligji “Për legalizimin” e ka amnistuar këtë fenomen. Sipas saj, asnjë subjekt nuk mund të mbajë përgjegjësi administrative për kundërvajtjet administrative<sup>24</sup>, të cilat sanksionoheshin me masë gjobë deri në shumën 10.000 lekë, për veprime të kryera përpara 22 vjetësh, për shkak të parimit të sigurisë juridike. Përveç kësaj, ajo ka sqaruar se në rastin konkret, banesa është ndërtuar në mbi një truall në përdorim me qira nga ana e familjes së bashkëshortit të saj, mbi të cilin ka pasur një objekt ekzistues.

Në përfundim të procesit, në vlerësim të argumentave të subjektit dhe rrethanave në të cilat është ndërtuar dhe legalizuar objekti, Komisioni nuk e çmoi ndërtimin e objektit pa një leje ndërtimi si shkak penalizues për subjektin.

**42.** Në lidhje me vlerën e investimit të banesës, subjekti ka pretenduar se në kushtet kur ndërtesa nuk ka një çmim të përcaktuar të parashikuar në ndonjë kontratë apo akt tjetër provues, vlera 3.000.000 lekë e deklaruar është bazuar në një vlerësim subjektiv, duke menduar se kjo ka qenë vlera e tregut të pjesës së tyre takuese në momentin e deklarimit, pra, në vitin 2003. Ky pretendim nuk qëndron, pasi vlera e tregut, bazuar në çmimin e referencës, sipas EKB-së, për blerjen e një apartamenti në qytetin e Tiranës për vitin 2003, ka qenë 53.450 lekë/m<sup>2</sup>, çka bën që vlera e dy apartamenteve të subjektit, në rast se do t'i shiste ato, do të ishte 6.614.972 lekë.

Ndërkohë, subjekti bie dakord me Komisionin sa i takon mënyrës së ndarjes së volumeve ndërtimore, ndër vite, duke përdorur çmimet të EKB-së, por kërkon që koha për ndërtimin e banesës të shtrihet për periudhën 1997 – 2000, duke u reduktuar me 30%<sup>25</sup> dhe kosto e ndërtimit të banesës së saj të konsiderohet vlera prej 1.727.494 lekësh.

Në përfundim, Komisioni konsideroi si periudhë ndërtimi periudhën 1997 – 2000, sikurse subjekti ka pretenduar. Ndërsa sa i takon vlerës së investimeve, Komisioni çmoi se, ndonëse vlera sipas çmimeve të EKB-së është më të ulët se 3.000.000 lekë, subjekti ka kryer punime me kosto më të larta se këto çmime dhe në vlerësimin përfundimtar, si vlerë investimi konsideroi shumën prej 3.000.000 lekësh, referuar fakteve e rrethanave si vijojnë: (i) ka mungesë të dokumentacionit tekniko-ligjor që të tregojë vlerën e investimeve; (ii) subjekti ka deklaruar në mënyrë konsistente si vlerë të pasurisë shumën prej 3.000.000 lekësh, duke filluar me deklaratën për vitin 2003, duke vijuar me deklaratën për vitin 2016 dhe deklaratën *Vetting*; (iii) bashkëshorti i subjektit pranë ILDKPKI-së në procesverbalin, datë 7.2.2017, ka deklaruar se vlera e shpenzuar për pjesën e tij takuese ka qenë 3.000.000 lekë; (iv) pretendimi i subjektit se i është referuar vlerës së tregut nuk qëndron, pasi vlera e tregut ka qenë 2 herë më e lartë se vlera prej 3.000.000 lekësh.

**43.** Në lidhje me konstatimin mbi pamundësinë me të ardhura të ligjshme për të investuar shumën 3.000.000 lekë, për ndërtimin e banesës objekt verifikimi, subjekti ka prapësuar konstatimet e Komisionit për secilin prej burimeve të përdorura, trajtuar hollësisht si vijon:

**43.1.** Në lidhje me të ardhurat e vjehrrit R. Ç., subjekti pretendon se është në kushtet e pamundësisë objektive për të vërtetuar këto të ardhura, për shkak të mungesës së dokumentacionit që ka ardhur si pasojë e ngjarjeve të vitit 1997, në Gramsh, ku u shkatërruan e vodhën shumë institucione. Madje edhe pas vitit 1997, sipas subjektit, ruajtja e dokumentacionit në institucionet e Gramshit ka qenë i vështirë. Sipas saj, në kushtet kur

<sup>24</sup>Ndërtimi pa leje u parashikua për here të parë si kundërvajtje penale në Kodin Penal vetëm në vitin 2009.

<sup>25</sup>Subjekti konsideron se kjo përqindje përfaqëson vlerat e fitimit, TVSh-së dhe kosto projekti, që në rastin e saj nuk janë aplikuar, pasi banesa është ndërtuar nga familjarët dhe individë-ustallarë që janë paguar me ditë pune.

dokumentacioni nuk është i plotë është e pamundur të përcaktohet saktësisht vlera e fitimit *neto* të realizuar nga aktiviteti i vjehrrit për vitet 1993 – 1999 dhe, për këtë arsye, *përlllogaritjet duhet të kryen në mënyrë alternative, të paktën në nivelin minimal të të ardhurave, pra, në fashën minimale mbi bazën e të cilit përlllogaritjet tatimi për biznesin e vogël.*

Në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti ka paraqitur disa dokumente<sup>26</sup> midis të cilave shkresën e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, e cila informon se: *“Si pasojë e hapjes së depove të armëve dhe trazirave të krijuara, në datën 10.3.1997, është sulmuar edhe djegur fillimisht Komisioni i Policisë Gramsh dhe, më pas, edhe institucione të tjera, së bashku me to edhe mjaft subjekte private. Në mjaft raste këto veprime janë shoqëruar me plaçkitje e djegie të materialeve që ndodheshin në godinën e këtyre institucioneve...”*.

Në analizë të provave të administruara gjatë gjithë hetimit administrativ, në përfundim të procesit, në kushtet kur Drejtoria Rajonale Tatimore Elbasan e lidh mungesën e dokumentacionit me ngjarjet e vitit 1997, bazuar në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerësoi se subjekti është në kushtet e pamundësisë objektive për të provuar të ardhura konkrete nga aktiviteti i vjehrrit gjatë viteve 1993 – 1997. Por, nuk e gjen të bazuar këtë pretendim në asnjë provë e dokument, për vitet 1998 dhe 1999. Për këtë arsye, Komisioni çmon të konsiderojë në analizën financiare për ndërtimin e banesës, të adhurua të ligjshme nga aktiviteti privat i vjehrrit shumë prej 393.336 lekësh, e cila përbëhet nga paga minimale e përcaktuar sipas VKM-ve të viteve 1993 – 1997<sup>27</sup>.

**43.2.** Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit A. Ç., si ekspert kontabël i autorizuar, në vijim të qëndrimit të mbajtur gjatë hetimit administrativ, ka shtuar se:

i) bashkëshorti i saj është urdhëruar që të bëjë ekspertimin kontabël të bilanceve të vitit 1996 nga DRT-ja Gramsh, çka vërteton faktin se ka qenë i regjistruar në organet tatimore dhe ka përmbushur detyrimet tatimore, pasi vetë autoriteti që ka detyrimin ligjor që të kontrollojë pagesën e detyrimeve tatimore e ka ngarkuar me kryerjen e këtij funksioni, prandaj, për këtë arsye, pagesa e detyrimeve tatimore duhet të prezumohet;

ii) ka provuar se është në pamundësi objektive për të provuar me dokumentacion<sup>28</sup> të ardhurat dhe fitimet e realizuara prej bashkëshortit të saj dhe, për këtë arsye, i ka përlllogaritur ato në vlerën 630.000 lekë bazuar në legjislacionin e kohës<sup>29</sup>;

iii) sa i takon pagesës së tatimit mbi të ardhurat si ekspert kontabël, deri sa auditimi është bërë me urdhër të organit që ka si detyrë kontrollin e pagimit të tatimeve, pagesa e detyrimeve tatimore duhet të prezumohet. Kështu, subjekti pretendon se shuma prej 630.000 lekësh duhet të përfshihet si burim i ligjshëm në analizën financiare për ndërtimin e banesës.

Në përfundim të procesit, në lidhje me të ardhura të bashkëshortit si ekspert kontabël, Komisioni çmoi se këto të ardhura nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme për vitin 1997, bazuar në rrethanat si vijojnë:

---

<sup>26</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2022, e Drejtorisë Vendore të Policisë, Elbasan; disa faqe të shtypit lokal, gazeta “\*\*\*\*” ku pasqyrohen ngjarjet e rënda që kanë ndodhur në këtë periudhë në qytetin e Gramshit; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, sipas së cilës informohet se: *“Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gramsh nuk disponon asnjë dokument arshivor përpara vitit 1997, pasi janë djegur nga trazirat e marsit të vitit 1997, ndërsa nga fillimi i vitit 1998 e deri në datën 15.5.2000, nga verifikimi i kodekseve rezulton se nga ana juaj janë gjykuar çështje civile, seksioni familjar dhe çështje penale”*.

<sup>27</sup>Referuar VKM-ve përkatëse të atyre viteve, përkatësisht: nr. 452, datë 16.9.1993; nr. 610, datë 31.12.1993, nr. 42, datë 23.1.1995, nr. 180, datë 18.3.1996; dhe nr. 20 datë 13.01.1997.

<sup>28</sup>Subjekti ka cituar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2020, të DRT-së Elbasan, e përcjellë në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sipas së cilës ky institucion jep përgjigje për z. A. Ç. *“pasi bëme verifikimet në sistemin elektronik të tatimeve apo çdo informacioni dokumentar për periudhën 1997-1998, nuk dispononim asnjë të dhënë”*.

<sup>29</sup>Subjekti i referohet VKM-së nr. 986, datë 30.12.1996, si dhe urdhëresës në zbatim të tij.

i) nuk është provuar fakti nëse bashkëshorti i subjektit ka kryer auditimin e 18 subjekteve tregtare dhe, për më tepër, të ketë marrë pagesë nga ky auditim. Përlllogaritja nga ana e subjektit, e shpërblimeve të marra nga bashkëshorti tregon shumën e të ardhurave që do të duhej të ishte përfituar, por nuk e provon këtë përfitim;

ii) duke qenë funksionar publik, bashkëshorti nuk ka qenë i regjistruar, pasi nuk mund të regjistrohej si subjekt tregtar/profesion i lirë në organet tatimore për të ushtruar profesionin e ekspertit kontabël;

iii) në rast se do të merrej e mirëqenë se këto të ardhura janë përfituar, pavarësisht se ato janë atipike<sup>30</sup>, mbi to do të duhej të ishte paguar tatim në burim në bazë të legjislacionit tatimor. Pagesa e tatimit në burim nuk mund të prezumohet si e kryer për shkak se detyra është urdhëruar nga organi tatimor, për më tepër, në kushtet kur subjekti as nuk ka pretenduar dhe as ka dhënë ndonjë shpjegim nëse është kryer kjo pagesë dhe kur;

iv) subjekti nuk provoi të jetë në kushtet e pamundësisë objektive, pasi vërtetimi i lëshuar nga DRT-ja Gramsh se kjo drejtori *nuk disponon asnjë të dhënë* pa dhënë asnjë arsye të shkaqeve, përafrohet më shumë me përshkrimin e situatës reale të z. A. Ç., pra, që nuk ka qenë i regjistruar në organet tatimore, pasi nuk mund të regjistrohej për shkak se ishte punonjës i administratës shtetërore.

**43.3.** Mbi të ardhurat e nënës së bashkëshortit, znj. D. Ç., subjekti ka paraqitur vërtetim të DR të ISSH Elbasan, e cila informon se ka përfituar pension pleqërie në shumën 350.383 lekë, për periudhën 1.1.1991 – 31.12.2000. Pensioni i vjehrrës së subjektit është përfshirë si burim i ligjshëm në analizën financiare për ndërtimin e shtëpisë.

**43.4.** Në lidhje me të ardhurat nga bujqësia, subjekti ka sqaruar se mungesa e deklarimeve në deklaratën *Vetting* ka qenë sepse këto prodhime janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve të jetesës, ndërkohë që i kërkon Komisionit uljen e këtyre shpenzimeve për periudhën 1991 – 1999, në këtë mënyrë: reduktimin e tyre në masën 30% bazuar në vendimin nr. 15/2021, të Kolegjit<sup>31</sup> dhe vlera që del nga kjo përlllogaritje, duhet të reduktohet me 40%, për shkak se familja e saj ka jetuar në fshat gjatë kësaj periudhe dhe se të gjitha frutat perimet, mishi, vezët apo prodhimet e tjera blektorale, siguroheshin nga toka bujqësore. Subjekti sjell në vëmendje disa vendimmarrje të Komisionit<sup>32</sup>, në të cilat është mbajtur qëndrimi se shpenzimet e jetesës së këtyre familjeve, për shkak të ekonomisë bujqësore, janë më të ulta. Subjekti ka paraqitur vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 31.5.2022, nga Zyra e Taksave Vendore, Njësia Administrative \*\*\*, me anën e të cilit vërtetohet se z. R. P. Ç., ish-banor i fshatit \*\*\*, ka shlyer të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore pranë kësaj njësie.

Nga përmbajtja e vendimeve të Komisionit të referuara nga subjekti, në varësi të specifikave sipas rastit, qëndrimi i përbashkët ka qenë reduktimi i shpenzimeve të jetesës për familjet që kanë jetuar në fshat dhe/ose kanë pasur tokë bujqësore për të cilën kanë provuar se është mbjellë me kultura bujqësore etj., për periudhën 1991 – 1999, kur nuk ka të dhëna zyrtare nga INSTAT.

<sup>30</sup>Në fillimet e tij ushtrimi i profesionit të ekspertit kontabël rregullohej nga legjislacioni për shoqëritë tregtare, sikurse të gjitha subjektet e tjera tregtare. Si për çdo profesion të lirë, ashtu edhe për ekspertin kontabël, ushtrimi i një aktiviteti të ligjshëm do të duhej të ushtrohej: (a) duke qenë i regjistruar në organin tatimor; (b) me kontratë shërbimi në të cilën të përcaktohej qartësisht se cila palë është e detyruar të paguajë tatimin në burim mbi të ardhurat.

<sup>31</sup>Në paragrafin 21.41, të këtij vendimi, arsyetohet se: “*Nga një vështrim i thjeshtë i të dhënave që disponohen nga burime të hapura, për pagat në vend në këtë periudhë, rezulton se raporti i pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve me ato të funksionarëve të tjerë të sektorit publik, qëndronte përafërsisht në raportin rreth 30% më të larta. Në këto kushte, duke marrë parasysh këtë raport, krahasuar me informacionin që jep, vlerësohet se në rastin e analizës financiare në të cilat figurojnë të ardhura të siguruara nga puna e gjyqtarëve apo prokurorëve, shpenzimet e jetesës duhet të llogariten në masën 30% të të ardhurave, i cili përafrohet me masën e shpenzimeve për jetesë në raportin 66% të të ardhurave që i përkasin pagave mesatare të të gjithë sistemit të pagave*”.

<sup>32</sup>Shihni vendimet: nr. \*\*\*, datë 4.2.2020; nr. \*\*\*, datë 28.1.2020; nr. \*\*\*, datë 26.2.2020; nr. \*\*\*, datë 22.4.2021; dhe nr. \*\*\*, datë 26.7.2019, të Komisionit.

Masa e këtij reduktimi ka qenë rast pas rasti. Në rastin konkret, Komisioni çmoi të reduktojë shpenzimet e jetesës nga 66% e të ardhurave familjare në masën 30% të tyre.

**44.** Në përfundim të procesit, bazuar në sa më sipër, Komisioni rishikoi analizën financiare për justifikimin e investimit të vlerës 3.000.000 lekë, e cila ndryshoi nga -2.543.177 lekë dërguar me rezultatet e hetimit, në një balancë prej -206.928 lekësh. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i konsiderimit të periudhës së ndërtimit të shtrirë nga viti 1997 deri në fund të vitit 2000, ç'ka ka sjellë përfshirjen e të ardhurave familjare të subjektit edhe për periudhën pas marsit të vitit 1997 (kohë e ndërtimit e konsideruar me rezultatet e hetimit) dhe përfshirjes së të ardhurave për vjehrrin dhe vjehrrën të dokumentuara me parashtrimet e subjektit.

**45.** Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Apartament me sipërfaqe 56 m<sup>2</sup>, Lagjja \*\*\*, Durrës, blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 24.9.2007, vërtetim dokumenti hipotekor nr. \*\*\*, datë 7.11.2007. Vlera: 2.000.000 lekë. pjesa takuese: 50% në bashkëpronësi me bashkëshortin. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat*”.

ILDKPKI-ja, në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar: mosdeklarim i burimit financiar për blerjen e apartamentit me sip. 56 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Durrës, në çmimin 2.000.000 lekë, në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2007.

### **Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri**

**46.** Në lidhje me origjinën, mënyrën e përfitimit, si dhe statusin e pasurisë<sup>33</sup>, rezultoi se:

- Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore lëshuar në datën 25.9.2007, nga ZVRPP-ja Durrës, rezultoi e regjistruar në pronësi të shtetasit A. K. apartamenti i banimit me sip. 56 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*.

- Me kontratë shitje apartamenti nr. \*\*\*, datë 24.9.2007, blerësi A. Ç. ka blerë nga shtetasi A.K., apartament nr. \*\*\*, me sip. 56 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, në \*\*\*, Durrës, në çmimin 2.000.000 lekë dhe është deklaruar nga subjekti në DPV-në e vitit 2007, me të njëjtin çmim, pa deklaruar burimin e krijimit.

- ASHK-ja<sup>34</sup> Durrës informoi se në emër të shtetasit A. R. Ç. rezultoi e regjistruar pasuria me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e llojit apartament me sip. 56 m<sup>2</sup>.

- FSHU-ja<sup>35</sup> ka konfirmuar lidhjen e kontratës për furnizimin me energji elektrike në emër të subjektit, konfirmuar edhe nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit<sup>36</sup>.

- UK Durrës<sup>37</sup> ka konfirmuar lidhjen e kontratës për furnizimin me ujë në emër të bashkëshortit të subjektit, konfirmuar edhe nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit<sup>38</sup>.

**47.** Në lidhje me çmimin e blerjes se u konstatua se:

**47.1.** Sipas kontratës së shitjes është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Gjatë hetimit administrativ, subjekti informoi se kalimi i çmimit të blerjes së shtetasit A. K. është bërë me mandatarkëtim jashtë zyrës së noterisë, në ditën e lidhjes së kontratës. Në mbështetje të këtij deklarami, subjekti ka paraqitur mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 24.9.2007, sipas së cilit A. Ç. ka arkëtuar shumën 2.000.000 lekë, me përshkrim *për blerje apartamenti nr. \*\*\*, me sip. 56 m<sup>2</sup>, \*\*\*, Durrës, për subjektin A. K., drejtori i shoqërisë<sup>39</sup> “\*\*\*\*” sh.p.k.*

<sup>33</sup>Shihni aktet bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2020, nga ASHK-ja Durrës, në dosjen e Komisionit dhe në aneksin \*\*\*, në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>34</sup>Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2020, nga ASHK-ja Durrës, në dosjen e Komisionit.

<sup>35</sup>Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2022, nga FSHU-jë, në dosjen e Komisionit.

<sup>36</sup>Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

<sup>37</sup>Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2022 nga UK Durrës, në dosjen e Komisionit.

<sup>38</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

<sup>39</sup>Shihni dokumentacionin bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

**47.2.** Sipas udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, dhe të koeficientit ‘k’, për vitin 2007”, për qytetin e Durrësit, ku ndodhet apartamenti, çmimi i referencës për vitin 2007 është 81.080 lekë/m<sup>2</sup>. Referuar këtij çmimi, apartamenti i blerë do të kushtonte 56 m<sup>2</sup> x 81.080 lekë/m<sup>2</sup> = 4.540.480 lekë, ndërkohë që ka kushtuar 2.000.000 lekë ose me një çmim prej 2 herë më të ulët se ai i referencës. Nisur nga ky çmim preferencial, u kryen verifikime, nga të cilat u konstatua se:

- Nuk rezultuan inspektime të kryera apo dokumente të nënshkruara nga bashkëshorti i subjektit A. Ç., i cili deri në vitin 2006 ka ushtruar detyrën e përgjegjës të zyrës së kontrollit në Drejtorinë e Tatim Taksave Tiranë, ndaj shoqërisë ndërtimore në cilësinë e palës shitëse<sup>40</sup>.

- Pas kërkesës së Komisionit, për kontrata të ngjashme të shitjes së apartamenteve, administratori i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>41</sup> ka informuar se duke qenë një kompani e re, për shkak të nevojës së vazhdimësisë së aktivitetit, disa apartamente janë shitur me çmim të përafërt me koston, ndërkohë që trualli mbi të cilin është ndërtuar objekti ka qenë pronë e administratorit/ortakut të vetëm të shoqërisë, çka ka sjellë shitjen me çmim më të larta se kostoja, por më të ulët se çmimi i zonës për atë periudhë. Sipas shoqërisë, kosto e ndërtimit, për periudhën 2007-2008 për rrethin e Durrësit, ka qenë 29.000 lekë/m<sup>2</sup>. Gjithashtu, shoqëria bëri me dije se ka kohë që e ka mbyllur aktivitetin dhe nuk disponon kopje të kontratave, por ka mundur të sigurojë një kontratë shitje në të njëjtin objekt dhe në të njëjtën periudhë, pikërisht kontratën nr. \*\*\*, datë 25.9.2007, sipas së cilës shtetasja B. M. Ç. ka blerë apartamentin me sip. 43 m<sup>2</sup>, me çmim 1.600.000 lekë, pra, 37.209 lekë/m<sup>2</sup>. Nga krahasimi i çmimeve të kësaj kontrate me çmimin në kontratën e subjektit rezulton se subjekti e ka blerë apartamentin e tij me një çmim 35.714 lekë/m<sup>2</sup>, ose 4% më lirë sesa çmimi i kësaj kontrate.

- Ndaj shtetasit A. K. dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. rezultojnë çështje në Gjykatën e Lartë, të cilat i përkasin viteve 2012 – 2017<sup>42</sup>, periudhën në të cilën znj. Brunilda Çarçiu nuk ka qenë e punësuar në këtë institucion, pasi marrëdhëniet e punës kanë nisur në datën 10.5.2000 dhe janë shkëputur në datën 3.3.2011.

**47.3.** Pavarësisht nga sa më sipër, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me konstatimin, duket se pasuria objekt shqyrtimi është blerë me një çmim 2 herë më i ulët se ai i referencës. Në parashtrimet e saj, subjekti ka deklaruar se çmimi sipas kontratës është bazuar në lirinë kontraktuale, dhe se në referencë të vendimeve të Kolegjit 11/2019 dhe 5/2019, vlera e shitjes së sendeve, sipas aktit noterial, përbën vlerë të plotë provuese. Po kështu, subjekti sjell në vëmendje rrethana të tjera që kanë ndikuar si vendndodhja, cilësia e ndërtimit, planvendosja, orientimi i apartamenteve, etj. Sipas saj, në vitin 2007, zona e apartamentit ka qenë një zonë informale, pa kanalizime e në të shumtën e rasteve edhe pa energji elektrike. Në përfundim të procesit, në vlerësim të të gjitha rrethanave, Komisioni nuk e konsideroi blerjen e pasurisë me çmim më të ulët se çmimi reference si shkak për penalizim të subjektit.

**48.** Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, u konstatua se:

**48.1** Në DPV/2007 subjekti nuk e ka deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie. Gjithashtu, në këtë deklaratë, subjekti nuk ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*.

**48.2** Në deklaratën *Vetting*, viti 2016, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat nga pagat.

<sup>40</sup>Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2022, të DRT-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

<sup>41</sup>Shihni shkresë kthim përgjigjeje nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., të datës 3.4.2022, në dosjen e Komisionit.

<sup>42</sup>Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2022, lëshuar nga kancelari i Gjykatës së Lartë në dosjen e Komisionit.

**48.3** I pyetur pranë ILDKPKI-së, viti 2017, bashkëshorti i subjektit ka sqaruar<sup>43</sup> se për blerjen e këtij apartamenti ka pakësuar gjendjen *cash* dhe, po ashtu, ka shpenzuar ndër vite shumën 250.000 lekë për mobilim dhe se këtë apartament e ka për përdorim sezonal për pushime.

**48.4** E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi mosdeklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie në DPV/2007, subjekti ka sqaruar se meqenëse të ardhurat në këtë periudhë, sipas deklarimeve të mëparshme i takojnë të ardhurave nga paga, ka menduar se është i ditur fakti.

**48.5.** Nga verifikimi i DPV-ve, ndër vite, deri në vitin 2007, konstatohet se subjekti ka deklaruar shuma të kursyera *cash*, në këtë mënyrë:

- Në DPV/2003 subjekti ka deklaruar në seksionin likuiditete: “*shuma 4.000.000 lekë – kursime nga paga. Kursime nga të ardhurat e punës në vite dhe aktivitet privat në qytetin e Gramshit; dhe shuma 1.700.000 lekë – të ardhura nga shitja e banesës 2+1, e privatizuar në qytetin e Gramshit*”. Pra, në fund të vitit 2003 gjendja *cash* është 5.700.000 lekë.

- Në DPV/2004 dhe DPV/2005 subjekti nuk ka deklaruar as shtesa as pakësime të gjendjes *cash*.

- Në pyetësorin nr. 3 subjekti ka informuar se DPV/2003 e ka ribërë me kërkesë të ILDKPKI-së në vitin 2007, për shkak se kjo deklaratë kishte humbur dhe nuk gjendej dhe se e pyetur nga inspektorja për kursimet e viteve 2004 dhe 2005 subjekti është shprehur se në këto vite gjendja *cash* ka qenë e njëjtë si në vitin 2003.

- Në DPV/2006 subjekti ka deklaruar shumën *cash* 450.000 lekë si kursime nga të ardhurat për vitin 2006, e cila është shtesë e shumës së akumuluar dhe të mbartur nga data 31.12.2005. Kështu, në fund të vitit 2006 subjekti ka gjendje *cash* në shumën 6.150.000 lekë.

- Në DPV/2007 subjekti nuk ka deklaruar pakësim të shumës 6.150.000 lekë, por në procesverbalin e datës 3.3.2009, mbajtur në ILDKPKI subjekti ka sqaruar se *aseti i krijuar në vitin 2007 e ka burimin e krijimit nga pakësimi i gjendjes cash në shumën 6.150.000 lekë (cash i deklaruar nga vitet 2003 – 2006)*.

**48.6.** Në përfundim të hetimit administrativ, në lidhje me përdorimin e shumës së akumuluar *cash* për blerjen e tre pasurive në vitin 2007<sup>44</sup>, duket se subjekti: (i) ka dhënë sqarime mbi gjendjen *cash* në mars të vitit 2009, shumë kohë përpara fillimit të procesit të rivlerësimit, duke e bërë deklarimin e saj para ILDKPKI-së të besueshëm; (ii) nuk është gjendur asnjë e dhënë që ajo dhe bashkëshorti të kenë blerë tjetër pasuri; (iii) pavarësisht se nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të tre pasurive në vitin 2007, ajo e ka korrigjuar këtë në deklaratën në vitin 2009 dhe në deklaratën *Vetting*, duke specifikuar si burim *të ardhurat nga pagat dhe shitja e banesës në Gramsh*, me të cilat ka krijuar kursimet *cash* ndër vite.

**48.7** Siç vërehet, shuma e kursimeve të akumuluar nga subjekti për periudhën nga fillimi i detyrës, gusht 1993, deri në DPFD-në e vitit 2003 dhe gjatë vitit 2006, është 6.150.000 lekë. Me qëllim evidentimin e mundësisë për krijimin e kësaj shume me të ardhura të ligjshme është kryer analiza financiare për krijimin e gjendjes *cash* në shumën 6.150.000 lekë, në fund të vitit 2006, si në tabelën vijuese.

<sup>43</sup>Shihni sqarimet e dhëna nga subjekti sipas procesverbalit të datës 7.2.2017, në ILDKPKI, bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2020, të ILDKPKI-së në dosjen e Komisionit.

<sup>44</sup>Apartament me sip. 56 m<sup>2</sup>, \*\*\*, Durrës, blerë në datën 24.9.2007, në vlerën 2.000.000 lekë; dy dyqane në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, blerë në nëntor të vitit 2007, përkatësisht: dyqan me sip. 28.66 m<sup>2</sup>, në vlerën 19.202 euro dhe dyqan me sip. 23.66 m<sup>2</sup>, në vlerën 15.852 euro.



<b>Përshkrimi</b>	<b>Gusht 1991– 2003</b>	<b>2006</b>
<b>Pasuri</b>	<b>9 082 603</b>	<b>244 826</b>
Blerë apartament në Gramsh	82 603	
Banesë dykatëshe, me sip. 243.9 m <sup>2</sup> , ***	3 000 000	
Autoveturë blerë në vitin 2001	300 000	
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve</i>	<i>5 700 000</i>	<i>244 826</i>
Gjendja e likuiditeteve	5 700 000	6 220 793
<b>Të ardhura dokumentuar</b>	<b>8 859 653</b>	<b>1 296 688</b>
Të ardhura nga paga subjekti	4 201 510	1 135 200
Të ardhura nga paga bashkëshorti	2 607 760	161 488
Të ardhura nga pensioni i babait të bashkëshortit	350 383	
Përfitur nga shitja e apartamentit në Gramsh	1 700 000	
<b>Shpenzime</b>	<b>4 134 148</b>	<b>660 893</b>
Shpenzime jetese	3 532 348	438 228
Shpenzime udhëtimi nga sistemi <i>TIMS</i>		222 665
Shpenzime mobilimi	600 000	
Shpenzime të tjera/të ndryshme	1 800	
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-4 357 098</b>	<b>390 968</b>

**48.8.** Bazuar në sa më sipër, duket se subjekti dhe familja e saj nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar gjendjen *cash* në fund të vitit 2003 në shumën 5.700.000 lekë, por ka pasur të ardhura për të krijuar shtesën gjatë vitit 2006 në shumën 450.000 lekë, e cila është e pamjaftueshme për t'u përdorur si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.

**49.** Analiza financiare për pasurinë objekt verifikimi apartament në Durrës është kryer së bashku me dy dyqanet, trajtuar në vijim, për shkak se të tria pasuritë janë blerë në vitin 2007 (shihni paragrafin 56 të këtij vendimi).

**50.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Dyqan, me sipërfaqe 52.32 m<sup>2</sup>, rruga ‘\*\*\*’. Rivlerësuar në vitin 2014, funksionon si një i tërë i blerë sipas dokumentacionit: kontratë nr. \*\*\*, datë 7.11.2007 dhe kontrata nr. \*\*\*, datë 7.11.2007, certifikatë z. k. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\* dhe z. k. \*\*\*, nr. pasurie \*\*\*, me vlerë totale sipas kontratave 35 054 euro, konvertuar në vlerën 4.276.588 lekë*”. *Burimi i krijimit: të ardhura nga pagat. Shitja e banesës 2+1, në Gramsh, në vitin 2003. Pjesa takuese: 50% në bashkëpronësi me bashkëshortin*”.

ILDKPKI-ja, në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar: (i) në deklarin e interesave private periodike vjetore të vitit 2007, subjekti ka deklaruar dyqane në vlerën totale 35.054 euro, por nuk ka deklaruar burimin e ligjshëm financiar për krijimin e kësaj vlere; (ii) referuar deklaratës së vitit 2007, subjekti, në krijimin e pasurive të tij rezulton me mosjustifikim të të drejtave pasurore, por duke pasur në vëmendje likuiditetet *cash*, të deklaruara prej tij në deklarinimet e mëparshme, konsiderohet se në këtë rast ka të bëjë me mosdeklarim të burimit të krijimit të këtyre pasurive; (iii) në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2015, subjekti deklaroi se dyqani me sip. 52 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*” është rivlerësuar në vlerën 100.000 euro, ndërsa në deklaratën *Vetting* nuk e ka deklaruar vlerën e rivlerësimit. Sa më sipër rezulton: mosdeklarim i burimit financiar për blerjen e dyqaneve në Tiranë, me vlerë 35.054 euro, konvertuar në vlerën 4.276.588 lekë, në DIPPV/2007.

## Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

**51.** Në lidhje me origjinën, mënyrën e përfitimit, statusin aktual dhe deklaratimet e subjektit<sup>45</sup> në lidhje me dy pasuritë njësi objekt verifikimi, rezultoi se:

- sipas kartelës së pasurisë, pasuria me nr. \*\*\*, ka qenë e regjistruar në emër të shoqërisë “\*\*\*\*\*” sh.p.k.;
- me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 7.11.2007, znj. Brunilda Çarçiu ka blerë nga shoqëria “\*\*\*\*\*” sh.p.k. njësi (dyqan) me sip. 28.66 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, me vlerë 19.202 euro;
- sipas kartelës së pasurisë, pasuria me nr. \*\*\*, ka qenë e regjistruar në emër të shoqërisë “\*\*\*\*\*” sh.p.k.;
- me kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 7.11.2007, z. A. Ç. ka blerë nga shoqëria “\*\*\*\*\*” sh.p.k. njësi (dyqan) me sip. 23.66 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, me vlerë 15.852 euro, likuiduar me këste nga pala blerëse jashtë zyrës noteriale;
- në DPV/2007 subjekti ka deklaruar dyqan me sip. 52 m<sup>2</sup>, blerë sipas dy kontratave më sipër, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*\*”, përkatësisht në vlerat 15.852 euro dhe 19.202 euro, nuk është deklaruar burimi i krijimit;
- në DIPPFD/2016 subjekti ka deklaruar *dyqan me sip. 52 m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*\*”, viti 2007. Rivlerësuar në vitin 2014, në shumën 100.000 euro. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat. Shitja e banesës 2+1, në Gramsh, në vitin 2003;*
- në deklaratën *Vetting* subjekti i ka deklaruar në një të vetme të dyja njësitë: *dyqan me sip. 52.32 m<sup>2</sup>*, por nuk e ka deklaruar vlerën e rivlerësimit;
- ZVRPP-ja Tiranë<sup>46</sup> ka konfirmuar se: (i) shtetasja Brunilda Çarçiu ka të regjistruar “Njësi” me sip. 28.66 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*; dhe (ii) shtetasi A. Ç. ka të regjistruar “Njësi” me sip. 23.66 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*;
- FSHU-ja<sup>47</sup> nuk konfirmoi kontratë të furnizimit me energji në emër të subjektit apo bashkëshortit të saj. Subjekti ka paraqitur librezat e energjisë elektrike me nr. \*\*\*, në emër të bashkëshortit A. Ç. dhe nr. \*\*\*, në emër të saj<sup>48</sup>, duke deklaruar se dyqani është blerë për t’u dhënë për aktivitete biznesi dhe është marrë nga qiramarrës të ndryshëm, të cilët kanë pasur detyrimin si për konsumin e energjisë ashtu edhe të ujit.

**52.** Në lidhje me likuidimin e çmimit të blerjes, u konstatua se:

- Sipas kontratave të shitjeve, çmimi i shitjes, përkatësisht prej 19.202 euro dhe 15.852 euro është likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti sqaroi se *shumat respektive janë dhënë pjesë-pjesë sipas mandatarkëtimeve. Pjesa e fundit është likuiduar në ditën e lidhjes së kontratave me mandatarkëtimi jashtë zyrës së noterisë.* Për të mbështetur këto deklaratime subjekti ka paraqitur: (i) katër mandatarkëtime për arkëtimin e shumave të caktuara sipas datave përkatëse nga znj. Brunilda Çarçiu për shoqërinë “\*\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “për blerje dyqani” dhe, konkretisht mandatarkëtimet: datë 2.11.2007, për shumën 5.000 euro; datë 11.6.2007 për shumën 5.000 euro; datë 16.7.2007, për shumën 4.500 euro; datë 7.11.2017, për shumën 4.702 euro; si dhe (ii) katër mandatarkëtime për arkëtimin e shumave të caktuara sipas datave përkatëse nga shtetasi A. Ç., për shoqërinë “\*\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë për dyqanin te R. C.” dhe konkretisht mandatarkëtimet: datë 4.5.2007, për shumën 4.000 euro; datë 27.6.2007, për shumën 3.000 euro; datë 18.9.2007, për shumën 4.000 euro; datë 7.11.2007, për shumën 4.852 euro.

<sup>45</sup>Shihni aktet në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së, DPV-ve, si dhe deklaratën *Vetting*.

<sup>46</sup>Shihni shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2018, nga ZVRPP-ja Tiranë në aneks \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>47</sup>Shihni shkresë kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2020, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>48</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

- Nisur nga datat e pagesave të çmimit të shitjes, të cilat i përkasin periudhës përpara datës së nënshkrimit të kontratave të shitjes, nga Komisioni iu kërkua shoqërisë “\*\*\*\*\*” sh.p.k. informacion mbi mënyrën e likuidimit të çmimit, ekzistencën e ndonjë marrëveshjeje paraprake mes shtetasve Brunilda dhe A. Ç. dhe shoqërisë “\*\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe të paraqesë librat kontabël të arkës ku të ishin të pasqyruara arkëtimet e shumave çifti Çarçiu. Në përgjigje të kësaj kërkesë shoqëria “\*\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>49</sup> ka konfirmuar kontratat e shitblerjeve për dy dyqanet duke theksuar se çmimi është likuiduar totalisht me këste, para lidhjes së dy kontratave të shitjes. Më tej ka sqaruar se, referuar praktikës së ndjekur prej saj në raste të tjera, ... *ka pasur marrëveshje me shkrim midis palëve, e cila pas përpilimit të kontratës përfundimtare për kalimin e të drejtave të pronësisë së njësisë të blerësi, pasqyrohet në kontratën përfundimtare, kopje të së cilës e dispononi dhe ju*. Sa i takon dokumentacionin financiar, por jo vetëm, shoqëria sqaron se për shkak të një kohe relativisht të gjatë nga lidhja e këtyre kontratave, si dhe bazuar në ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”<sup>50</sup> është e pamundur gjetja e arkivës së 15 viteve të fundit. Pra, siç vërehet nga ana e shoqërisë është konfirmuar ekzistenca e një marrëveshjeje paraprake me blerësin përpara lidhjes së kontratës përfundimtare të shitjes, ndërkohë, nuk paraqet të dhëna e dokumentacion për të vërtetuar qoftë mënyrën e likuidimit apo qoftë marrëveshjen paraprake. Në këto rrethana, likuidimi i çmimit është konsideruar sipas mandatpagesave të paraqitura nga subjekti.

**53.** Në lidhje me vlerën e çmimit të shitjes, u konstatua se:

**53.1.** Sipas kontratave të shitblerjes, të dyja të datës 7.11.2007, çmimi i dy njësisive/dyqaneve me sip. totale 52.32 m<sup>2</sup> është në vlerën 35.054 euro ose 670 euro/m<sup>2</sup>. Ndërkohë që sipas çmimit të referencës për zonën ku ndodhen dy pasuritë, zona \*\*\* e Tiranës, çmimi për metër katror i një apartamenti është 87.500 lekë/m<sup>2</sup><sup>51</sup> ose 724 euro/m<sup>2</sup><sup>52</sup>. Duke përdorur analogjinë, mund të thuhet se çmimi/m<sup>2</sup> i një dyqani në këtë zonë është 1.447 euro/m<sup>2</sup><sup>53</sup>. Kështu, për sipërfaqen 52.32 m<sup>2</sup> vlera e dyqaneve do të ishte 75.725 euro/9.156.016 lekë<sup>54</sup> ose 2.2 herë më e lartë se vlera e paguar nga subjekti.

**53.2.** Nisur nga ky çmim preferencial, Komisioni kreu verifikime të mëtejshme, nga të cilat u konstatua se:

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion prej DRT-së Tiranë<sup>55</sup> nuk rezultuan inspektime të kryera apo dokumente të nënshkruara nga bashkëshorti i subjektit, z. A. Ç., i cili deri në vitin 2006 ka ushtruar detyrën e përgjegjës të zyrës së kontrollit në Drejtorinë e Tatim Taksave Tiranë, ndaj shoqërisë “\*\*\*\*\*”sh.p.k.

- U kërkuan kontrata të ngjashme të shitjes së apartamenteve që i përkasin të njëjtës godinë në të njëjtën periudhë nga shoqëria “\*\*\*\*\*” sh.p.k., e cila ka sqaruar se në kohën kur janë prenotuar këto njësi, çmimet për zonën \*\*\* (\*\*\*, \*\*\*, rruga “\*\*\*”), ku është ndërtuar objekti, kanë qenë

<sup>49</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 9.5.2022, nga shoqëria “\*\*\*\*\*” sh.p.k., në dosjen e Komisionit.

<sup>50</sup>Sipas këtij ligji dokumentacioni financiar nga shoqëritë tregtare, ruhet për 10 vjet.

<sup>51</sup>Për vitin 2007 çmimet e banesave nuk janë të ndara sipas zonave të Tiranës dhe, për këtë arsye, në vend që të merret çmimi mesatar për të gjithë Tiranën që në vitin 2007 është 97.000 lekë/m<sup>2</sup>, është konsideruar si më përfaqësues çmimi i zonës \*\*\* për vitin 2008 sipas udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2008”.

<sup>52</sup>Kursi i këmbimit 1 euro = 120.91 lekë, Banka e Shqipërisë datë 31.12.2007.

<sup>53</sup>Deri në vitin 2015 nuk ka pasur çmime reference për dyqanet, por vetëm për apartamentet dhe, për këtë arsye, për të përllogaritur një çmim reference të dyqaneve në vitin 2007, Komisioni i është referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 3.6.2015, të DPT-së, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”, pika 3/a, në të cilin përcaktohet se vlera e qirasë së dyqanit është 2 herë më e lartë se ajo e një apartamenti.

<sup>54</sup><https://www.tirana.al/artikull/informacion-mbi-tregun-e-pasurive-te-palujtshme-ne-qytetin-e-tiranes>  
[https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/udhzim\\_1\\_20.08\\_2.pdf](https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/udhzim_1_20.08_2.pdf)

<sup>55</sup>Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2022, të DRT-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

320 euro/m<sup>2</sup> për apartament dhe 640 euro/m<sup>2</sup> për dyqanet<sup>56</sup>. Shoqëria ka vënë në dispozicion të Komisionit aktmarrëveshjen mes Drejtorisë së Tatimeve dhe Shoqatës së ndërtuesve të datës 25.5.2004, si dhe dy kontrata shitjeje njësisish/dyqanesh në të njëjtin objekt dhe, në të njëjtën periudhë, që sipas saj janë shitur me çmime të përafërta, si vijojnë: (i) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 1.11.2007, me objekt njësi (dyqan) me sip. 36.6 m<sup>2</sup>, me çmim 660 euro/m<sup>2</sup> dhe çmim total 24.156 euro; (ii) kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 9.11.2007, me objekt njësi (dyqan) me sip. 46 m<sup>2</sup>, me çmim 680 euro/m<sup>2</sup> dhe çmim total 31.280 euro. Siç duket, subjekti i ka blerë dy pasuritë njësi në një çmim dy herë më të ulët se çmimi i referencës, por ka paguar të njëjtin çmim sa dy shtetas të tjerë që kanë blerë dyqane në të njëjtën ndërtesë dhe periudhë.

- E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti informoi<sup>57</sup> se gjatë ushtrimit të detyrës si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë nuk ka dhënë opinione/relacione për çështje me palë përfaqësues të shoqërisë “\*\*\*\*\*” sh.p.k. apo shtetasin R. A. Subjekti ka paraqitur shkresën kthim përgjigje me nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2022, nga kancelari i Gjykatës së Lartë, sipas së cilës ndaj shtetasit R. A. dhe shoqërisë “\*\*\*\*\*” sh.p.k. rezultojnë çështje të cilat i përkasin viteve 2012 – 2017, periudhë në të cilën znj. Brunilda Çarçiu nuk ka qenë e punësuar në Gjykatën e Lartë pasi marrëdhëniet e punës kanë nisur në datën 10.5.2000 dhe janë shkëputur në datën 1.3.2011.

- Në përfundim të hetimit administrativ, pavarësisht se nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi me shoqërinë apo administratorin e saj, qoftë nga ana e subjektit, qoftë nga ana e bashkëshortit të saj, duket se pasuria objekt shqyrtimi do të kishte një çmim 2.5 herë më të lartë se vlera e paguar nga subjekti. Subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

- Në parashtrimet e saj, subjekti ka deklaruar se çmimi i blerjes është dakordësuar me shitësin e “\*\*\*\*\*” sh.p.k., bazuar në çmimet e tregut, bazuar në vullnetin e lirë të palëve. Gjithashtu, subjekti ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit se çmimi i dyqaneve është 2 herë më i lartë se çmimi i apartamenteve, pasi ai është i bazuar në një vendim të vitit 2015, i cili nuk duhet të shërbejë për të nxjerrë vlerën e dyqaneve në vitin 2007, pra 8 vjet më parë.

- Për sa pretendohet nga subjekti, duke iu referuar aktmarrëveshjes mes Drejtorisë së Tatimeve dhe Shoqatës së Ndërtuesve të datës 25.5.2004, miratuar me udhëzimin nr. \*\*\*, datë 10.6.2004, të Ministrisë së Financave, Komisioni vlerëson se: (i) sipas këtij dokumenti çmimi për metër katror sipërfaqja e ndërtimit për dyqane është 2 herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas zonave, sikurse është përllogaritur nga Komisioni; (ii) ky dokument referon çmimet minimale të shitjes për efekt fiskal për zonat e Tiranës dhe jo çmimet e shitjes së tregut, të cilat janë të përllogaritura dhe të përcaktuara çdo vit nga Enti Kombëtar i Banesave.

**53.3.** Nga sa më sipër rezulton se çmimet e përcaktuara në kontratat e shitjeve midis subjektit dhe shoqërisë ndërtuese janë përllogaritur në një vlerë shumë të përafërt me çmimet minimale fiskale për metër katror. Konkretisht, për pasurinë dyqan me sip. 28.66 m<sup>2</sup> x 670 euro/m<sup>2</sup> është përcaktuar çmimi 19.202 euro dhe për pasurinë dyqan me sip. 23.66 m<sup>2</sup> x 670 euro/m<sup>2</sup> është përcaktuar çmimi 15.852 euro. Këto çmime i sjellin palët në një pozitë korrekte përpara organeve tatimore, por jo domosdoshmërisht tregojnë çmimin real të shitjes (jo vetëm për subjektin, por edhe për blerësit e tjerë). Në këto rrethana, pavarësisht se Komisioni ka përllogaritur si shpenzim vlerën e çmimit sipas kontratave, edhe pse nuk kanë rezultuar të dhëna për konflikt interesi si dhe është provuar që subjekti i ka blerë njësitë me çmim të përafërt me

<sup>56</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2022, nga shoqëria “\*\*\*\*\*” sh.p.k. në dosjen e Komisionit, në të cilën sqarohet se çmimet janë përllogaritur duke iu referuar aktmarrëveshjes mes Drejtorisë së tatimeve dhe Shoqatës së ndërtuesve të datës 25.5.2004, miratuar me udhëzimin nr. \*\*\*, datë 10.6.2004, të Ministrisë së Financave, në të cilën janë përcaktuar çmimet minimale të shitjes për efekt fiskal të njësisive për qytetin e Tiranës.

<sup>57</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3 dhe dokumentacionin bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

dy blerës të tjerë, në përfundim të procesit, mbetet dyshimi që çmimi i blerjes së këtyre pasurive, nuk është çmim real.

#### **54. Në lidhje me përdorimin e njësive dhe të ardhurave nga qiratë nga aktet në dosje<sup>58</sup> rezultoi se:**

**54.1.** Sa i takon dhënies me qira, nga verifikimi i deklarimeve të subjektit konstatohet se janë deklaruar të ardhura nga qiraja e dyqaneve si vijon:

- në DPV/2007 të ardhura nga qiraja sipas kontratës së datës 10.4.2007, në shumën 80.000 lekë, e cila nuk është paraqitur nga subjekti;
- në DPV/2008 nuk ka deklaruar;
- në DPV/2009 ka deklaruar të ardhura nga qiraja sipas kontratës së datës 30.1.2009, në shumën 220.000 lekë, e cila nuk është paraqitur nga subjekti;
- në DPV/2010 ka deklaruar të ardhura nga qiraja sipas kontratës së datës 30.1.2009 dhe kontratës së datës 1.2.2010, në shumën 240.000 lekë, e cila nuk është paraqitur nga subjekti;
- në DPV/2011 ka deklaruar të ardhura nga qiraja sipas kontratës datë 1.2.2010 (2 muaj) në shumën 40.000 lekë, e cila nuk është paraqitur nga subjekti;
- në DIPPFD/2016 subjekti ka deklaruar “të ardhura nga qiraja mujore e dyqanit sipas kontratës datë 13.6.2016, me vlerën 16.500 lekë/muaj, e cila nuk është paraqitur nga subjekti;
- në deklaratën *Vetting* ka deklaruar të ardhura “Nga qiratë e dyqanit, dhënë sipas kontratave nr. \*\*\* rep., datë 23.2.2010, me afat njëvjeçar me vlerë 20.000 lekë/muaj dhe nr. \*\*\*, datë 6.1.2012, afat njëvjeçar, me vlerë 20.000 lekë/muaj, në shumën 480.000 lekë; si dhe nga qiraja e dyqanit sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 13.6.2016 (deklaruar edhe në DPV/2016 si më sipër) me vlerë 16.500 lekë/muaj, shuma 115.500 lekë. Të tria këto kontrata janë paraqitur në ILDKPKI.

**54.2.** Siç vërehet, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se dyqani me sip. 52.32 m<sup>2</sup> funksionon si një i tërë pavarësisht se është blerë me dy kontrata të ndryshme. Ndërkohë, referuar kontratave të qirasë, të depozituara nga subjekti në ILDKPKI (nr. \*\*\*, datë 23.2.2010; nr. \*\*\*, datë 6.11.2012; dhe nr. \*\*\*, datë 13.6.2016), rezulton se është dhënë me qira vetëm dyqani me sip. 28.66 m<sup>2</sup>. E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi këtë fakt subjekti ka sqaruar se për këtë dyqan është e vërtetë që kanë lidhur dy kontrata shitblerjeje dhe kanë dy certifikata pronësie, por dyqani ka funksionuar gjithmonë si një i tërë, pasi nuk kanë ndarje pronat nga njëra-tjetra dhe, në këto kushte, sipas saj nuk mund të jepen me qira si objekte më vete dhe për subjekte të ndryshëm. Ajo ka deklaruar se përderisa funksionon si një i tërë është konsideruar e mjaftueshme hartimi i vetëm një kontrate noteriale. Subjekti ka paraqitur 3 foto me pamje nga dyqani, nga të cilat evidentohet që njësia është pastrim kimik dhe ka dy ambiente që lidhen me një derë të brendshme. Pra, realisht, sipas subjektit, janë dhënë me qira të dyja dyqanet me sip. 52.32 m<sup>2</sup>, ndërkohë që në kontratë është shënuar vetëm sipërfaqja prej 28.66 m<sup>2</sup>.

**54.3.** Bazuar në sa më sipër, subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me konstatimin se në kontratat e qirasë nuk është deklaruar sipërfaqja e plotë e pasurisë së dhënë me qira, e cila duket se ka çuar në pagimin e një vlere më të ulët të tatimit mbi qiranë. Në parashtrimet e saj subjekti ka dhënë të njëjtat sqarime, sikurse gjatë procesit të rivlerësimit, sipas të cilave, duke qenë se pasuria funksionon si një e tërë është konsideruar i mjaftueshëm hartimi i vetëm një kontrate noteriale, por realisht janë dhënë me qira të dyja dyqanet me sip. 52.32 m<sup>2</sup>. Sipas saj, vlera e qirasë për të gjithë dyqanin është ajo e pasqyruar në kontratat e qirasë dhe tatimi mbi qiranë është paguar mbi vlerën e qirasë, e cila përfaqëson qiranë për të gjithë dyqanin. Vendimi që përcakton vlerën e qirasë sipas zonave është i vitit 2015 dhe përpara kësaj periudhe nuk ka pasur të tillë.

<sup>58</sup>Shihni aktet në aneksin \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

**54.4.** Në analizë të pretendimeve të subjektit, Komisioni çmon se ato qëndrojnë, pasi: (i) për herë të parë në vitin 2015, u përcaktuan vlerat minimale të qirave për metër katror si çmim reference për qëllime tatimore dhe, në këtë kontekst, deklarimi i sipërfaqes për efekte tatimore nuk ishte i detyruar. Kështu, nga ana e subjektit nuk ka pasur motiv pasqyrimi në kontratë i një sipërfaqeje më të vogël se ajo reale, pasi kjo gjë nuk do të sillte ndonjë përfitim të supozuar për subjektin. Po kështu, nuk do të kishte efekt fiskal as për organet tatimore; (ii) dyqani është marrë me qira nga persona fizikë dhe detyrimin e pagesës së tatimit në burim e kanë pasur qiramarrësit, fakt i parashikuar edhe në kontratat e qirasë. Ndërkohë, ky arsytim nuk vlen për kontratën e lidhur në datën 13.6.2016. Gjithsesi, për Komisionin mbetet e paqartë përse në kontratat e lidhura përpara vitit 2016 është shkruar dhënia me qira vetëm e sipërfaqes prej 28.66 m<sup>2</sup>, ndërkohë që është dhënë me qira e gjithë sipërfaqja e të dyja dyqaneve prej 52.32 m<sup>2</sup>.

**55.** Sa i takon të ardhurave nga qiratë:

**55.1.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.10.2017, DRT-ja Tiranë<sup>59</sup> ka informuar në lidhje me disa pagesa të tatimit në burim, bazuar në kontratat e qirave, si në tabelën vijuese.

Muaji	Qira e deklaruar	Tatimi mbi qiranë i likuiduar	Shënime	Qiraja neto
Tetor 2016	75 900	11 385	Deklaruar dhe paguar për periudhën 13.6.2016 - tetor 2016	64 515
Dhjetor 2016	49 500	7 425	Deklaruar dhe paguar për tre muaj (nëntor - dhjetor 2016, janar 2017)	42 075
Mars 2017	49 500	7 425	Deklaruar dhe paguar për tre muaj (mars-prill-maj 2017)	42 075
Qershor 2017	49 500	7 425	Deklaruar dhe paguar për tre muaj (qershor-korrik-gusht 2017)	42 075

**55.2.** Gjatë procesit të rivlerësimit subjektit iu kërkua të provojë me dokumente burimin e ligjshëm të të ardhurave nga qiraja, e cila në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 sqaroi se në zbatim të legjislacionit tatimor<sup>60</sup> detyrimin për pagesën e tatimit mbi qiranë në organet tatimore e ka qiramarrësi, aq më tepër të gjithë qiramarrësit që kanë marrë me qira ambientin e tyre kanë ushtruar aktivitet privat dhe kanë qenë të regjistruar në organet tatimore.

**55.3.** Subjekti ka paraqitur dy urdhërpagesa për tatimin e mbajtur në burim, nga analiza e të cilave rezultoi se është paguar tatimi në burim për të ardhurat nga qiraja, vetëm për disa muaj gjatë viteve 2016 dhe 2017. Në këto kushte, subjektit iu kërkua të provojë pagesat e këtij tatimi edhe për vitet e tjera sipas kontratave të qirasë, e cila në përgjigjet e saj<sup>61</sup> duke u referuar në legjislacionin tatimor mbi tatimin për të ardhurat vijon të deklarojë se detyrimi për pagesën e tatimit mbi qiranë në organet tatimore i përket qiramarrësit, aq më tepër që të gjithë qiramarrësit kanë qenë subjekte private dhe se në dijeninë e saj ky tatim është paguar prej tyre. Më tej subjekti ka informuar se që në vitin 2016 dyqanin e ka marrë subjekti privat që ushtron aktivitetin e pastrimit kimik, i cili paguan tatimin mbi qiranë çdo tremujor, fakt ky sipas saj

<sup>59</sup>Shihni Aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>60</sup>Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, germa "d" e nenit 8 dhe udhëzimi nr. 5, datë 30.1.2006, në zbatim të ligjit.

<sup>61</sup>Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

lehtësisht i verifikueshëm. Subjekti nuk ka paraqitur dokumente të tjera që të provojnë pagesën e tatimit për të ardhurat nga qiraja.

**55.4.** Bazuar në sa më sipër, janë përfshirë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare të subjektit për periudhën 18.11.2016 (dita e emërimit të subjektit si këshilltare në KLD) deri më 31.12.2016, vetëm pjesa e të ardhurave nga qiratë për të cilat janë paguar detyrimet tatimore dhe pikërisht qiraja *neto* e muajve nëntor-dhjetor 2016, në shumën 28.050 lekë<sup>62</sup>.

**55.5.** Në parashtrimet e saj subjekti ka informuar se pavarësisht detyrimit të qiramarrësit për të paguar tatimin në kushtet kur nuk kanë mundur të vërtetojnë pagesën e tatimit e kanë kryer vetë pagesën e detyrimeve tatimore. Subjekti ka paraqitur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2022, të Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve për pagesën e kryer për tatimin mbi qiranë në vlerën 144.000 lekë. Gjithashtu, ajo sjell në vëmendje të Komisionit jurisprudencën e organeve të rivlerësimit në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore me vonesë duke u konsideruar si të ardhura të ligjshme. Në mbështetje të pretendimeve të saj, subjekti ka paraqitur edhe tre kontrata qiraje, përkatësisht, të viteve 2009, 2010 dhe 2012, të cilat parashikojnë se detyrimi i pagimit të tatimit mbi fitimin i përket qiramarrësit.

**55.6.** Nga verifikimi në faqen elektronike të QKB-së rezultoi se: (i) G. Ç. është person fizik i regjistruar në datën 11.2.2008, me NIPT \*\*\*; lloji i aktivitetit, lavazh; vendi i ushtrimit të aktivitetit ka qenë rruga “\*\*\*\*”, pallati pranë shkollës “\*\*\*\*”; (ii) znj. M.V. është person fizik i regjistruar në datën 4.1.2012, me NIPT \*\*\*; lloji i aktivitetit – farmaci, vendi i ushtrimit të aktivitetit: kryqëzimi i rrugës “\*\*\*\*” me rrugën “\*\*\*\*”, pallati pranë gjimnazit “\*\*\*\*”, kati 1. Pra adresat e këtyre PF, të deklaruara në QKR, përputhen me vendndodhjen e dyqanit në pronësi të subjektit dhe bashkëshortit.

**55.7.** Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur konstatohet se subjekti ka kryer pagesën e tatimit mbi qiranë në vlerën 144.000 lekë që i përket periudhave 2009, 2010, 2012 dhe 2013, ndërkohë që nuk ka paraqitur kontratë qiraje për vitin 2007, pavarësisht se në DPV/2007 ka pretenduar të ardhura nga qiraja në shumën 88.000 lekë dhe për vitin 2013, për të cilin ka paguar tatimin në burim.

**55.8.** Në përfundim të procesit, Komisioni çmoi të konsiderojë të ligjshme të ardhurat nga qiraja për vitet 2008, 2010, 2012 dhe 2016, tatimi mbi të cilat është paguar nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

i) Subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja edhe në deklaratat vjetore edhe në deklaratën *Vetting*.

ii) Subjekti ka provuar marrëdhënien e qirasë me personat fizikë, duke paraqitur kontratat e qirasë për këto vite, në të cilat parashikohet vlera e qirasë dhe përcaktohet se detyrimi për pagesën e tatimit i takon qiramarrësit.

iii) Qiramarrësit, si palë në kontratat e paraqitura nga subjekti, janë persona fizikë dhe, si të tillë, kanë detyrimin ligjor për pagesën e tatimit mbi qiranë.

iv) Subjekti i ka paguar vetë detyrimet tatimore, pasi ka marrë dijeni se qiramarrësit, pavarësisht se e kanë pasur detyrim, nuk kishin paguar tatimin në burim.

v) Komisioni dhe Kolegji<sup>63</sup>, në disa raste, ka konsideruar si të ardhura të ligjshme nga qiratë, midis të tjerash, edhe kur janë plotësuar kushtet e sipërpërmendura.

---

<sup>62</sup>Kjo shumë përfaqëson qiranë *neto* për 2 muaj dhe pikërisht  $16.500 \times 2 = 33.000$  lekë dhe pas zbritjes së tatimit 15% është përfutur shuma 28.050 lekë.

<sup>63</sup>Vendimet e Komisionit: nr. \*\*\*, datë 1.8.2018; nr. \*\*\*, nr. \*\*\*, datë 18.6.2019; nr. \*\*\*, datë 19.6.2019; nr. \*\*\*, datë 26.2.2020; nr. \*\*\*, datë 20.7.2020; si dhe vendimet e Kolegjit: nr. 14, datë 15.6.2021; nr. 15, datë 18.6.2021, nr. 6, datë 17.3.2022 dhe nr. 12, datë 29.4.2022.

## 56. Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë

**56.1.** Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit konstatohet se: (i) në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat nga pagat dhe shitja e banesës 2+1 në Gramsh në vitin 2003; (ii) në DPV-në e vitit 2007 nuk është deklaruar burimi i krijimit. Komisioni ka kryer analizë specifike për secilin nga burimet e deklaruara si vijon:

**56.2.** Për të ardhurat nga pagat Komisioni iu referua: (i) gjendjes *cash* me kursime nga pagat, të deklaruara nga subjekti, e cila deri në fund të vitit 2006 është në vlerën 6.150.000 lekë; (ii) pagave të subjektit dhe bashkëshortit për harkun kohor 1 janar deri më 7.11.2007<sup>64</sup>, të cilat janë në vlerën 1.009.748 lekë.

**56.3.** Në lidhje me burimin të ardhura nga shitja e banesës 2+1, në Gramsh, në vitin 2003<sup>65</sup>, nga aktet në dosje ka rezultuar se:

- Sipas certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 27.3.2003 nga ZVRPP-ja Gramsh, rezulton e regjistruar në pronësi të shtetasve A., Brunilda, R. dhe D. Ç., apartamenti me sip. 73.83 m<sup>2</sup>, përfituar nga privatizimi prej EKB-së Elbasan, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 16.1.2002, me çmim 82.603 lekë.

- Me kontratën nr. \*\*\*, datë 27.3.2003, shitësit A., Brunilda, R. dhe D. Ç., i kanë shitur shtetasve K. Z. dhe F. Z., apartament me sip 73.03 m<sup>2</sup>, në shumën 1.700.000 lekë, likuiduar nga blerësi jashtë zyrës noteriale. Nga kartela e pasurisë rezulton se në datën 8.5.2003 kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasve K. dhe F. Z.

- Duke qenë se pasuria ka qenë në bashkëpronësi të 4 bashkëpronarëve mbetej e paqartë përse subjekti ka deklaruar se së bashku me bashkëshortin kanë përfituar vlerën e plotë nga shitja e pasurisë.

Për këtë arsye iu kërkuan sqarime subjektit, e cila në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, sqaroi se banesën në Gramsh e kishte përfituar bashkëshorti i saj me autorizim nga Bashkia Gramsh, në vitin 1994, si ish-punonjës i asaj kohe, ç'ka dihej nga prindërit e tij dhe se për shkak të marrëdhënieve të ngushta familjare prind-fëmijë nuk është hartuar ndonjë akt shkresor për shprehjen e vullnetit, por është bërë me veprime konkludente. Këtë situatë e shpjegon edhe fakti që nga trashëgimtarët e tyre ligjorë nuk ka pasur dhe nuk ekziston asnjë mosmarrëveshje apo ndonjë pretendim si atëherë, edhe sot. Sipas subjektit, bazuar në germën “ç”, të nenit 233, të Kodit të Procedurës Civile, kur për shkak të marrëdhënieve të posaçme nuk ka qenë e mundur të merrej provë me shkresë, lejohet prova me dëshmitarë për veprimin e kryer, të cilin ajo deklaroi se e dëshmon, duke qenë në pamundësi që ata të shprehin vullnetin aktualisht, pasi kanë ndërruar jetë respektivisht në vitet 2013 dhe 2017. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të paraqesë certifikatat e vdekjeve të prindërve të bashkëshortit. Në parashtrimet e saj, subjekti ka provuar pamundësinë e shfaqjes së vullnetit të prindërve të bashkëshortit, duke paraqitur certifikatat e vdekjes sipas të cilave ata kanë ndërruar jetë përkatësisht në vitet 2013 dhe 2017.

Sqarimet e subjektit duken bindëse dhe, për këtë arsye, shuma 1.700.000 lekë u përfshi si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të vitit 2003.

## Analiza financiare

**57.** Kjo analizë përmbledh të tria pasuritë e blera gjatë vitit 2007, konkretisht: apartament në Durrës dhe dy dyqane në Tiranë, blerje të kryera nga muaji prill deri më 7.11.2007, datë që

<sup>64</sup>Nga mandatpagesat e paraqitura nga subjekti për pagesën e dy dyqaneve është evidentuar se pagesa e parë është bërë në prill të vitit 2007 ndërsa e fundit më 7.11.2007.

<sup>65</sup>Shihni aktet në anekset \*\*\* dhe \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.



përkon me pagesën e kështit të fundit të dyqaneve. Bazuar në analizën e burimeve si më sipër, të ardhurat dhe shpenzimet për harkun kohor janar – 7.11.2007 janë pasqyruar në mënyrë të përmbledhur si në tabelën vijuese.

<i>Përshkrimi</i>	<i>1.1 - 7.11.2007</i>
<b>Pasuri</b>	<b>45 910</b>
Apartament me sip. 56 m <sup>2</sup> , ***, Durrës, datë 24.9.2007	2 000 000
Dyqan me sip. 28.66 m <sup>2</sup> , rruga “****”, Tiranë, 670 euro/m <sup>2</sup>	2 321 714
Dyqan me sip. 23.66 m <sup>2</sup> , rruga “****”, Tiranë	1 916 665
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	<i>-6 192 470</i>
Gjendja e likuiditeteve	28 324
<b>Të ardhura dokumentuar</b>	<b>1 009 748</b>
Të ardhura nga paga subjekti	1 009 748
Të ardhura nga paga bashkëshorti	0
<b>Shpenzime</b>	<b>4 792 368</b>
Shpenzime jetese	546 480
Shpenzime udhëtimi nga sistemi <i>TIMS</i>	233 138
Shpenzime të tjera/të ndryshme	12 750
Sistemim veprimi <i>cash</i> 4 milionë nga të ardhura të pajustificuara	4 000 000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-3 828 530</b>

Në këtë analizë është konsideruar që shuma prej 6.150.000 lekësh, e kursyer nga pagat ndër vite, e deklaruar si gjendje *cash* nga DPFD-ja në vitin 2003 deri në fund 2006, është përdorur për blerjen e tri pasurive. Por, meqenëse subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kursimeve *cash*, sikurse është trajtuar në paragrafët 48.6 deri 48.8 të këtij vendimi, kjo pamundësi ka afektuar rezultatin negativ të analizës së treguar në tabelën e mësipërme.

**58.** Në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti: (i) nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurisë apartament në Durrës, në shumën 2.000.000 lekë, si dhe për blerjen e dy njësi/dyqaneve në Tiranë në shumën 35.054 euro; (ii) nuk ka deklaruar si burim pakësimin e gjendjes *cash* në DPV/2007; (iii) nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurive në DPV/2007. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

**58.1.** Në parashtrimet e saj, subjekti ka prapësuar se ka pasur burime të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament në Durrës, në shumën 2.000.000 lekë, si dhe për blerjen e dy njësi/dyqane në Tiranë, në shumën 35.054 euro, për faktin se ata kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të kursyer shumën prej 4.000.000 lekësh në fund të vitit 2003. Ndërsa sa i takon pakësimin të gjendjes *cash* dhe mosdeklarimit të burimit të krijimit të pasurive në DPV/2007, janë pasaktësi të karakterit formal në DPV-në vjetore të këtij viti, që sipas saj nuk shoqërohen me pamjaftueshmëri financiare dhe, si të tilla, nuk përbëjnë shkak për marrjen e masave disiplinore nën dritën e jurisprudencës së Kolegjit<sup>66</sup>.

**58.2.** Komisioni, pasi analizoi pretendimet e subjektit në lidhje me analizën financiare për blerjen e dy dyqaneve dhe pasi mori në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, në përfundim të procesit, rishikoi analizën financiare dhe balanca negative u ul nga 3.828.530 lekë

<sup>66</sup>Në vendimin nr. 22/2019 të Kolegjit arsyetohet se: “Trupi gjykues, megjithëse e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se deklarimet periodike të subjektit kanë pasaktësi, vlerëson se bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, pasaktësitë në deklarimet periodike të pasurisë nuk përbëjnë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore”.

në 2.309.023 lekë. Ky përmirësim vjen si pasojë e rishikimit të analizës financiare për periudhën 1991 – fund të vitit 2003, periudhë gjatë së cilës është krijuar shuma *cash* me të cilën janë paguar të tria pasuritë e blera në vitin 2007.

**58.3.** Sa i takon pasaktësive në deklarin e vitit 2007, për shkak të mungesës së deklarimeve të burimit të krijimit të pasurive të blera gjatë këtij viti dhe mosdeklarimit të pakësimit të gjendjes *cash*, në kushtet kur në përfundim të procesit rezultoi që subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë justifikuar me të ardhura të ligjshme likuiditetin prej 4.000.000 lekësh në fund të vitit 2003, i cili pretendohet të jetë burim për krijimin e pasurive të blera në vitin 2007, këto pasaktësi marrin një peshë specifike të posaçme, të cilat e vënë subjektin në kushtet e pamjaftueshmërisë në deklarime, sipas parashikimit të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2014.

**59.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Gjendje cash, vlera 900.000 lekë. Burimi i krijimit: kursime 50% në bashkëpronësi me bashkëshortin*”. Meqenëse shuma *cash* e ka burimin nga gjendja *cash*, e krijuar gjatë periudhës janar 2007 – mars 2011<sup>67</sup>, Komisioni ka analizuar mundësinë e subjektit për të krijuar shumat ndër vite, sikurse është pasqyruar në tabelën *analiza financiare për periudhën e rivlerësimit*, dërguar me rezultatet e hetimit. Nga kjo analizë duket se subjekti nuk ka pasur mundësi të krijojë këtë gjendje likuiditeti me të ardhura të ligjshme. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Në parashtrimet e saj, subjekti ka prapësuar këtë konstatim, duke sjellë argumente të cilat janë analizuar në kuadër të analizës së detajuar të pretendimeve të subjektit për analizën financiare (trajtuar në paragrafin 81 të vendimit).

**60.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Autoveturë Reno, kontratë nr. \*\*\*, datë 6.11.2010, në shumën 270.000 lekë. Burimi i krijimit: kursime nga pagat. Pjesa takuese: 100%*”. ILDKPKI-ja, në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar: vlerë e dyshimtë e blerjes së automjetit tip “Renault”, me vlerë 270.000 lekë në vitin 2010, pasi shitësi ka shpenzuar po në vitin 2010 pothuajse 2-fishin e kësaj vlere për blerjen e tij.

**60.1** Në lidhje me këtë automjet, nga aktet në dosje<sup>68</sup> konstatohet se:

- DPSHTRR-ja nuk ka konfirmuar të regjistruar në pronësi të znj. Brunilda Çarçiu automjetin objekt shqyrtimi me nr. shasie \*\*\*, i cili pas dokumenteve të paraqitura nga subjekti<sup>69</sup> rezulton të ketë targën \*\*\* dhe të jetë shitur nga subjekti me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 18.7.2018, pra pas deklaratës *Vetting*.

- Sipas deklaratës doganore të datës 13.6.2010, shtetasi A. B. e ka blerë këtë automjet në Gjermani, në vlerën 1.950 euro dhe ka paguar doganën në shumën 137.893 lekë.

- Me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 6.11.2010 znj. Brunilda Carciu ka blerë nga shtetasi A. B. automjetin tip “Renault Clio” me targa \*\*\*, nr. shasie \*\*\*, në çmimin 270.000 lekë, për të cilin palët deklarojnë se janë likuiduar dhe nuk ka pretendime për gjendjen teknike të automjetit. Blerja e këtij automjeti është deklaruar nga subjekti edhe në DPV/2010 me të njëjtin çmim, por pa deklaruar burimin e krijimit.

- Vërehet se shtetasi A. B. ka shpenzuar për automjetin gjithsej shumën 408.573 lekë 1.950 euro/270.680 lekë<sup>70</sup> +137 893 lekë), ndërkohë që e ka shitur te znj. Brunilda Çarçiu në shumën 270.000, pra aq sa është çmimi i blerjes pa shpenzimin e zhdoganimit. Gjatë procesit të

<sup>67</sup>Në periudhën 2007 – 2011, subjekti ka deklaruar shtesa të gjendjes *cash*, duke arritur në vlerën 2.200.000 lekë në datën 31.12.2010. Gjatë periudhës së shkëputjes së subjektit nga detyra, kjo shumë është shpenzuar gradualisht deri sa kanë mbetur 900.000 lekë me të cilat subjekti vjen në DPV/2016 dhe në deklaratën *Vetting*.

<sup>68</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, nga DPSHTRR-ja, aktet në anekset \*\*\* dhe \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së dhe përgjigjet në pyetësorët dërguar subjektit.

<sup>69</sup>Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 4 në dosjen e Komisionit.

<sup>70</sup>Kursi i këmbimit 1 euro = 138.81 lekë, Banka e Shqipërisë, datë 31.12.2010.

rivlerësimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi marrëdhënien e tyre me shtetasin A. B. dhe arsyet e shitjes më lirë nga sa ai e kishte blerë. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se automjeti tip “Reno”, i cili kishte 5 muaj i reklamuar për shitje në ambient të jashtëm, është blerë në treg dhe pa asnjë lloj njohje me pronarin. Lidhur me shitjen më lirë sesa është blerë, subjekti ka deklaruar se është vënë në dijeni nga pyetësi. Më tej, ajo ka sqaruar se që në fillim automjeti i ka dhënë një defekt dhe ndoshta shitësi me këtë çmim i ka fshehur të metën që automjeti i shfaq pas vënies në përdorim prej saj, ndërsa në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti informoi se gjatë ushtrimit të detyrës si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë nuk ka dhënë opinione/relacione për çështje me palë shtetasin A. B. Subjekti ka paraqitur shkresën kthim përgjigje me nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2022, nga kancelari i Gjykatës së Lartë, sipas së cilës për këtë shtetas nuk ka pasur çështje të regjistruara në Gjykatën e Lartë.

**60.2.** Me njoftimin e barrës së provës, subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me konstatimin se duket se blerja e automjetit nga subjekti me çmim përafërsisht sa gjysma e çmimit që shitësi e kishte blerë atë, është jashtë logjikës ekonomike. Në parashtrimet e saj, në lidhje me këtë konstatim subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime, si dhe gjatë procesit të pambështetura me ndonjë provë shkresore. Në kushtet kur nuk u evidentuan elemente të konfliktit të interesit me shitësin e automjetit, Komisioni nuk e çmoi blerjen e tij në çmim më të ulët se çmimi i blerjes nga shitësi si shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit, ndonëse mbetet i dyshimtë çmimi i blerjes nga ana e subjektit.

**60.3.** Sa i takon burimit të krijimit, subjekti ka deklaruar kursimet nga pagat. Komisioni ka kryer analizën financiare për të evidentuar mundësinë e subjektit për blerjen e automjetit në datën 6.11.2010, e cila fillon në datën 29.5.2010<sup>71</sup>. Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën e caktuar, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur si në tabelën vijuese.

<i>Përshkrimi</i>	<i>29.5.2010 - 6.11.2010</i>
<b>Pasuri</b>	<b>580 784</b>
Automjet tip “Renault”, ***, blerë në datën 6.11.2010	270 000
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve</i>	<i>310 784</i>
Gjendja e likuiditeteve	2 030 748
<b>Të ardhura dokumentuar</b>	<b>704 992</b>
Të ardhura nga paga subjekti	593 992
Të ardhura nga paga bashkëshorti	111 000
<b>Shpenzime</b>	<b>578 378</b>
Shpenzime jetese për 4 persona	241 050
Shpenzime udhëtimi nga sistemi <i>TIMS</i>	337 328
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-454 170</b>

**60.4.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimit duket se subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura për blerjen e automjetit objekt shqyrtimi për shkak të balancës negative prej 454.170 lekësh. Në parashtrime, subjekti e kundërshtoi këtë konstatim dhe ka paraqitur argumentet në lidhje me analizën financiare, duke kërkuar përfshirjen e të ardhurave nga qiraja dhe dhuratën e dollarëve nga SHBA-ja, trajtuar hollësisht në prapësimet e bëra nga subjekti mbi analizën financiare në paragrafin 81 të këtij vendimi.

<sup>71</sup>Kjo është bërë për të shmangur mbivendosjen e rezultateve, pasi në këtë datë është blerë një tjetër automjet i cili është analizuar më vete.

**60.5.** Komisioni, pasi analizoi pretendimet e subjektit në lidhje me analizën financiare për blerjen e automjetit objekt shqyrtimi dhe pasi konsideroi përfshirjen e të ardhurave nga qiraja për periudhën e analizuar, në përfundim të procesit, rishikoi analizën financiare, sipas së cilës balanca negative u ul nga 454.170 lekë në 334.170 lekë.

**61.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “Llogari ‘Raiffeisen Bank’, gjendje më 25.1.2017, në shumën 592.523 lekë. Burimi i krijimit: paga, honorare dhe mësimdhënie. Pjesa takuese: 100%”. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, “Raiffeisen Bank” konfirmoi llogarinë e pagës së subjektit dhe gjendjen e deklaruar prej saj në deklaratën *Vetting*. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.

**62.** Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “Llogari në ‘Raiffeisen Bank’, krijuar më 19.9.2016, gjendje më 25.1.2017, në shumën 22 euro. Burimi i krijimit: pakësim i gjendjes cash në vlerën 2.800 euro. Pjesa takuese: 100%”. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, “Raiffeisen Bank” konfirmoi llogarinë në euro të subjektit dhe gjendjen e deklaruar prej saj në deklaratën *Vetting*. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.

### **Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur A. Ç., bashkëshorti i subjektit**

**63.** Z. A. Ç. ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij dhe ka deklaruar pasuritë:

### **Pasuri të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit**

**64.** Në deklaratën *Vetting* bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “Automjet tip ‘Mercedes-Benz’, kontratë shitblerje nr.\*\*\*, datë 29.5.2010, me targa \*\*\*. Vlera: 630.000 lekë. Pjesa takuese 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat nga pagat dhe shitja e Benzit 190 të mëparshëm, në shumën 400.000 lekë”.

ILDKPKI-ja, në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar: (i) në deklaratën e interesave private periodike vjetore të vitit 2005, bashkëshorti A. Ç. e ka deklaruar automjetin tip “Mercedes-Benz 190”, me vlerë 250.000 lekë, ndërkohë që këtë automjet në vitin 2010 e ka deklaruar të shitur në vlerën 400.000 lekë; (ii) subjekti nuk ka paraqitur kontratën e blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz 190”, deklaruar në vitin 2005, në vlerën 250.000 lekë. Sa më sipër rezulton se duke marrë në konsideratë zhvlerësimin e mjeteve, nisur nga deklarimi i subjektit se automjetin tip “Mercedes-Benz” e ka blerë në vitin 2005, me çmimin 250.000 lekë dhe më pas e ka shitur atë në vitin 2010 me çmimin 400.000 lekë, krijohen dyshime se çmimi i blerjes në vitin 2005 dhe/ose i shitjes në vitin 2010 nuk kanë qenë çmime reale.

**64.1.** Në lidhje me këtë mjet nga aktet në dosje<sup>72</sup> rezultoi se:

- DPSHTRR-ja ka konfirmuar të regjistruar në pronësi të shtetasit A. Ç. automjetin me targa \*\*\* që, nisur nga numri i shasisë, i përket automjetit objekt verifikimi.

- Sipas faturës së shitjes të datës 11.12.2009, shtetasi Y. C. e kishte blerë këtë automjet në Gjermani në shumën 2.800 euro dhe sipas deklaratës doganore të datës 13.12.2009 është bërë zhdoganimi i automjetit në vlerën 268.694 lekë.

- Me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*\*, datë 29.5.2010, shtetasi A. Ç. ka blerë nga shtetasi Y. C. automjetin tip “Daimler Chrysler” (\*\*\*), me nr. shasie \*\*\*, në shumën 630.000 lekë, pagesë e cila do të merret nga shitësi me regjistrimin e mjetit. Blerja e këtij automjeti është deklaruar nga subjekti në DPV/2010, por pa deklaruar burimin e krijimit.

- Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti informoi se gjatë ushtrimit të detyrës si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë nuk ka dhënë opinione/relacione për çështje me palë shtetasin Y.C.

<sup>72</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit, aktet në anekset \*\*\* dhe \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

Subjekti ka paraqitur shkresë kthim përgjigje me nr. \*\*\* prot., datë 1.3.2022, nga kancelari i Gjykatës së Lartë, sipas së cilës ndaj shtetasit Y. C. nuk ka çështje të regjistruara në gjykatë.

**64.2.** Në lidhje me burimin e krijimit në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar të ardhurat nga pagat dhe shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz 190” të mëparshëm, në shumën 400.000 lekë. Komisioni ka kryer analizë specifike të të dyja burimeve, si vijon:

**64.3.** Në lidhje me burimin e të ardhurave nga pagat janë konsideruar pagat e subjektit dhe bashkëshortit për harkun kohor 1 janar - 29.5.2010, të cilat rezultojnë të jenë në shumën 587.493 lekë.

**64.4.** Në lidhje me burimin të ardhura nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz 190” të mëparshëm, në shumën 400.000 lekë, konstatohet se:

- Me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 30.6.2010, shtetasi A. Ç. i ka shitur shtetasit I. K., automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, nr. shasie \*\*\*, në shumën 400.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Kjo shitje është deklaruar nga subjekti në DPV/2010. Siç vërehet, shitja e këtij automjeti është bërë 1 muaj pas blerjes së automjetit objekt verifikimi me targa \*\*\*\*\*, datë 29.5.2010 dhe, për këtë arsye, është e paqartë si kanë shërbyer këto të ardhura si burim krijimi për këtë automjet. E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi këtë fakt, subjekti ka sqaruar se<sup>73</sup> ata kishin marrë lekët nga shtetasi I. K., kundrejt dhënies së automjetit dhe thjesht kontratën e formalizuan më pas dhe kjo për shkak të angazhimeve të palës blerëse dhe mungesës së kohës, duke evidentuar besimin reciprok. Ky shpjegim i subjektit, sa i takon kohës së marrjes së të ardhurave nga shitja, u konsiderua bindës dhe, për këtë arsye, të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa \*\*\*, janë përfshirë si burim për blerjen e automjetit objekt shqyrtimi më 29.5.2010.

- Në lidhje me mënyrën e përfitimit të automjetit tip “Mercedes-Benz 190”, me targa \*\*\*\*, nga verifikimi i deklarimeve të bashkëshortëve rezultoi se bashkëshorti i subjektit, z. A. Ç., në DPV/2005 ka deklaruar automjetin tip “Mercedes-Benz 190”, në shumën 250.000 lekë, me pjesë takuese 100%, pa deklaruar burimin e krijimit. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka paraqitur kontratën e blerjes nr. \*\*\*, datë 2.6.2005, në vlerën 250.000 lekë. Subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

- Ndërsa i pyetur mbi arsyet e shitjes së këtij automjeti pas 5 vjetësh në një vlerë më të lartë (400.000 lekë) sesa çmimi i blerjes 250.000 lekë, subjekti sqaruar se nuk ka ndonjë arsye specifike përveç faktit që blerësi donte të blinte këtë lloj automjeti “Mercedes-Benz”, i cili ishte mirëmbajtur dhe në gjendje shumë të mirë teknike dhe se i hynte në punë në veprimtarinë e tij. Në kushtet kur ky pretendim është në kuadër deklarativ dhe nuk justifikohet shitja e automjetit në vlerën 400.000 lekë (rreth dyfishin e çmimit të blerjes dhe pas pesë vitesh nga data e blerjes) në vitin 2010, në analizën financiare si e ardhur e ligjshme nga shitja u konsiderua vlera 250.000 lekë.

- Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi për blerjen e automjetit më 29.5.2010, pavarësisht një balancë negative prej 53.357 lekësh është vlerësuar e pakonsiderueshme. Me rishikimin e analizës financiare, në përfundim të procesit, duke përfshirë në këtë analizë të ardhurat nga qiraja për periudhën e analizuar, kjo balancë bëhet nga negative në pozitive.

**65.** Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Depozitë në ‘Raiffeisen Bank’, krijuar më 13.2.2013, gjendja më 25.1.2017, në shumën 10.148 USD. Burimi i krijimit: shuma të dërguara nga kunati, si dhe nga kursimet e falura nga babai*”. ILDKPKI-ja, në lidhje me këtë pasuri, ka konstatuar: (i) bashkëshorti i subjektit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për burimin e krijimit të depozitës në shumën 10.148 USD, nga kunati dhe

<sup>73</sup>Shihni përgjigjen e pyetjes 5.2 në pyetësorin nr. 2, në dosjen e Komisionit.

nga babai, si dhe dokumentacion justifikues ligjor për marrëdhëniet juridike të dhurimit të shumës nga babai dhe dërgimit nga kunati; (ii) nuk ka deklaruar sa ka qenë konkretisht vlera monetare e dërguar nga kunati dhe ato të falura nga babai; (iii) QKB-ja nuk ka konfirmuar që babai i subjektit të ketë kryer aktivitet privat.

Në lidhje me këtë depozitë u evidentua se:

**65.1.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, “Raiffeisen Bank” konfirmoi këtë depozitë të bashkëshortit të subjektit dhe gjendjen e deklaruar prej tij në deklaratën *Vetting*. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.

**65.2.** Në lidhje mënyrën dhe burimin e krijimit të kësaj depozite, rezultoi se:

i) Bashkëshorti i subjektit në DPDFD/2015 ka deklaruar: “*Depozitë në ‘Raiffeisen Bank’, krijuar më 13.2.2013, gjendja më 20.2.2015, në shumën 10.119 USD. Burimi i krijimit: të dhëna nga nipi, si dhe kursimet e dhuruara nga babai*”.

ii) Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj depozite shumat e dërguara nga kunati dhe kursimet e falura nga babai.

iii) Në përgjigjen e pyetësorit standard subjekti ka informuar se ka marrë nga kunati dhe nipi (familja R. në SHBA) me transfertë bankare shumën 2.057 USD, pasi bashkëshorti, me prokurë të posaçme të lëshuar prej tyre, ka qenë i autorizuar për të kryer veprimet për blerjen e apartamentit në Tiranë dhe ka marrë shumën 7.000 USD *cash*, pas dasmës së D.<sup>74</sup> në qershor të vitit 2012 dhe shumën 1.000 USD nga babai i bashkëshortit, i cili ka ndërruar jetë më 28.4.2013. Gjithashtu informon se deklaroi në konfidencë se nëna e bashkëshortit iu ka dhënë para vdekjes<sup>75</sup> shumën 350.000 lekë.

**65.3.** E pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi mënyrën e dhënies së shumave të mësipërme, duke i dokumentuar këto veprime, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti informoi se: (a) nga babai është dhuruar shuma 1.000 USD, në shenjë mirënjohjeje për përkujdesjen e tyre ndaj tij, i cili ka ndërruar jetë më 28.4.2013 dhe se për shkak të marrëdhënieve babë e bir nuk është bërë ndërmjet tyre ndonjë kontratë apo provë me shkresë për shprehjen e vullnetit; (b) shuma 9.000 USD është dhënë nga familja R., nga e cila 2.000 USD me transfertë bankare, mbetur nga blerja e banesës së porositur nga familja R. dhe 7.000 USD *cash* në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për organizimin e dasmës në vitin 2012, deklaruar edhe nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit nr. 1. Sipas subjektit, ky shtetas amerikan ka qenë dhe vazhdon të jetë në marrëdhënie pune. Për të mbështetur këto pretendime, subjekti ka paraqitur deklaratë të datës 5.2.2017, të shtetasit D. R., banues në SHBA, me profesion arkitekt, në të cilën deklaroi se në shenjë respekti dhe mirënjohjeje për organizimin e dasmës së tij në vitin 2012 i ka dhuruar dajës së tij A. Ç. shumën 9.000 USD. Nga kjo shumë, 2.000 USD janë dorëzuar me anën e një transferte bankare, si dhe 7.000 USD janë dorëzuar *cash*.

**65.4.** Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank” është evidentuar se janë kryer këto veprime: (i) në datën 20.10.2010 ka ardhur me transfertë shuma 1.958 USD nga llogaria e shtetasve K. ose D. R., duke bërë që balanca e llogarisë në këtë datë të jetë në vlerën 2.057,45 USD; (ii) në datën 13.2.2013, bashkëshorti i subjektit ka depozituar në llogarinë bankare në “Raiffeisen Bank” shumën 8.000 USD me përshkrimin “A. Ç. derdh në llogari”. Në këtë datë, balanca në llogarinë e tij është bërë 10.057,89 USD dhe është investuar në depozitë me afat, e cila vazhdon të jetë në bankë deri në datën 31.12.2016<sup>76</sup>. Shuma 8.000 USD, sipas deklarimeve të subjektit gjatë hetimit

<sup>74</sup>Ka parasysht D. R., emër i evidentuar në transfertat e “Raiffeisen Bank”.

<sup>75</sup>Data e vdekjes është deklaruar më 24.8.2017.

<sup>76</sup>Aneksi \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

administrativ, rrjedh prej dhuratës 7.000 USD nga shtetasi D. R. dhe 1.000 USD nga babai i bashkëshortit.

**65.5.** Në përfundim të hetimit administrativ, shumat e mësipërme janë përfshirë te likuiditetet (pasuritë) e z. A. Ç., në analizën financiare për periudhën 2010 – 2016, por nuk janë përfshirë si të ardhura për sa kohë që subjekti nuk ka provuar me dokumentacion të ardhura të ligjshme të shtetasit D. R. dhe as të babait të bashkëshortit.

**65.6.** Nga analiza financiare e kryer deri në përfundim të hetimit administrativ, bashkëshorti i subjektit duket se nuk ka pasur mundësi për krijimin e depozitës objekt verifikimi, pasi: (i) nuk u provuan të ardhura të ligjshme që kanë shërbyer si burim për shumat e dhuruara në favor të bashkëshortit të subjektit nga familja R. dhe nga babai i tij; (ii) subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi të krijojnë me të ardhura të tyre të ligjshme shumën 2.057 USD të transferuar në llogarinë e bashkëshortit në tetor të vitit 2010, për shkak të një balance negative të këtij viti në shumën 1.211.116 lekë<sup>77</sup>; (iii) subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi të krijojnë me të ardhura të ligjshme shumën 8.000 USD, të depozituar në shkurt të vitit 2013<sup>78</sup>. Me njoftimin e rezultateve të hetimeve, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

**65.7.** Në parashtrimet e veta, subjekti ka paraqitur pretendime në kuadër të analizës financiare mbi mundësinë e krijimit të depozitës objekt verifikimi, ë cilat janë krijuar pjesërisht jashtë periudhës së detyrës dhe pjesërisht gjatë detyrës. Pretendimet e subjektit, në kundërshtim të barrës së provës për secilën nga periudhat, janë trajtuar hollësisht në paragrafët 74 dhe 81 të këtij vendimi.

**66.** Në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “Gjendje në lekë në datën 25.1.2017, në ‘Raiffeisen Bank’, në shumën 236.144 lekë, llogari rrjedhëse. Bono thesari në shumën 3.000.000 lekë. Obligacione në shumën 2.500.000 lekë. Burimi i krijimit: paga, zbatim vendimi gjykate për dëmshpërblim nga marrëdhëniet e punës nr. \*\*\*, datë 16.6.2006, shuma e llogarisë në euro, kthyer në lekë dhe interesa nga bonot dhe obligacionet. Pjesa takuese: 100%”.

Në lidhje me këtë depozitë u evidentua se:

**66.1.** “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, konfirmon: (i) llogarinë rrjedhëse në të cilën kalon paga e z. A. Ç. dhe gjendjen e saj në shumën e deklaruar prej tij; (ii) bonon e thesarit në shumën 3.000.000 lekë; (iii) obligacionin në shumën 2.500.000 lekë. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.

**66.2.** Në lidhje me burimin e krijimit të këtyre llogarive dhe investimeve financiare, nga lëvizjet e llogarive të bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank”<sup>79</sup>, është evidentuar se:

i) Tepricat në llogarinë e pagës janë kursime të pagës së pa tërhequr, pra janë krijuar me burim të ligjshëm.

ii) Sa i takon bonove të thesarit në shumën 3.000.000 lekë, ato janë krijuar me një pjesë nga dëmshpërblimi i bashkëshortit të subjektit, i kredituar në “Raiffeisen Bank”, sipas vendimit nr.\*\*\*, datë 16.6.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pra, ky investim është krijuar me burime të ligjshme.

iii) Sa i takon obligacioneve në shumën 2.500.000 lekë, të investuara në datën 12.11.2015, me afat 2-vjeçar, janë krijuar nga:

<sup>77</sup>Shihni analizën financiare të vitit 2010.

<sup>78</sup>Shihni analizën financiare të periudhës jashtë detyrës.

<sup>79</sup>Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, nga “Raiffeisen Bank”, bashkëlidhur së cilës ndodhen lëvizjet e llogarive bankare të bashkëshortit në këtë bankë.

- akumulimi i shumave të mbetura, të transferuara në llogarinë e z. A. Ç., nga vijimi i ekzekutimit të vendimit nr. 456 të gjykatës, gjatë periudhës dhjetor 2013 – tetor 2015;
- depozitimi *cash* i shumës 1.000.000 lekë, në datën 30.10.2015, nga bashkëshorti i subjektit, e cila vjen nga konvertimi i një pjese të shumës 7.000 euro, depozituar *cash* në datën 31.12.2013, për të cilën subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për ta krijuar këtë shumë.

Për rrjedhojë, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e shumës 2.500.000 lekë, investuar në obligacione më 30.10.2015, të cilat subjekti i ka deklaruar edhe në deklaratën *Vetting*. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi. Trajtimi i pretendimeve të subjektit është kryer në paragrafin 74 të këtij vendimi.

**67.** Në deklaratën *Vetting* bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Alpha Bank”, krijuar më 1.1.2011, gjendja në datën 25.1.2017, në shumën 707 euro, 449.584 lekë. Burimi i krijimit: honorare nga U. G. Sh., si dhe kursime. Pjesa takuese: 100%”*.

Në lidhje me këtë llogari depozite u evidentua se:

**67.1.** “Alpha Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020, konfirmon se shtetasi A. Ç. ka tri llogari në lekë, euro dhe dollar, si dhe ka konfirmuar shumat e deklaruara nga bashkëshorti në deklaratën *Vetting*. Nga lëvizjet e këtyre llogarive evidentohet se burimi i krijimit të tyre është ai i deklaruar nga subjekti. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.

**67.2.** Sa i takon mundësisë së subjektit dhe bashkëshortit për t’i kursyer këto shuma, nga analiza financiare për periudhën jashtë detyrës duket se nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi. Trajtimi i pretendimeve të subjektit është kryer në paragrafin 74 të këtij vendimi.

**68.** Në deklaratën *Vetting* bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Depozitë në BKT, krijuar më 1.1.2009, gjendja në datën 25.1.2017, në shumën 1.091.793 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga e kaluar në këtë bankë nga \*\*\* sh.p.k., kursime e interesa. Pjesa takuese: 100%”*.

Në lidhje me këtë llogari depozite u evidentua se:

**68.1.** BKT-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2020, konfirmon këtë depozitë me afat dhe gjendjen e saj në deklaratën *Vetting*. Nga lëvizjet e llogarisë së bashkëshortit evidentohet se kjo depozitë është çelur në datën 19.4.2013, në shumën 1 milion lekë me burim: (i) shumat e kursyera dhe të pa tërhequra nga llogaria e pagës, të cilat në datën 28.3.2013 kanë qenë në vlerën 748.132 lekë; (ii) shuma 252.000 lekë që është depozituar *cash* nga bashkëshorti në datën 19.4.2013. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.

**68.2.** Sa i takon mundësisë së subjektit dhe bashkëshortit për t’i kursyer këto shuma, nga analiza financiare jashtë periudhës së detyrës, duket se nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme. Me njoftimin e rezultateve të hetimeve, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi. Trajtimi i pretendimeve të subjektit është kryer në paragrafin 74 të këtij vendimi.

**69.** Në deklaratën *Vetting* bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: *“Intesa Sanpaolo Bank”, krijuar më 1.1.2013, gjendja në datën 25.1.2017, në shumën 703.203 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga e kaluar në këtë bankë nga shoqëria ‘\*\*\*’ sh.p.k. Pjesa takuese: 100%”*.

Në lidhje me këtë llogari depozite u evidentua se:

**69.1.** “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2020, konfirmon këtë llogari dhe gjendjen e saj, sikurse deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në deklaratën *Vetting*. Nga



lëvizjet e llogarisë së bashkëshortit evidentohet se kjo shumë është krijuar nga pagat e derdhura nga shoqëria “\*\*\*”, për periudhën shkurt 2013 – mars 2015, paga të cilat bashkëshorti nuk i ka tërhequr, por i ka lënë në bankë si kursime. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.

**69.2.** Sa i takon mundësisë së subjektit dhe bashkëshortit për t’i kursyer këto shuma, nga analiza financiare jashtë periudhës së detyrës duket se nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme. Me njoftimin e rezultateve të hetimeve, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi. Trajtimi i pretendimeve të subjektit është kryer në paragrafin 74 të këtij vendimi.

**70.** Në deklaratën *Vetting* bashkëshorti i subjektit ka deklaruar: “*Bashkëpronar në asetet me nr.1, 2, 3, 4 të deklaruara nga bashkëshortja në faqet 5 dhe 6 të deklaratës së saj. Pjesa takuese: 50%*”. Trajtuar në analizën e pasurive të deklaruara nga subjekti.

**71.** Në rubrikën “Detyrime financiare” subjekti ka deklaruar kartë krediti në BKT, me limit 50.000 lekë, e papërdorur. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.

#### **Deklarimi i vajzës së subjektit A. Ç.**

**72.** Në deklaratën *Vetting* vajza e subjektit ka deklaruar: “*Llogari rrjedhëse në ‘Abi Bank’.* Gjendja në datën 26.1.2017 është 121.720 lekë”.

Në lidhje me këtë llogari u evidentua se:

**72.1.** “Intesa Sanpaolo Bank”, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2020, konfirmon këtë llogari dhe gjendjen e saj, sikurse është deklaruar nga vajza e subjektit në deklaratën *Vetting*. Nga lëvizjet e llogarisë së znj. E. Ç. evidentohet se kjo shumë është krijuar nga pagat e derdhura nga shoqëria “\*\*\*”, nga marsi i vitit 2015 e në vijim. Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin bankar.

**72.2.** Nga analiza financiare duket se ata nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi. Trajtimi i pretendimeve të subjektit është kryer në paragrafin 74 të këtij vendimi.

#### **Analizë për verifikimin e mundësisë financiare për krijimin e pasurive/likuiditeteve në paragrafët 65-72 të këtij vendimi, që i përkasin periudhës jashtë detyrës 3.3.2011 – 18.11.2016**

**73.** Meqenëse këto likuiditete vijnë deri në deklaratën *Vetting*, por janë krijuar gjatë periudhës jashtë ushtrimit të detyrës, mars 2011 – nëntor 2016, është kryer analiza financiare e kësaj periudhe për të verifikuar mundësinë e subjektit dhe bashkëshortit për t’i krijuar këto pasuri/likuiditete, të cilat janë pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese.

<i>Përshkrimi</i>	<i>Periudha 3.3.2011 – 18.11.2016</i>
<b>Pasuri</b>	<b>8 748 823</b>
Parcele ndërtimore	567 467
<i>Shtesa /pakësime likuiditeteve<sup>80</sup></i>	<i>11 016 074</i>
<b>Të ardhura dokumentuar</b>	<b>11 078 717</b>
Të ardhura nga paga subjekti	3 083 011
Të ardhura nga paga bashkëshorti	2 744 250
Nga qiratë e dyqanit	28 050
Ekzekutimi i vendimit të gjykatës	4 528 725

<sup>80</sup>Në këtë analizë, gjendja *cash* e mbartur nga data 3.3.2011, në shumën 2.2 milionë lekë, është pakësuar në shumën 600.000 lekë, sipas deklarimeve të subjektit për periudhën e mësipërme. Meqenëse, subjekti nuk ka dhënë shpjegime për sasinë e gjendjes *cash* të shpenzuar për çdo vit, kjo shumë është konsideruar si e shpenzuar për 5 vjet, në mënyrë të barabartë.

Interesa bankare	297 046
Bono privatizimi	330 000
Pagesë në "Raiffeisen Bank" shuma 500 euro	67 635
<b>Shpenzime</b>	<b>5 577 284</b>
Shpenzime jetese	3 463 820
Shpenzime udhëtimi nga sistemi <i>TIMS</i>	1 530 629
Shpenzime për shkollën e vajzës në Slloveni	568 134
Shpenzime të tjera/të ndryshme	14 700
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-3 247 390</b>

Sipas kësaj analize duket se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të krijuar pasuri (të paluajtshme dhe likuiditete në banka dhe *cash*) dhe, për këtë arsye, gjendjet e llogarive bankare të deklaruara në deklaratën *Vetting* nga bashkëshorti, nuk janë konsideruar të krijuara me burime të ligjshme. Kjo pamundësi e subjektit në shumën prej 3.247.390 lekësh është reflektuar në analizën financiare të harkut kohor 18 nëntor deri në dhjetor të vitit 2016, pasi, megjithëse depozitat janë krijuar jashtë detyrës, ato mbarten deri në deklaratën *Vetting*.

### **Qëndrimi i subjektit dhe vlerësimi i Komisionit**

**74.** Në parashtrimet e veta, subjekti ka pretenduar se barra e provës mbi mundësinë financiare të krijimit të depozitave në periudhën që ka qenë specialiste në KLD, një punonjëse e nivelit bazë, pa kompetenca vendimmarrëse, është joproporcionale dhe përtej qëllimit të ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka kërkuar nga Komisioni që në analizën financiare të kësaj periudhe të përfshihen disa të ardhura dhe të rishikohen disa shpenzime, duke ngritur disa pretendime të cilat janë analizuar një nga një si vijon. Konkretisht, subjekti ka kërkuar:

- Të përfshihen të ardhurat e përfituara nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor në shumat 3.380.769 lekë dhe 1.147.956 lekë. Këto të ardhura ishin përfshirë në analizë që me dergimin rezultateve të hetimit.

- Të përfshihen të ardhura nga dhurimi i vjehrrit i shumës 1.000 USD dhe familja R. në shumën 7.000 USD ose gjithsej shumën 8.000 USD/852.560 lekë. Subjekti ka provuar me dokumentacion të ardhura nga z. D. R., në shumën 97.367.44 USD për vitin 2012<sup>81</sup>, nga të cilat duket se z. R. ka pasur mundësi financiare për të dhuruar shumën 7.000 USD në vitin 2012. Për këtë arsye kjo shumë është përfshirë si e ardhur e ligjshme në analizën financiare të rishikuar të këtij viti. Ndërsa sa i takon shumën 1.000 USD, të dhuruar nga vjehrrit i saj në vitin 2012, subjekti ka dhënë disa shpjegime duke sqaruar se kjo është një shumë simbolike, të cilën babai i bashkëshortit ka pasur mundësi ta kursejë gjatë gjithë jetës së tij, por nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion për të provuar pretendimet e saj, përveç dokumenteve që vërtetojnë pensionet e prindërve të bashkëshortit deri në vitin 2000. Megjithatë, edhe në rastin që mund të merren vlera reference të pensioneve të prindërve, ato janë të ardhura minimale, të cilat janë edhe më të ulëta se shpenzimet e jetesës për person sipas standardit të ILDKPKI-së. Për këtë arsye, shuma 1.000 USD nuk është konsideruar si e ardhur e ligjshme në analizën përfundimtare financiare të vitit 2012.

- Të përfshihen të ardhura të vajzës E. Ç. në shumën 778.462 lekë, pretendim i cili është marrë në konsideratë, pasi janë provuar me dokumentacion të ardhurat e vajzës nga punësimi në shoqërinë "\*\*\*\*" sh.p.k. dhe nga lëvizja e llogarisë së vajzës në "Intesa Sanpaolo Bank".

- Të përfshihen të ardhurat e vajzës A. Ç. në shumën 121.720 lekë, pretendim i cili nuk është marrë në konsideratë, pasi nga verifikimi i lëvizjes së llogarisë së pagës së vajzës në "ABI

<sup>81</sup>Subjekti ka paraqitur dokumentin zyrtar të të ardhurave personale nga punësimi për vitin 2012, i përkthyer dhe noterizuar.

Bank", ka rezultuar se ajo ka filluar të marrë pagë nga nëntori i vitit 2016 dhe kjo pagesë është konsideruar si e ardhur brenda periudhës së rivlerësimit.

- Të përfshihen të ardhurat nga qiraja në total në shumën 484.125 lekë. Nga analiza e dokumenteve, fakteve dhe rrethanave në lidhje me qiratë, trajtuar në paragrafin 55 të këtij vendimi, Komisioni çmoi të përfshijë shumat e përfituara nga qiraja në analizën e vitit 2012 dhe pesë muaj për vitin 2016.

- Të përfshihen të ardhura të bashkëshortit për vitin 2011 në shumën 600.000 lekë, për vitin 2013 në shumën 720.000 lekë dhe për vitin 2014 në shumën 660.000 lekë, sipas 2 vërtetimeve të paraqitura nga subjekti në datën 16.6.2022, pas seancës dëgjimore të datës 14.6.2022. Ky pretendim nuk u mor në konsideratë, pasi subjekti nuk provoi pagesë të tatimit në burim për këto të ardhura.

- Të merret në konsideratë që vlera e paguar në vitin 2014 për privatizimin e truallit poshtë ndërtesës së ndërtuar në mënyrë informale është në vlerën 270.467 lekë, ndryshe nga ajo e përlllogaritur nga Komisioni në shumën 567.467 lekë, për shkak se bonot e privatizimit si letra me vlerë janë blerë në treg dhe vlera e blerjes së tyre është vetëm 10% e vlerës së shënuar në këto letra me vlerë. Bashkëlidhur subjekti ka paraqitur dokumentacionin nga Banka e Shqipërisë për të provuar çmimin e blerjes së bonove të privatizimit në treg. Ky pretendim i subjektit nuk qëndron dhe nuk u mor në konsideratë, pasi në rezultatet e hetimit është përfshirë si e ardhur 1/4 e shumës 1.320.0000 lekë (820.000 dhe 500.000 lekë), shumë e paguar me bono privatizimi në datën 17.12.2014 në "Credins Bank" dhe, për këtë arsye, analiza e Komisionit, dërguar me rezultatet e hetimit, është e saktë pasi bazohet në provat e administruara në dosjen e subjektit për këtë çështje.

- Të rishikohen shpenzimet e udhëtimit për vitet 2011, 2012 dhe 2016, pretendim i cili është konsideruar nga Komisioni, pasi subjekti ka paraqitur dokumentacion provues<sup>82</sup> që ka vizituar familjarë të saj që punojnë e jetojnë jashtë shtetit në ditët e pretenduara prej saj dhe të deklaruara në pyetësonin standard. Në këto kushte, kostoja ditore për ditët e qëndrimit të afërm u reduktua nga 50 euro/ditë në 5 euro/ditë.

Në mbështetje të pretendimeve të veta, subjekti ka paraqitur një analizë financiare të rishikuar prej saj, për periudhën mars 2011 – nëntor 2016, me një balancë negative prej 415.429 lekësh.

Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar në sa më sipër, Komisioni rishikoi analizën financiare për periudhën jashtë detyrës, 3.3.2011 – 18.11.2016, sipas së cilës balanca negative e dërguar me rezultatet e hetimit ndryshoi nga 3.247.390 lekë në 1.155.914 lekë.

### **Konstatime të tjera**

**75.** Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësonit nr. 2, subjekti ka paraqitur, ndër të tjera, edhe dokumentet:

- Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 15.9.2009, e lidhur mes palës sipërmarrës/investitor, shoqëria "\*\*\*\*" sh.p.k., përfaqësuar nga administratori S. K. (me prokurë nga z. A. S.), shoqëria "\*\*\*\*\*" sh.p.k., përfaqësuar nga administratori P. B. dhe palës porositëse D. R., përfaqësuar me prokurë nga shtetasi A. Ç., me objekt ndërtimin e një apartamenti me sip. 68.21 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, kati i \*\*\*-të. Po sipas kësaj kontrate, porositësi kërkon të blejë edhe një garazh, vendi i të cilit do të caktohet pas ndarjes me pronarët. Vlera totale e apartamentit është 47.000 euro.

---

<sup>82</sup>Subjekti ka paraqitur tri deklarata noteriale nga rezidentë në shtetin grek dhe konkretisht: deklaratë noteriale datë 8.6.2022, të vajzës së xhaxhait L. Sh. (A.), ku vërtetohet se në harkun kohor 1.8.2011 - 8.8.2011, subjekti ka qëndruar familjarisht, në shtëpinë e saj; deklaratë noteriale datë 6.6.2022, të djalit të dajës A. G., ku vërtetohet se në harkun kohor 4.8.2012 - 17.8.2012, ka qëndruar familjarisht në shtëpinë e tij; gjithashtu, vajzat E. dhe A. kanë qëndruar në shtëpinë e tij në harkun kohor 7.8.2016 - 15.8.2016.

- Prokurë e posaçme e datës 9.7.2009, legalizuar me vulë apostile, sipas së cilës shtetasit A., K. dhe D. R. kanë emëruar si përfaqësues të posaçëm shtetasin A. Ç. për të kryer në emër dhe për llogari të tyre të gjitha veprimet ligjore dhe administrative për blerjen e një apartamenti banimi në Tiranë dhe pagimin e lekëve për këtë qëllim, si dhe hipotekimin e pronës në emër të këtyre tre shtetasve në pjesë të barabarta.

**75.1.** Me qëllim heqjen e çdo dyshimi që kjo mund të jetë një pasuri e subjektit, gjatë hetimit administrativ, u kryen verifikimet si vijojnë:

- Nga verifikimet e lëvizjeve të llogarisë bankare të bashkëshortit të subjektit në “Raiffeisen Bank”, është evidentuar se janë kryer ndër të tjera edhe veprimet: (i) në datën 6.7.2009 ka ardhur me transfertë shuma 14.917.59 USD nga llogaria e shtetasve K. R. etj. Në datën 17.7.2009 kjo shumë është transferuar nga llogaria e z. A. Ç. në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. me përshkrimin “blerje apartamenti nga D. (E.) R.”; (ii) në datën 1.9.2009 ka ardhur me transfertë shuma 47.099.24 USD nga llogaria e shtetasve D. R. etj. Në datën 15.9.2009 shuma 47.000 USD është transferuar nga llogaria e z. A. Ç. në llogarinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me përshkrimin “blerje apartamenti nga D. R.”.

- Siç vërehet në llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. është derdhur nga z. A. Ç. në total shuma 62.000 USD, e konvertuar në euro është rreth 47.000 euro<sup>83</sup>, pra, njësoj sa parashikohet në kontratën e porosisë. Ndërkohë, duke qenë se u vërtetua që shumat e dërguara nga familja R. nga SHBA-ja janë dërguar dhe kanë kaluar te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. me transferata bankare, me përshkrimin “për blerje shtëpie nga D. R.”, nuk u vlerësua t’i kërkohet burimi i ligjshëm i këtyre shumave.

- Nga verifikimi në sistemin *online* të ASHK-së rezulton se në emër të z. D. K. R. rezulton e regjistruar pasuria e llojit apartament me sip. 59.99 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, në \*\*\*, me vlerë 47.000 USD, e regjistruar në datën 31.5.2016. Ndërsa nga verifikimi për shtetasit A. dhe B. Ç. nuk rezultoi e regjistruar ndonjë pasuri tjetër, përveç atyre objekt verifikimi në këtë raport. Pra, siç vërehet, nisur nga çmimi në kartelën e pasurisë, duket se apartamenti i regjistruar në emër të z. D. R. është apartamenti objekt i kontratës së porosisë të datës 15.9.2009.

- Pas kërkesës së Komisionit, subjekti paraqiti<sup>84</sup>: (i) kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 20.5.2016, sipas së cilës shtetasi D. R. (personalisht) ka blerë nga shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k. apartamentin me sip. 59.99 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Tiranë (sip. e përbashkët 8.22 m<sup>2</sup> dhe sip. totale 68.21 m<sup>2</sup>) me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me çmim 47.000 euro; (ii) certifikatë për vërtetim pronësie + kartelë pasurie, sipas të cilave pasuria me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, është regjistruar në datën 31.5.2016, në pronësi të shtetasit D. R.

- FSHU-ja<sup>85</sup> dhe UKT-ja<sup>86</sup> nuk konfirmuan kontrata përkatëse me shtetasit A. apo Brunilda Çarçiu.

**75.2.** Në përfundim të hetimit administrativ nuk rezultuan lidhje të subjektit me këtë pasuri.

**76.** Në deklaratën e vitit 2003 subjekti ka deklaruar automjet me vlerë 300.000 lekë, me burim krijimi të ardhura nga pagat, ndërkohë që ky automjet nuk është deklaruar në deklaratimet e mëpasshme të subjektit dhe bashkëshortit. Në kushtet e mungesës së informacionit mbi këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ, u kryen verifikimet si vijojnë:

- Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti informoi se automjeti tip “Golf”, e vitit 1986, e blerë prej tyre në vitin 2001, sot është automjet i dalë jashtë përdorimit. Ky automjet, me blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz 190”, në vitin 2005, i është lënë në përdorim nipit të

<sup>83</sup>Kursi i këmbimit 1 dollar = 0.756 euro, Banka e Shqipërisë, datë 31.12.2010.

<sup>84</sup>Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 4, në dosjen e Komisionit.

<sup>85</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2020, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>86</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2020, nga UKT-ja në dosjen e Komisionit.



nga inspektorja për kursimet e viteve 2004 dhe 2005, subjekti është shprehur se në këto vite gjendja *cash* ka qenë e njëjtë si në vitin 2003.

- Në DPV/2004 dhe DPV/2005 subjekti nuk ka deklaruar as shtesa as pakësime të gjendjes *cash*, ndërkohë që nga informacioni i përcjellë nga Banka e Shqipërisë është evidentuar se në datën 7.7.2004 subjekti ka investuar shumën 3.500.000 lekë në bono thesari me maturim në datën 20.1.2005.

E pyetur për këtë veprim, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se: *“Nisur nga fakti që unë në atë kohë të gjitha kursimet i kisha cash, kam deklaruar si gjendje cash të ardhurat nga banesa në shumën 1.700.000 lekë, e shitur në vitin 2003 dhe shumën 4.000.000 lekë, duke përfshirë në këtë shumë edhe gjendjet cash të viteve 2004 dhe 2005 të padeklaruara. Për të vërtetuar këtë fakt po ju paraqes dhe dokumentin nga Banka e Shqipërisë, nga Departamenti i Operacioneve Monetare, i datës 6.1.2022, ku pasqyrohet pjesëmarrja në ankand në datën 7.7.2004, me vlerë nominale 3.500.000 për një periudhë 6-mujore, si dhe interesi në shumën 135.000 lekë”*. Kështu, gjendja *cash*, e krijuar ndër vite, është përdorur për investimin në bono thesari në korrik të vitit 2004, të cilat janë maturuar në janar të vitit 2005 dhe janë mbajtur përsëri *cash* në banesë nga janar i vitit 2005, për t'u përdorur për blerjen e tre pasurive në vitin 2007.

- Në DPV/2006 subjekti ka deklaruar *“Shuma cash kursime nga të ardhurat për vitin 2006, 450.000 lekë”*. Pra, në fund të vitit 2006, gjendja *cash* është në vlerën 6.150.000 lekë.

- Në DPV/2007 subjekti ka deklaruar: *“Kursime nga të ardhurat për vitin 2007, shuma cash 3.000.000 lekë”*.

- Në vitin 2007 subjekti nuk ka deklaruar pakësim të shumës 6.150.000 lekë, por në procesverbalin e datës 3.3.2009, mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka sqaruar se: (i) *pasuria e krijuar në vitin 2007 e ka burimin e krijimit nga pakësimi i gjendjes cash në shumën 6.150.000 lekë, (gjendje cash e deklaruar në vitet 2003 – 2006); dhe (ii) gjendja e krijuar nga kursimet e pagave për vitin 2007, pra gjendja cash është 300.000 lekë, e kam deklaruar gabim 3.000.000 lekë”*.

Kështu, në fund të vitit 2007 gjendja *cash* është 300.000 lekë, duke konsideruar se shuma 6.150.000 lekë është përdorur për blerjen e tre pasurive në vitin 2007.

- Në DPV/2008 subjekti ka deklaruar: *“Të ardhura cash nga kursimet e pagës të vitit 2008, 500.000 lekë”*. Në fund të vitit 2008, gjendja *cash* është në vlerën 800.000 lekë.

- Në DPV/2009, subjekti ka deklaruar: *“Kursime cash nga të ardhurat e pagave dhe qirasë për vitin 2009, 700.000 lekë”*. Në fund të vitit 2009 gjendja *cash* është në vlerën 1.50.000 lekë.

- Në DPV/2010 subjekti ka deklaruar: *“Kursime cash nga të ardhurat e pagave dhe qirasë për vitin 2010, 700.000 lekë”*. Në fund të vitit 2010 gjendja *cash* është në vlerën 2.200.000 lekë.

- Në DPV/2011 subjekti nuk ka deklaruar asgjë mbi gjendjen *cash*, kështu, në fund të vitit 2011 gjendja *cash* është në vlerën 2.200.000 lekë.

- Në DPFD/2016 subjekti ka deklaruar: *“Gjendje cash (nga kursimet ndër vite, qira e dyqanit) 900.000 lekë”*.

- Në DPV/2016 subjekti ka deklaruar: *“Gjendja cash pakësuar nga 1.500.000 lekë, mbetet në shumën 900.000 lekë”*.

- Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: *“Gjendje cash 900.000 lekë. Burimi: kursime”*.

**79.2.** Sa i takon mundësisë financiare të subjektit për të krijuar kursimet *cash* ndër vite, ato janë pasqyruar tek analiza financiare për periudhën e rivlerësimit, sipas së cilës subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për vitet 1991 deri në fund të viteve 2003, 2008, 2009 dhe 2010. Në

parashtrimet e saj, subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të Komisionit dhe ka paraqitur një analizë sipas së cilës, periudhat e mësipërme rezultojnë me balanca pozitive.

### **Analizë financiare për periudhën e rivlerësimit**

**80.** Në përfundim të hetimit administrativ pamundësia financiare totale e subjektit për të krijuar pasuritë dhe likuiditetet, si dhe për të mbuluar shpenzimet për të gjithë periudhën e rivlerësimit është 9.222.340 lekë, për të cilën subjektit i kaloi barra e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

<b>0</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>4</b>
<b>Përshkrimi</b>	<b>Pasuri</b>	<b>Të ardhura</b>	<b>Shpenzime</b>	<b>Mundësia për kursime 2-1-3</b>
<i>deri në fund 2003</i>	9 000 000	8 777 050	4 134 148	-4 357 098
2004	193 962	1 837 368	475 856	1 167 550
2005	332 005	1 815 054	776 224	706 825
2006	244 826	1 296 688	660 893	390 968
2007	368 475	1 167 129	792 368	6 286
2008	466 268	1 212 852	803 593	-57 009
2009	593 544	1 429 354	1 164 963	-329 152
2010	1 737 291	1 409 983	883 808	-1 211 116
<i>deri më 3.3.2011</i>	36 725	287 647	92 827	158 095
2016	8 362 652	8 552 526	3 457 839	-3 267 965

### **Qëndrimi i subjektit në lidhje me analizën financiare dhe vlerësimi i Komisionit**

**81.** Në parashtrimet e saj, subjekti ka pretenduar se ka provuar në mënyrë bindëse krijimin e pasurive me burime të ligjshme dhe, për këtë arsye, vlerëson se ka arritur nivel të besueshëm të kriterit të pasurisë. Konkretisht, subjekti ka paraqitur pretendimet në lidhje me analizën financiare, duke kërkuar si vijon:

- konsiderimin e investimit për ndërtimin e pjesës takuese të banesës në vlerën 1.727.494 lekë dhe jo 3.000.000 lekë, pretendim i cili nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni, sikurse është argumentuar në paragrafin 42 të këtij vendimi;
- konsiderimin si periudhë ndërtimi vitet 1996 – 2000 dhe jo mars 1997, pretendim i cili është marrë në konsideratë nga Komisioni, sikurse është argumentuar në paragrafin 42 të këtij vendimi;
- përfshirjen e pensionit të vjehrrës për periudhën janar 1991 – 2000, pretendim i marrë në konsideratë nga Komisioni, sikurse është argumentuar në paragrafin 43.3 të këtij vendimi;
- përfshirjen e të ardhurave të vjehrrit nga aktiviteti privat dyqan në fshatin \*\*\*, Gramsh, pretendim i marrë në konsideratë pjesërisht nga Komisioni, sikurse është argumentuar në paragrafin 43.1 të këtij vendimi;
- përfshirjen e të ardhurave të bashkëshortit si ekspert kontabël, në vitin 1997, pretendim i cili nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni, sikurse është argumentuar në paragrafin 43.2 të këtij vendimi;
- reduktimin e shpenzimeve të jetesës për periudhën 1991 – 1999, periudhë kur nuk ka të dhëna zyrtare nga INSTAT-i, për shkak të përdorimit të produkteve nga toka bujqësore, pretendim i marrë në konsideratë pjesërisht nga Komisioni, sikurse është argumentuar në paragrafin 43.4 të këtij vendimi;

- të përfshihen të ardhura nga qiraja për vitet 2009 dhe 2010, pretendim i cili është marrë në konsideratë nga Komisioni, sikurse është argumentuar në paragrafin 55.9 të këtij vendimi;
- të përfshihet si e ardhur e ligjshme shuma 2.057,45 USD, e sjellë nga z. K. R. në llogarinë e bashkëshortit në “Raiffeisen Bank”, pretendim i cili nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni, pasi subjekti nuk ka provuar me dokumentacion të ardhura të z. D. ose K. R. për vitin 2010;
- rishpërndarja e shpenzimeve të mobilimit në një tjetër mënyrë nga Komisioni dhe, konkretisht, 300.000 lekë deri në vitin 2003 dhe 500.000 lekë deri në fund të vitit 2006, pretendim i cili është marrë në konsideratë nga Komisioni, pasi sidoqoftë shpërndarja e këtyre shpenzimeve ishte bërë nga Komisioni në mungesë të deklarimeve precize të subjektit gjatë hetimit administrativ;
- marrjen në konsideratë të vlerës së shitjes së automjetit në vitin 2010 sipas kontratës së shitjes në shumën 400.000 lekë dhe jo 250.000 lekë (vlera e blerjes së tij në vitin 2005), pretendim i cili nuk është marrë në konsideratë nga Komisioni, sikurse është argumentuar në paragrafin 64.4 të këtij vendimi.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit Komisioni ka rishikuar analizën financiare sipas së cilës, balanca negative bëhet nga 9.222.340 lekë në 4.824.260 lekë. Kjo balancë negative është totali i pamundësisë së subjektit për të krijuar pasuritë, likuiditetet dhe për të mbuluar shpenzimet e saj për periudhat:

- i) 3.3.2011 – 18.11.2016, kur subjekti nuk është në detyrë, periudhë e cila në përfundim të procesit ka rezultuar me një balancë negative prej 1.155.914 lekësh. Kjo balancë është mbartur/reflektuar në analizën financiare të te gjithë periudhës së rivlerësimit, për shkak se pasuritë dhe likuiditetet e krijuara gjatë kësaj periudhe janë deklaruar në deklaratën *Vetting*;
- ii) 1.8.1991 – 3.3.2011 dhe 18.11.2016 - 31.12.2016, kur subjekti është në detyrë, e cila në përfundim të procesit ka rezultuar me një balancë negative prej 3.668.345 lekësh.

## **Metodologjia e analizës financiare**

**82.** Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

### **82.1.** Të ardhurat e dokumentuara të subjektit<sup>89</sup> duke përfshirë:

- pagat si gjyqtare nga data (1.8.1991) e emërimit në detyrë e deri në fund të periudhës së rivlerësimit dhe pagat e përfituara si pedagoge e jashtme;
- të ardhurat e dokumentuara të bashkëshortit të subjektit<sup>90</sup>;
- pensionet<sup>91</sup> e vjehrrit dhe të vjehrrës<sup>92</sup> së subjektit për periudhën 1991 – 2000, kur ata kanë jetuar së bashku;
- të ardhurat e vjehrrit R. C., nga ushtrimi i aktivitetit privat në fshatin \*\*\*, Gramsh, për periudhën 1993 – 1997<sup>93</sup>;
- të ardhurat e dokumentuara nga pagat e vajzave të subjektit E.<sup>94</sup> dhe A. Ç.<sup>95</sup>;
- të ardhurat e përfituara nga qiraja për vitet 2009, 2010, 2012 dhe 2016 (nga data 13.6.2016);
- të ardhurat e përfituara nga interesat bankare<sup>96</sup>;

<sup>89</sup>Shihni dokumentet në aneksin \*\*\* të administruara në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>90</sup>Shihni dokumentet në aneksin \*\*\* të administruara në dosjen e ILDKPKI-së

<sup>91</sup>Shihni dokumentet e paraqitura nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>92</sup>Shihni dokumentet e paraqitura me parashtrimet e subjektit, datë 9.6.2022, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>93</sup>Shihni dokumentet e paraqitura nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, administruar në dosjen e Komisionit.

<sup>94</sup>Shihni dokumentet në aneksin \*\*\* të administruara në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>95</sup>Shihni dokumentet në aneksin \*\*\* të administruara në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>96</sup>Shihni informacionin e përcjellë nga: Banka e Shqipërisë, “Raiffeisen Bank”, BKT dhe “Alpha Bank”.



- të ardhurat nga shitja e pasurive: apartamenti në Gramsh në vitin 2003 dhe dy automjete në vitet 2009 dhe 2010. Në rastin kur automjeti është shitur më shtrenjtë nga çfarë është blerë, çmimi i shitjes është barazuar me atë të blerjes.

Nuk janë përfshirë si të ardhura të ligjshme: të ardhurat nga bashkëshorti si ekspert kontabël në vitin 1997; shuma 1.000 USD, dhuruar nga vjehri në vitin 2012; shuma 2.057 USD në vitin 2010, e dhuruar nga familjarë në vitin 2012.

## 82.2. Shpenzimet

- Shpenzimet e jetesës për vitet 1991 – 1999 janë përlllogaritur në masën 30% të të ardhurave familjare nga paga; për vitin 2000 për 6 persona, për vitin 2001 e në vijim për 4 persona bazuar në standardin e ILDKPKI-së.

- Shpenzimet e udhëtimit dhe pushimeve janë përlllogaritur bazuar në raportin nga sistemi *TIMS* dhe sqarimet e dhëna nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve. Metodologjia e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

- Shpenzimet e shkollimit për vajzën E. C. për vitin 2016, sipas përgjigjeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti.

- Shpenzime të tjera në të cilat përfshihen shpenzime mobilimi sipas deklarimeve të subjektit në pyetësorin standard, shpenzime të tjera sikurse janë evidentuar nga lëvizjet bankare dhe çdo faturë apo mandat i administruar gjatë procesit të rivlerësimit.

## 82.3. Pasuritë

- Blerja e apartamentit në Gramsh në vitin 2001, e përfituar me privatizim.

- Investimi për ndërtimin e pjesës takuese të banesës në Tiranë, në shumën 3.000.000 lekë dhe i shtrirë nga viti 1997 deri në fund të vitit 2000.

- Blerja e tri pasurive të paluajtshme në vitin 2007: një apartament në \*\*\*, Durrës dhe dy dyqane në Tiranë.

- Automjetet e blera nga bashkëshorti i subjektit: automjet i blerë në vitin 2001; “Mercedes-Benz”, blerë në datën 2.6.2005; “Renault”, blerë në datën 6.11.2010; “Mercedes-Benz”, blerë në datën 29.5.2010.

- Likuiditetet janë trajtuar si pjesë e pasurive, në një zë të veçantë. Këtu janë përfshirë gjendjet e llogarive bankare<sup>97</sup> në fund të çdo viti/date të analizuar, si dhe gjendjet *cash* sikurse janë deklaruar nga subjekti në DPV-të dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit.

Një pjesë e likuiditeteve që vijnë në deklaratën *Vetting* janë krijuar gjatë një periudhë kur subjekti nuk ka qenë në një funksion që të vetohet. Sidoqoftë, burimi i krijimit të tyre është analizuar dhe rezultati i nxjerrë nga ky verifikim (analiza financiare për periudhën jashtë detyre) është mbartur në periudhën brenda detyrës, duke afektuar kështu rezultatin total të subjektit.

---

<sup>97</sup>Shkresë: nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020, nga Banka e Shqipërisë; nr. \*\*\* prot., datë 17.1.2020 nga “Alpha Bank”; nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, nga “Raiffeisen Bank”; nr. \*\*\* prot., datë 27.1.2020, nga BKT; nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2020, nga “Intesa Sanpaolo Bank”; nr. \*\*\* prot., datë 21.2.2020, nga “Credins Bank”; nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2020, nga Banka e Parë e Investimeve Albania.

- Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit.

- Vlera e çdo pasurie është marrë nga kontratat e porosive, shitblerjeve, deklaratat noteriale, si dhe çdo provë tjetër e administruar nga Komisioni, e ballafaquar me deklaratën *Vetting* dhe DPV-të.

- Shuma në fund përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së vlerësimit.

### **Vlerësimi përfundimtar në lidhje me kriterin pasuror**

**83.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë u vërtetua se subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu ka mungesë burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, për shkak të balancës negative në shumën 4.824.260 lekë, nga e cila, 1.155.914 lekë i përket periudhës jashtë detyrës dhe 3.668.345 lekë i përket periudhës gjatë detyrës.

Sa i takon balancës negative, në periudhën jashtë detyrës, referuar standardit të mbajtur në raste të ngjashme edhe nga Komisioni edhe Kolegji, Komisioni, nisur nga rrethanat faktike të kësaj balance, si dhe vlera, çmoi se proporcionalisht kjo balancë negative nuk mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit. Kjo edhe në konsideratë të faktit se ndonjë pasuri në formë likuiditetesh të deklaruara nga bashkëshorti i subjektit në këtë periudhë e të mbartura deri në deklaratën *Vetting* janë të pajustificuara me burime të ligjshme, këto likuiditete nuk u vërtetua të jenë investuar për krijimin e ndonjë pasurie gjatë periudhës së detyrës. Ndërkohë, sipas kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016, germa “d”, e pikës 5, e nenit 33, e pikës 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe bazuar në standardin e vendosur tashmë në lidhje me vlerën e balancës negative penalizuese për subjektet e rivlerësimit, në përfundim të procesit Komisioni çmoi se balanca negative prej 3.668.345 lekësh gjatë periudhës së detyrës, përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

### **Kontrolli i figurës**

**84.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr.\*\*\* prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Brunilda A. Çarçiu, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.1.2020, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e saj apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar *përshatshmërinë* për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Brunilda Çarçiu.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020, Komisioni ka kërkuar edhe përditësim informacioni për subjektin Brunilda Çarçiu. Me shkresa konfidenciale të institucioneve kompetente dërguar nga DSIK-ja është konfirmuar që *nuk ka* të dhëna të përditësuara. Ndërkohë, gjatë procesit të rivlerësimit nuk u evidentuan të dhëna që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit.

## Vlerësimi i aftësive profesionale

**85.** Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.12.2020, KLGJ-ja i ka kërkuar Komisionit të japë mendim lidhur me periudhën e rivlerësimit që do të merret për zhvillimin e shortit profesional të znj. Brunilda Çarçiu, nëpunëse përgjegjëse pranë Njësisë së Vlerësimit Profesional dhe etik të gjyqtarëve, pranë KLGJ-së, e cila në periudhën e rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, sipas ligjit, nuk ka ushtruar detyrën e gjyqtarit, ndërkohë që është emëruar inspektore në KLD në datën 18.11.2016. Ky institucion ka informuar gjithashtu se sipas detyrimit ligjor bazuar në nenin 41/1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” znj. Brunilda Çarçiu ka depozituar në datën 30.1.2017 formularin e vetëvlerësimit dhe dokumente shoqëruese pranë ish KLD-së, si organ i vlerësimit të aftësive profesionale.

**86.** Me qëllim përcaktimin e periudhës së rivlerësimit për efekt të vlerësimit të aftësive profesionale të znj. Brunilda Çarçiu, Komisioni i administroi nga KLGJ-ja<sup>98</sup> praktikën e plotë të shqyrtuar nga ky institucion për dhënien e statusit të magjistratit të inspektore Brunilda Çarçiu, nga aktet e së cilës u konstatua se: në periudhën 1.8.1991 – 15.5.2000 ka ushtruar detyrën e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gramsh; në periudhën 15.5.2000 – 1.3.2011 ka ushtruar detyrën e ndihmëses ligjore pranë Gjykatës së Lartë; me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.11.2016, të ish KLD-së është emëruar inspektore pranë Inspektoratit të ish KLD-së; me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.12.2019, pasi ka arritur në përfundimin se inspektorja Brunilda Çarçiu e ka ruajtur statusin e gjyqtarit, KLGJ-ja ka vendosur të deklarojë pasjen e statusit “magjistrat” nga znj. Brunilda Çarçiu.

**87.** Me vendimin nr. 2, datë 21.11.2019, trupi gjykues, duke mbajtur në konsideratë se gjatë periudhës së rivlerësimit, 8.10.2013 – 8.10.2016, të parashikuar nga ligji nr. 84/2016, subjekti ka qenë jashtë sistemit gjyqësor dhe nga data e emërimit të saj si inspektore pranë ish KLD-së ka më pak se tre vjet, vendosi ndër të tjera t’i japë mendim KLGJ-së, që dokumentet mbi bazën e të cilave do të bëhet vlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Brunilda Çarçiu të përzgjidhen nga dokumentacioni i prodhuar prej saj sipas periudhave përkatëse, në të treia funksionet e mbajtura, si ish gjyqtare, ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë dhe si inspektore pranë ish KLD-së në periudhën e intervalit kohor 18.11.2016 – 18.11.2019.

**88.** KLGJ-ja<sup>99</sup>, në konsideratë të parashikimit të pikës 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet se “Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelimeve merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit”, sugjeroi që si periudhë e rivlerësimit lidhur me këtë subjekt të merret ajo e ushtrimit të detyrës si ndihmëse ligjore pranë Gjykatës së Lartë (2006 – 2011) dhe periudha e ushtrimit të detyrës si inspektore pranë ish KLD-së. Në përfundim, trupi gjykues mori në konsideratë vlerësimin e KLGJ-së në lidhje me periudhën e rivlerësimit për këtë subjekt.

**89.** Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Brunilda Çarçiu, bazuar në: (i) raportin për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor, dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.5.2022, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 12.5.2022; (ii) informacionin e marrë nga burime të tjera.

**90.** Raporti për analizën e aftësive profesionale, kryer nga KLGJ-ja, është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit, si dhe në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë

<sup>98</sup>Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2020, nga KLGJ-ja në dosjen e Komisionit.

<sup>99</sup>Shihni shkresën kthim përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2021, nga KLGJ-ja në dosjen e Komisionit.

formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në datën 30.1.2017; (ii) pesë dokumentet ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

**91.** Pasi KLGJ-ja ka evidentuar: (i) saktësinë e formularit të vetëdeklarimit; (ii) përvojën profesionale në 10 vitet e fundit; (iii) detyrat e kryera tre vitet e fundit dhe të dhënat statistikore; (iv) trajnimet në tre vitet e fundit; (v) subjekti për shkak të kohës së shkurtër në detyrën e inspektore nga emërimi në datën 18.11.2016 deri në kohën e plotësimit të formularit të vetëdeklarimit, nuk ka finalizuar asnjë dokument ligjor, ka kryer analizën e pesë dosjeve të përzgjedhura me short dhe dokumenteve të administruara, pjesë e këtyre dosjeve, nga ku nuk janë evidentuar problematika.

**92.** Sa i takon të dhënave nga burime arkivore, KLGJ-ja ka konstatuar se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për subjektin e rivlerësimit Brunilda Çarçiu nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e ish KLD-së dhe nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe as të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish KLD-ja.

**93.** Pasi ka analizuar të dhënat si më sipër, KLGJ-ja, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit për secilin prej kriterëve, si vijon:

### **93.1 Për aftësitë organizative**

#### *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, sasia*

Për periudhën 18.11.2016 – 18.12.2018, subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu, në cilësinë e inspektore së KLD-së, ka përfunduar në total 220 dokumente ligjore, nga të cilat 25 prej tyre përbëjnë raporte të vlerësimit etiko-profesional të gjyqtarëve për periudhat 2007 – 2009 dhe 2010 – 2012, raporte të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve për efekt *vettingu*, si dhe akte të tjera, të cilat i janë nënshtruar procesit të shortit për rivlerësim. Subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu rezulton se ka përmbushur kriterin sasior të përcaktuar në sistemin e vlerësimit.

Për periudhën 3.3.2006 – 1.3.2011, subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu, në cilësinë e ndihmëses ligjore në Gjykatën e Lartë, ka përfunduar në total 772 dokumente ligjore, relacione pranimi e mospranimi për çështje penale e civile sipas periudhës së punës në Kolegjin Penal dhe në Kolegjin Civil. Pra, rezulton se subjekti ka pasur një ngarkesë mbi standardin minimal.

#### *Metodologjia*

Inspektorja Brunilda Çarçiu ka aftësi shumë të mira metodologjike. Në pesë dokumentet ligjore të vëzhguara veprimet procedurale dokumentohen rregullisht dhe qartë, si dhe nuk ka mangësi në kryerjen e detyrave përkatëse. Për çdo veprim procedural janë mbajtur aktet e domosdoshme, të cilat i janë bashkëngjitur aktit të vlerësimit apo vendimit të kalimit për gjykim. Baza ligjore identifikohet lehtësisht prej saj në hartimin e raporteve dhe në hartimin e relacioneve për çështjet penale e civile të shqyrtuara prej saj. Ka aftësi të mira për të paraqitur saktë nga pikëpamja formale aktet në funksion të uniformizimit të praktikave.

#### *Shpejtësia*

Konstatohet se gjatë ushtrimit të detyrës si inspektore, ndonëse ka pasur ngarkesë të lartë sasiore, ku ka përballuar detyra të ndryshme të ngarkuara, faktin se Inspektorati i KLD-së ka funksionuar me më pak inspektorë sesa kishte në organikën e tij, subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu e ka respektuar afatin standard të parashikuar në aktet nënligjore që rregullojnë këto veprimtari.

Gjithashtu, duhet evidentuar volumi i madh i punës i përballuar nga subjekti gjatë ushtrimit të detyrës si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë.

## **93.2 Aftësitë profesionale teknike**

### *Qartësia e hartimit të raportit*

Subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu ka aftësi të mira për të hartuar qartë raportet e relacionet e punës. Ajo i kushton rëndësi mbledhjes së plotë dhe të saktë të të dhënave, duke ndjekur formatet standard të raporteve sipas llojit të tyre (vlerësim, rivlerësim apo relacion), identifikon saktë rrethanat e çështjes, ligjin e aplikueshëm, paraqitjen e plotë të detajeve e fakteve, si dhe krijimin e dosjes në mënyrë të plotë dhe profesionale.

Nga përmbajtja e tri dokumenteve ligjore të llojit relacion konstatohet se në çdo rast ndihmësja ligjore ka studiuar në çdo shkallë gjykimi çështjen gjyqësore që ka relatuar, duke identifikuar disponimet e gjykatave më të ulëta, thelbin e analizës ligjore, shkaqet e rekursit apo kundërrkursit, si dhe ka dhënë mendimin e saj ligjor për kalimin e çështjes për gjykim.

### *Aftësia për të përdorur njohuritë juridike*

Subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu ka nivel të mirë të njohurive mbi legjislacionin dhe jurisprudencën, fakt që u konstatua nga përmbajtja e pesë dokumenteve të përzgjedhura me short. Rezulton se identifikon qartë problematikën e çështjes, duke i kushtuar rëndësi këtij hapi të parë në proces. Subjekti shpreh një nivel të mirë të njohurive mbi legjislacionin dhe jurisprudencën, duke i përditësuar këto njohuri në njohjen e pjesëve të reja të legjislacionit, apo edhe vendimeve të reja unifikuese, si dhe ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit.

### *Aftësia për të përdorur raportin sipas modeleve të caktuara*

Subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu pasqyron aftësi në këtë aspekt. Nga vëzhgimi i pesë dokumenteve të përzgjedhura me short rezulton se ka respektuar modelet standarde e të unifikuara, të miratuara sipas llojit të dokumentit ligjor.

### *Saktësia në hartimin e raportit*

Nga vëzhgimi i pesë dokumenteve të përzgjedhura me short rezulton se inspektorja ka aftësi edhe në këtë aspekt, pasi raportet dhe relacionet e përgatitura prej saj janë të sakta nga ana profesionale. Ato nuk përmbajnë gabime ligjore apo materiale dhe janë miratuar pa asnjë vërejtje nga eprorët e inspektoreve. Gjuha e përdorur është profesionale, e saktë, me metodologji të qartë dhe në përputhje me rregullat e drejtshkrimit.

## **93.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave të gjyqësorit**

### *Etika dhe disiplina në punë*

Subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu ka respektuar rregullat e etikës në komunikim me eprorët, kolegët e saj, gjyqtarët dhe administratën gjyqësore. Ajo ka treguar saktësi dhe shpejtësi në realizimin e detyrave. Dallohet për punën në grup, ku shfaqet e gatshme të marrë përsipër detyra e të japë udhëzimet e duhura, sikurse janë dhënia e mendimeve ligjore në relacionet e hartuara për kalimin e çështjeve gjyqësore për gjykim nga kolegjet respektive. Subjekti i rivlerësimit karakterizohet nga ndjenja e përgjegjësisë në përmbushjen e detyrës.

### *Integriteti*

Konstatohen aftësi të dukshme komunikuese, ndjenjë përgjegjësie dhe integritet e aftësi në ushtrimin e detyrës. Në periudhën e vlerësimit, ndaj subjektit nuk është paraqitur asnjë ankesë as nga gjyqtarët dhe as nga subjektet ankuuese ndaj gjyqtarëve. Po ashtu, ndaj saj nuk ka pasur asnjë rast për fillimin e procedurave disiplinore. Nuk rezultojnë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

## *Paanësia*

Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Brunilda Çarçiu. Nuk rezultojnë të jenë paraqitur ankesa ndaj saj për ruajtjen e konfidencialitetit dhe të paanësisë përgjatë përmbushjes së detyrës, si nga qytetarët, ashtu dhe nga gjyqtarët. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjere që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit të ketë cenuar të drejtat e palëve.

### **93.4 Angazhimi profesional**

#### *Kriteret sociale*

Nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e subjektit me gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, pranë të cilit ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor, apo me trupën gjyquese të Kolegjit Penal e Civil të Gjykatës së Lartë. Subjekti ka shfaqur aftësi shumë të mira për të punuar në grup, si dhe për të krijuar marrëdhënie bashkëpunimi dhe mjedis të përshtatshëm për zbatimin e detyrave të ngarkuara, si për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve ashtu edhe për rivlerësimin kalimtar të tyre.

#### *Rritja profesionale*

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka qenë pjesëmarrëse në 1 aktivitet trajnues, jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, me temë: “*The digital Audio Recording System and the monitoring of its usage and courtroom utilization in Albanian court*”, i organizuar nga USAID-i, në Tiranë më 10.7.2014. Ajo ka paraqitur certifikata për trajnime të tjera nga Shkolla e Magjistraturës dhe institucione jashtë programit të saj, të cilat janë jashtë periudhës së rivlerësimit.

### **94. Informacioni i marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar**

**94.1** Informacioni i marrë nga KLGJ-ja për pesë dokumentet e përzgjedhura me short, për të cilat u konstatuan të njëjtat vlerësime si ato të KLGJ-së, trajtuar më sipër.

**94.2.** Për subjektin e rivlerësimit nuk janë paraqitur denoncime nga publiku.

### **95. Rivlerësimi profesional sipas burimeve të parashikuara në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”**

**95.1** Lidhur me rivlerësimin e aftësive profesionale, në pikën 4, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se inspektorët që nuk janë magjistratë vlerësohen bazuar në: (a) relacionin dhe mendimet ligjore të përgatitura; (b) rezultatin e testimin në Shkollën e Magjistraturës.

**95.2** Sikurse u përmend me sipër, në rastin konkret, bazuar në rrethanat e çështjes, Komisioni vlerësoi që për efekt të vlerësimit profesional të përzgjedheshin dokumente të prodhuara nga subjekti në funksionet e saj si gjyqtare, ndihmëse ligjore dhe inspektore e ish KLD-së, çka u kufizua për shkak të moskapërcimit të afatit ligjor të periudhës së rivlerësimit, vetëm në dokumentet e prodhuara si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Lartë dhe inspektore e ish KLD-së. Ndërkaq me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.12.2019, pasi ka arritur në përfundimin se inspektorja Brunilda Çarçiu e ka ruajtur statusin e gjyqtarit, KLGJ-ja ka vendosur të deklarojë pasjen e statusit “magjistrat” nga znj. Brunilda Çarçiu.

**95.3.** Në kushtet kur nga ana e KLGJ-së, që është organi kompetent lidhur me statusin e magjistratit, është deklaruar se subjekti ka ruajtur statusin e magjistratit dhe deklaroi pasjen e tij, pra është një inspektore magjistrate, trupi gjyques vlerëson se mospërmbushja e detyrimit sipas germës “b”, të pikës 2, të nenit 42, lidhur me testimin në Shkollën e Magjistraturës nuk përbën shkak për penalizim të subjektit, por edhe në rastin e kundërt, nëse subjekti nuk do të

kishte statusin e magjistratit, neni E i Aneksit të Kushtetutës nuk parashikon klauzola penalizuese për inspektorët lidhur me testimin në Shkollën e Magjistraturës.

**95.4.** Në përfundim të vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues e konsideron të mjaftueshëm vlerësimin profesional të kryer nga KLGJ-ja, mbështetur në pesë dokumentet ligjore për arritjen e nivelit minimal kualifikues të subjektit të rivlerësimit, sipas kërkesave të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

#### **IV. SEANCA DËGJIMORE**

**96.** Në datat 14.6.2022 dhe 20.6.2022, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar Gerrit Sprenger u zhvilluan seancat dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Brunilda Çarçiu. Gjatë seancave dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij, duke dhënë sqarime të mëtejshme mbi rezultatet e hetimit administrativ, procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, si dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues. Në datën 20.6.2022 u zhvillua seanca në të cilën Komisioni shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Brunilda Çarçiu.

#### **V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**97.** Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe gjatë seancave dëgjimore.

Në të gjitha komunikimet znj. Brunilda Çarçiu ka qenë në çdo rast e gatshme, duke u treguar tërësisht bashkëpunuese, pasi i është përgjigjur me korrektesë dhe brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë shpjegime në mënyrë shteruese për informacionin e kërkuar e duke paraqitur dokumente shkresore për të vërtetuar pretendimet e saj.

#### **KONKLuzion PËRFUNDIMTAR**

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, sipas pikës 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit, Komisioni çmoi se:

1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.
2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.
3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit Brunilda Çarçiu ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi kreu bisedimet për marrjen e vendimit në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Brunilda Çarçiu, inspektore në Inspektoratin e ish-KLD-së, sot KLGJ.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 20.6.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Kryesuese**

**Firdes SHULI**  
**Relatore**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ertugena Sokoli*